

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 22.3.2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 22.03.2007.GODINE

MARS - MART 2007

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë,
2. Shqyrtimi i informatës për ngjarjet e 10 shkurtit 2007.

DNEVNI RED

1. Razmatranje informacije Regulatornog Autoriteta Telekomunikacije u vezi odabira drugog mobilnog telefonskog operatera na Kosovu,
2. Razmatranje informacije o događajima od 10. februara 2007. godine

SEANCA PLENARE e datës 22.3.2007

KRYEARI KOLË BERISHA -Të nderuar deputetë, i nderuari kryeministër dhe kabinet qeveritar, mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë 81 deputetë që do të thotë që janë plotësuar kushtet të procedohet me punë. Seanca është në një farë mënyre vazhdimësi e seancës së kaluar. Dhe, vazhdojmë aty ku e kemi ndërprerë sot një javë.

Shqyrtimi Informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë

Si Kryesi e kemi shtuar edhe një pikë të rendit të ditës bashkë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, meqenëse ndërkohë ka arritur materiali nga Ministria e Punëve të Brendshme që mund të shqyrtohen ngjarjet e 10 shkurtit.

Fillojmë me pikën e parë.

Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 16 mars 2007. Gjatë shqyrtimit të Informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë vendosi që debati të shtyhet me qëllim që të kërkohet nga Bordi i Autoritetit Rregullator që t'i paraqet Kuvendi të dhënat shtesë për pjesëmarrësit në tender dhe vlerësimet e pikave ofertuesve lidhur me procedurën për zgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë dhe të kërkohet që në seancën plenare të 22 marsit 2007 të prezantojë kryeministri i Kosovës, ministri për Telekomunikacion, kryesuesi i ART-së si dhe të gjithë anëtarët e bordit. Informata shtesë u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Sipas procedurës, fjalën mund ta marrë paraqitësi i kërkesës. Urdhëroni z. Alush.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari kryetar, ju lutem të veproni si thatë në fillim, se kjo është vazhdimi i seancës. Propozuesi i kësaj kërkesë ka shfrytëzuar të drejtën e vet dhe ne jemi shumë të shqetësuar për akuzat pa bazë që janë bërë atë ditë dhe kemi insistuar që këtu të jenë kryeministri, ministri përkatës ,si dhe ART-ja, prandaj ju lutem ta vazhdoni mbledhjen, të mos fillohet mbledhja prej fillimit. Ju faleminderit!

KRYEARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! z. Limaj, ju nuk keni dokument që Qeveria nuk e ka dëgjuar diskutimin e juaj. Nuk keni të drejtë tash, sepse e keni thënë atë çka është dashur ta thoni. Urdhëro zoti Limaj, e keni fjalën.

DEPUTETI DEMIR LIMA – I nderuari z. kryetar, të nderuar z. kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Unë mendoj se qysh në start është një shkelje procedurale, sepse, ratë nën ndikim të shefit të grupit parlamentar, Alush Gashit, të cilit ia tërheq vëmendjen këtu. Demir Limaj nuk ka bërë akuza. Akuzat e pabaza, si thotë ai, në qoftë se janë ato akuza të pabaza, atëherë shtrohet pyetja se Alush Gashi a është kryesues i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, a është kryeministër në këtë rast? Ne nuk guxojmë t'i prejudiojmë gjërat dhe të paragjykojmë, absolutisht. Unë kam kërkuar të diskutohet për të gjitha spekulimet

që janë bërë, qofshin të vërteta apo të pavërteta, sepse është në interes edhe të institucionit edhe të Agjencionit të ART-së, është edhe në interes të Qeverisë. Nga të gjitha këto përfolje që janë bërë nga mediat dhe nga kritikët shihet qartë që janë bërë shkelje të ligjit. Pse të mos procedohet me një kompani të pavarur, që do ta bëjë inspektimin e procesit të përzgjedhjes së operatorit të dytë. Unë nuk di çka ka të keqe këtu. Të keqe ka te ata të cilët nuk pranojnë një gjë të tillë dhe shtohet dyshimi. Për mua është dyshim i madh në qoftë se nuk pranohet një kompani për të bërë hetimin e procesit të përzgjedhjes së operatorit të dytë. Pse atëherë, shtrohet pyetja , të mos bëhet një inspektim i tillë? Mendoj që i shkon për shtati edhe Qeverisë, z. Çeku dhe Bordit të ART-së. Në qoftë se të gjitha ato përfolje nuk qëndrojnë, atëherë, le të formohet një komision, një kompani e cila është përgjegjëse, është e fushës përkatëse, ta bëjë inspektimin dhe raportin të na sjellë këtu.

KRYEARI KOLË BERISHA – E kryetë fjalën tuaj. Mirë, urdhëroni z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI –I nderuari z. kryetar. Grupi Parlamentar i LDK-së është i përcaktuar dhe i përkushtuar për transparencë të plotë. Dhe ne nuk jemi në mbrojtje të pavërtetave. Mu për shkak të ngritjes së çështjeve, ne kemi kërkuar që debati të vazhdohet në prani të kryeministrit, ministrit përkatës dhe të ART-së. Dhe, ne nuk kemi të dhëna që Qeveria i ka humbur 700 milion lidhur me këtë çështje, prandaj, ne e konsiderojmë të domosdoshme që këtë çështje ta trajtojë Qeveria këtu në seancën plenare. Ne edhe herën e kaluar e kemi ditur që këtu ka konflikte të interesit që interpelanca është kërkuar nga z. Limaj, i cili është zyrtar i lartë i PTK-së, por për shkak të ngritjes së çështjeve nga ana e shoqërisë civile nga deputetët, ne kemi pranuar me shumë përkushtim këtë pikë të rendit të ditës dhe jemi të interesuar që kjo të trajtohet konform ligjit. I respektojmë plotësisht procedurat e punës së Kuvendit të Kosovës, por nuk jemi në fushatë zgjedhore. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Replikë, keni vetëm një minutë.

DEPUTETI DEMIR LIMAJ- I nderuari z. Alush Gashi, me gjithë respektin për ju si profesor. Interesi personal imi është e vërtetë që është interesi nacional dhe interesi publik. Është e vërtetë që jam zyrtar i Post -telekomunikacionit të Kosovës, mirëpo aty mbrohet interesi publik, interesi i qytetarëve tanë për të cilët kam ngritur çështjen që së pari është dashur të privatizohet operatori “Vala” që është pasuri e qytetarëve të Kosovës, e tani të fillohet me procesin e operatorit të dytë dhe të tretë dhe në qoftë se ka treg edhe për të katërtin. Ky është interesi im dhe i vetmi interes, interesi nacional dhe interesi publik i qytetarëve të Kosovës, asgjë më tepër.

KRYEARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Ftojme përfaqësuesin e ART-së ta marrë fjalën.

PËRFAQËSUESI I ART-së –ANTON BERISHA – I nderuari z. kryetar,
I nderuari z. kryeministër, të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Konform kërkesës së Kuvendit të Kosovës të datës 7 mars 2007, ART i ka dorëzuar Kuvendit një informatë lidhur me procesin e operatorit të dytë mobil. AER pas dorëzimit të informatës nuk ka pasur nga Kuvendi asnjë kërkesë shtesë e as ftesë për seancën plenare të datës 16 mars 2007.

Për hir të informimit të drejtë duhet theksuar se ART dhe unë si përfaqësues i ART-së deri më tani ju kemi përgjigjur pozitivisht të gjitha kërkesave të Kuvendit të Kosovës, si dhe Komisionit Funkcional. Edhe për temën në fjalë me datën 6 shkurt 2007 në cilësinë e përfaqësuesit të AER-it kam raportuar para Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion.

Zhvillimi i sektorit të telekomunikacionit në Kosovë është i një rëndësie të madhe për ekonominë dhe shoqërinë kosovare si tërësi, prandaj është e domosdoshme që të krijohet tregu konkurrent në mes të operatorëve të licencuar. Në fakt, liberalizimi i tregut jo vetëm që është kërkesë ligjore, por edhe kërkesë e Komisionit Evropian që u është bërë të gjitha vendeve të Evropës Juglindore. Në këtë projekt, për fat të mirë, është futur edhe Kosova. Kjo qasje mundëson futjen e teknologjive të reja, të shërbimeve moderne, në mënyrë që të plotësohen nevojat e konsumatorëve apo të qytetarëve të Kosovës, si dhe, natyrisht, investime direkt të huaja dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Konform Ligjit të telekomunikacionit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të prolonguar nga Përfaqësuesi Special, Qeveria e Kosovës më datën 28 mars 2006 ka marrë vendim për shpalljen e tenderit. Meqenëse neni 36 i këtij ligji ka kërkuar që ky proces të sigurojë një koordinim të ngushtë me PSSP-në, neni 36, është vendosur që procesi të udhëhiqet prej një komisioni special të përbashkët pesë anëtarësh, në të cilin dy përfaqësues nga PSSP-ja, nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut dhe nga Zyra Ligjore e Shtyllës së Katërt, dy përfaqësues nga Qeveria, nga Zyra e Kryeministrit dhe nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe një përfaqësues nga Bordi i AER-it.

Konform ligjit, neni 36, Qeveria duhej të përgatiste pakon tenderuese, ndërsa ART të implementojë tenderin. Për shkak të rëndësisë së procesit dhe për shkak të asaj të gjithë e dimë e kompetencat që ka PSSP-ja, Qeveria dhe PSSP vendosën për angazhimin e një kompanie konsulente ndërkombëtare, që do të administronte procesin, bënte verifikimin dhe në përgjithësi do të asistonte komisionin special për të arritur objektivat. Ndërsa roli i Bordit të ART-së u pasqyrua me kompetenca që kishin të bënin me pjesën që i takonte ART-së, respektivisht me një anëtar në Komisionin Special, dhe më vonë me dy anëtarë në Komisionin vlerësues. Kompania e mirënjohur ndërkombëtare "APIS- Telekom" nga Suedia, respektivisht për ata që i njohin rrjedhat e telekomunikacionit nga regjioni, ka zbuluar dhe ka treguar rezultatet më të mira në fushën e telefonisë mobile, u zgjodh për të ndihmuar në administrimin e tërë procesit.

Qeveria e Kosovës, mbështetur në të drejtën ligjore për të përgatitur pakon tenderuese, ka përcaktuar metodën e përzgjedhjes së kombinuar të ashtuquajtur Ankant + Bjudi kontest si dhe kriteret e vlerësimit në të cilin është përcaktuar që çmimi të jetë 30% të pikëve, mbulueshmëria dhe shtrirja e rrjetit 30%, participimi vendor 20%, shërbimet dhe kualiteti 10%, përvoja në telefoninë mobile 10%, si dhe çmimi minimal prej 20 milionë eurosh.

Përgjegjësitë e ART-së, Komisioni Special Mbikëqyrës është udhëhequr nga përfaqësuesi i Qeverisë, ndërsa komisionit i është kërkuar që gjitha vendimet t'i marrë me konsensus, pra nuk ka pasur sistem të votimit. Përgjegjësia e ART-së në këtë proces ishte e natyrës pjesëmarrëse administrative dhe profesionale. Ministria e Transporti dhe e Post - telekomunikacionit dhe ART kanë bërë publikimin e tenderit në shtypin vendor dhe në shtypin ndërkombëtar, në "Fajnën Shenel Tajms".....Në Ueb faqen e MTTP-së, të ART-ë dhe në Ueb faqen e Uenit. Staf i profesional i ART-së në bashkëpunim me kompaninë konsulentë ABES Telekom ka qenë përgjegjëse që të sigurojë mënyrë transparente të komunikimit me palët e interesuara. Kjo është arritur duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara në Web faqen zyrtare të ART-së në të cilën kanë pasur qasje të gjithë, e cila është azhuruar çdo javë. Ky proces i pyetjeve dhe i përgjigjeve kishte përmbajtjen e ambientit rregullator në Kosovë, kushtet e investimit e numeracionin në spektrin frekuentor, e pyetjet të tjera teknike.

Dokumenti ka qenë publik dhe ende është në faqen e ART-së. Komisioni për vlerësimin e ofertave është themeluar nga dy anëtarë të emëruar nga PSSP-ja ,një anëtar nga Zyra e Kryeministrit dhe dy anëtarë nga ART-ja. Në qoftë se kërkohet që për çështje teknike të ketë sqarime të mëtutjeshme, atëherë kryesuesi i Komisionit z. Lulzim Kurtaj, i cili është edhe anëtar i Bordit, mund t'i japë ato sqarime të cilat i keni marrë në dokumentacionin shtesë. Në ditën e nënshkrimit të licencës, si përfaqësues i ART-së kam takuar zëvendëskryeadministratorin z. Shuk dhe jam informuar se kjo çështje për UNMIK-un është e mbyllur dhe se unë duhet të vazhdoj me procedurën e licencimit. Po të njëjtën ditë z. Agim Çeku, kryeministër i Kosovës, në emër të Qeverisë ka nënshkruar deklaratën e vendimit për licencim dhe po të njëjtën ditë kemi bërë konsultimet me zëvendëskryeministrin z. Lutfi Haziri. Ky proces duhet të jetë i dobishëm për ekonominë dhe për qytetarët e Kosovës , për organet kompetente ligjore dhe profesionale, kanë dhe duhet të dëshmojnë rregullsinë e tij. Në fund të fundit, përse ekzistojnë kompanitë konsulente profesionale, auditorë të pavarur, agjensionet profesionale dhe gjykatat. Konsideroj se përpjekja e personalizimit të këtij procesi në kontekstin negativ në emrin tim personal është i pa shembull në praktikat e vendeve evropiane dhe nga dokumentacioni që ekziston është absolutisht e pa mbështetur në fakte. Ky personalizim kishte për qëllim atakimin e integritetit tim personal dhe fizik, linçimin, shtrembërimin e fakteve, ndërsa publikimet e ndryshme në stilin gjumaja e Anton Berishës shprehin një urrejtje personale profesionale dhe me elementet të urrejtjes fetare.

ART dhe unë në raport me përmbushjen e kërkesave të Ligjit, të qytetarëve, të praktikave të mira ndërkombëtare me kompletimin e raportit të katërt që jemi duke bërë për Komisionin Evropian që do të thotë tri të parat i kemi dorëzuar. Jemi duke dëshmuar përparimet e dukshme që janë bërë në Kosovë në sektorin e telekomunikacionit. Pres nga Kuvendi i Kosovës të japë kontributin dhe të ndihmojë në drejtim të veprimeve të dhunshme, respektimin e normave njerëzore të komunikimit, të tolerancës, dhe pres respektimin e praktikave dhe të direktivave evropiane në të cilat mbështetet edhe Ligji i Telekomunikacionit, të obligime që i kemi marrë për të ndërtuar institucionet, si dhe për të ndërtuar një shoqëri dhe shtet të civilizuar. Jam i sigurt që në rrethanat e normalizuara pas një periudhe kohore, kur fjalët e pamatura do të zëvendësohen me matjen e

rezultateve konkrete, do të dëshmojnë kontributin e secilit prej nesh të dhënë në të mirë të zhvillimit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!. z. kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Më lejoni së pari të sqaroj mosprezencën time në seancën e kaluar kur është diskutuar kjo çështje. Gjithë jemi dëshmitarë, kam qenë në atë seancë dhe e kam pasur rendin e ditës para vetes dhe në rend të ditës ka qenë: Shqyrtimi i informatës së ART-së për telefoninë mobile, nuk ka pasur të bëjë absolutisht me debat, as nuk ka pasur të bëjë për interpelancë për tenderin e telefonisë mobile. Por prapëseprapë Qeveria ka qenë prezente dhe unë kam ngarkuar ministrin përkatës, ministrin Qemajl Ahmeti që të jetë prezent dhe ai ka qenë prezent këtu. Po të ishte debat, po të ishte interpelancë, me siguri do të isha këtu dhe mendoj që ne disiplinën e llogaridhënies e kemi dëshmuar që nga fillimi i mandatit tonë. Pra, është kërkuar një informim i ART-së, si institucion i pavarur i zgjedhur nga ky Kuvend dhe jo raport i Qeverisë apo i kryeministrit. Përkundër kësaj, thashë edhe një herë, Qeveria ka qenë prezente.

Para se të sqaroj rolin e Qeverisë në këtë proces, dua të shpreh habinë time për gjuhën që e përdorën disa deputetë në seancën e kaluar përkitazi me këtë çështje, e cila nuk dallon nga gjuha e njëfarë OJQ-je që ditë më parë pa asnjë argument e akuzoi edhe Qeverinë, edhe ART-në, por edhe opozitën për keqpërdorime në këtë proces. Habit fakti se ku mbështeten akuzat dhe këto dyshime të deputetëve në materialin e ofruar nga OJQ-ja. Unë kam besuar që deputetët janë më të përgjegjshëm për akuzat e veta. Ne nuk kemi asnjë raport të auditimit deri më tash. Në përvojën time parlamentare kam marrë pjesë në shumë interpelanca, kam marrë pjesë në shumë debate, por të gjitha kanë pasur fakte, kanë pasur raport të auditit, kurse këtu nuk dinë në çka mbështeten. Ose në thashetheme të organizatës joqeveritare ose në tregimet e miqve të tyre personale ,të pakënaqur me ecurinë e këtij procesi, apo të pakënaqur saktësisht me rezultatin e këtij procesi, por ajo duhet të jetë problem i tyre. Po them që dyshimi që ata mendojnë, plotësisht pajtohem, por kisha pasur dëshirë që ky debat të bëhet në bazë të auditit. Kemi institucionet legale, kompetente, kemi agjencione kundër korrupsionit, kemi auditin gjeneral të cilin për çdo dyshim Parlamenti ka drejtë ta ftojë, ndoshta edhe një agjencion të pavarur.Për çdo gjë, por duhet të kemi fakte të institucionit kompetent, mbi të cilat mbështeten akuzat, dyshimet, shpifjet apo çkado tjetër.Të mos lejojmë të manipulohet edhe Kuvendi edhe ne nga thashethemet, pakënaqësitë private, interesat private etj., etj. Por, sido qoftë, unë çdo moment jam i gatshëm të jap llogari para këtij parlamenti, para qytetarëve për rolin e Qeverisë dhe të marr përgjegjësi për të. Por, përgjegjësi në bazë të fakteve të gjetura nga organet kompetente, e jo nga shoqatat joqeveritare apo nga njerëzit e pakënaqur.

Për këtë arsye, unë jam sot këtu për të argumentuar deri sa nuk dëshmohet e kundërta nga organet kompetente apo nga ky Parlament, se Qeveria i ka respektuar të gjitha procedurat dhe ka qenë aleat me ligjin në këtë proces dhe qeveria këtë proces e konsideron zhvillim pozitiv për Kosovën deri sa nuk ballafaqohemi me fakte të tjera nga organet kompetente .

Më lejoni me pak fjalë ta sqaroj rolin e Qeverisë, mandej do të sqaroj pse ne mendojmë se ka qenë rezultat pozitiv. Më lejoni, gjithashtu, t'ju rikujtoj se kjo është përpjekja e dytë e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile. Kemi pasur një proces, kemi pasur një telenovelë, në të cilën ART-ja e ka publikuar fituesin e tenderit të parë, i cili është anuluar nga organi kompetent, nga organi suprem këtu në Kosovë që sipas Kornizës Kushtetuese, Rezolutës 1244 është UNMIK-u. Përkundër anulimit, e kundërshtimit të UNMIK-ut, i cili ka shprehur dyshimin se procesi ka qenë i parregullt, jemi dëshmitarë të një këmbëngulësie edhe të Qeverive edhe të ART-së që të respektohet vendimi i ART-së. A kemi pasur të bëjmë me një fitues, i cili Kosovës i ofron 6.5 milion euro. Asnjëherë kurrkush nuk e ka sfiduar këtë procedurë, asnjëherë kurrkush nuk ka bërë thirrje që të respektohet autoriteti i UNMIK-ut, por vazhdimisht ka vazhduar tregimi dhe përpjekjet që t'i jepet licenca fituesit dhe Kosova të fitojë vetëm 6.5 milion euro. Asnjëherë nuk është përmendur se duhet të privatizohet Vala 900, as atëherë as deri sot. Ndoshta ekspertët të cilët kanë ardhur në këtë ide kanë qenë në shkollim në atë kohë, nuk e di, por nuk e kanë përmendur. Në të kundërtën, jemi dëshmitarë të gjithë, unë si kryeministër, me sa e sa kritika ballafaqohem nga opozita pse po i shitni asetet kombëtare? Bëjnë thirrje, bëjnë apele të mos shiten, të mos shiten, të mos privatizohen, të mos jepen me koncesion. Këtu shumë zëshëm kërkohet të shitet një aset mbi të cilin Kosova ka monopol deri më tash. Cili vend shet asetin e vet mbi të cilin ka monopol dhe ky monopol që e kemi i ka sjellë Kosovës profit, PTK-ja, Vala 900 nuk janë tani në kompetenca të Qeverisë, por kemi mbi 200 milion euro për banka të Kosovës sot që do të mbeten në buxhetin e Kosovës, sikur ta kishim privatizuar tashti. Prapëseprapë kemi njëfarë ndikimi në PTK, kemi njëfarë ndikimi në Vala përmes AKM-së, e sikur ta kemi një operator privat, çfarë ndikimi do të kishim ne sot?.

Dhe, puna e parë e mirë që e ka bërë Qeveria, është anulimi i vendimit për dhënien e licencës të..... dhe fillimi i tenderit, rishpallja e tenderit për telefoninë mobile. Ndërpritet një agoni, ndërpritet një proces nga i cili humb Kosova, humbin qytetarët e Kosovës e vazhdimisht e kanë vetëm një zgjidhje, vetëm një operator, i cili është pa konkurrencë dhe ofron shërbime të shtrenjta në mungesë të konkurrencës kuptohet dhe Qeveria mori vendim të fillojë ritenderimi i këtij procesi, hap shumë pozitiv i Qeverisë, mendoj.

Më 28 mars, vetëm dy javë pas marrjes nga ky Parlament, shprehëm vendosmërinë që ky proces të jetë, në radhë të parë, i bazuar në standardet më të larta perëndimore, të jetë korrekt, të jetë transparent, të jetë i hapur. Dhe, për këtë arsye, erdhëm në idenë që, fillimisht, para se të shpallet tenderi, të angazhojmë një kompani konsulente ndërkombëtare, e cila ka përvojë të duhur që të na ndihmojë vërtet që përmes këtij tenderi ta dërgojmë një mesazh pozitiv në botë dhe t'i përfillim procedurat më të avancuara të tenderimit. E përmendi z. Berisha, u angazhua kompania STER-kom nga Suedia, e cila së bashku me Ministrinë e transportit ka qenë e ngarkuar që ta përgatisë pakon tenderuese dhe të përcaktojë kriteret dhe metodat e vlerësimit dhe kjo është bërë.

Më 7 korrik 2006 Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit mori vendim për themelimin e Komisionit Mbikëqyrës, d.m.th. vendosëm ta kemi një kompani

konsulente, por edhe një komision mbikëqyrës pa të drejtë vendimmarrjeje, por vetëm komision mbikëqyrës për zgjidhje nga UNMIK-u, nga ART—ja dhe nga Qeveria.

Kompania konsulente u përzgjedh në shtator 2006. Ajo ka bërë përgatitje të tenderëve dhe më 10 tetor 2006 Qeveria e Kosovës mori vendim për përcaktimin e kriterëve për licencimin e Operatorit të telefonisë mobile në Kosovë. Këtu është roli pozitiv i dytë i Qeverisë. Ne në praktikën e këtyre tenderëve, janë dy metoda të tenderimit. Tenderimi me ankand, apo tenderi me një shumë fikse, apo si e quajnë **“Bjuti Kontekst,”** apo metoda e bukurisë së thjeshtë, cila është shumë subjektive dhe me të cilën është përzgjedhur operatori në tenderin e parë të dështuar. Ne u përcaktuam për një metodë të kombinuar, që ta kemi kështu minimalisht 20 milionë, jo 6.5 milionë, por minimalisht 20 milion, dhe atëherë t’i përcaktojmë disa kriterë, kush ofron çmimin më të lartë. Çmimi më i lartë tërheq 30% të pikëve, kurse 30% të tjera mbulesa e territorit, mandej pjesëmarrja e kompanive vendore 100 pikë etj., etj. Kështu, kryesore ka qenë çmimi i ofertuesit që kemi dashur të përfitojë këtë aset, ky aset i vlefshëm që e ka Kosova të shitet sa më e shtrenjtë që është e mundur, dhe kjo është ndërhyrja e dytë, apo e treta e Qeverisë, dhe kjo ka qenë pozitive, jemi dëshmitarë se ka qenë pozitive.

Pas kësaj, deri më 17 janar kompania konsulentë ka punuar në ndihmën e ART-së për të përgatitur pakon tenderuese etj. Jemi dëshmitarë se u dalë pakoja dhe ndërhyrja tjetër e ime si kryeministër i Qeverisë ka qenë, kemi pasur kërkesa që të vazhdohet afati i aplikimit, se disa kompani ende nuk janë gati etj., etj.

Ne kemi kërkuar që procesi të ecë në bazë të procedurave. Çdo ndryshim i procedurave lë mundësi që të ketë dyshime se Qeveria, apo ART-ja, apo UNMIK-u po i krijojnë dikujt hapësirë ,apo po i jep dikujt avantazhe në krahasim me të tjerët, ne nuk jemi pajtuar që të ketë zgjatje të afateve të procedurave.

Mandej, kur është përmbyllur afati aplikimit dhe është caktuar Komisioni vlerësuar, kam kërkuar personalisht nga UNMIK-u që të caktojë, dy anëtarë pa njohur, d.m.th. dy anëtarë në mënyrë të pavarur dhe i ka caktuar UNMIK-u dy vetë, ART-ja dy anëtarë dhe Qeveria një, vetëm një, të Komisioni vlerësues. Qeveria ka pasur një zë, një votë.

Vlerësimi ka filluar, vlerësimi me sa e di, nga anëtari i Qeverisë që ka qenë aty ka qenë individual dhe ajo çka më është thënë, është se të gjitha vendimet janë marrë me konsensus, d.m.th. gjithë anëtarët që kanë qenë nga strukturat e ndryshme e kanë pasur një mendim për këtë. Vlerësimi ka përfunduar dhe ART-ja në bazë të mandatit, në përputhje me ligjin e ka shpallë fituesin e parë. Kontakti im i dytë apo i pari me ART-në ka qenë kur më kanë kontaktuar shefi ART-së, ka gjasa që afati po skadon, ofertuesi i parë i cili u shpallë në bazë të ofertës 81 milionë nuk do ta përmbushë në afatin e përcaktuar. Kemi pasur disa sugjerime që të shtyhet afati 24 orë, 48 orë etj. Prapë intervenimi ynë ka qenë respektimi i procedurës, respektimi i ligjit. Në qoftë se i paguan mirë, në qoftë se nuk i paguan, vazhdo sipas procedurave. Nuk i ka paguar kompania, ART-ja në bazë të kompetencave në përputhje me ligjin e ka shpallë fituesin e dytë.

Përfshirja e radhës së Qeverisë ka qenë kur ART-ja na ka ftuar që të jemi prezentë dhe si Qeveri duhet ta nënshkruajmë edhe ne licencën, dhe është caktuar data, për këtë para se të shkoj. Unë personalisht edhe Qeveria kemi kërkuar konfirmim nga UMIK-u, nga zyra diplomatike në mënyrë që edhe njëherë mos të vijmë në situata çfarë kemi ardhur në tenderin e parë që UNMIK-u të reagojë pasi të nënshkruhet. Më është marrë kohë dhe më është konfirmuar në tri nivele, jo nga një nivel, po në tri nivele UNMIK-u e ka vërtetuar dhe mendon e është i bindur që procesi ka qenë transparent në përputhje me ligjin dhe këtë ma kanë konfirmuar dhe kjo ka bërë që atëherë të shkojë dhe të jem prezent edhe në nënshkrimin e kësaj licence.

Kështu që, duke mos i mohuar të drejtat e atyre që janë të pa kënaqur, tërë kohën i kemi institucionet tona, kemi sistemin ligjor. Unë nuk jam ekspert që të hyjë në detaje, por unë duhet dikujt t'i besoj dhe i kam besuar edhe ART-së, edhe përfaqësuesit tim, i kam besuar edhe UNMIK-ut, edhe atyre që kanë qenë të përfshirë. Dhe sot, sot në këto dokumente e kemi vetëm një dokument zyrtar i cili ka të bëjë me ecurinë e këtij procesi, edhe ajo është letra e UNMIK-ut, të përfaqësuesve të UNMIK-ut që ata dëshmojnë me nënshkrimin e tyre se procesi ka qenë i drejtë, korrekt, transparent dhe ligjor.

Asnjë dokument tjetër nuk e kemi zyrtar që konfirmon të kundërtën. Dhe për këtë arsye po them se ne mendojmë deri në ballafaqimin me faktet e tjera, prapë po e përsëris të një organi kompetent, ne besojmë që ky proces ka qenë i tillë dhe kjo na ka bërë të shkojmë dhe të jemi prezentë dhe të nënshkruajmë këtë. Akuza tjetër që i është bërë Qeverisë atë ditë është se ky proces është shitur me çmim të turpshëm. A është i turpshëm ky çmim i cili po sfidohet sot, apo ai 6.5 milion i cili kur nuk është sfiduar, por e dinë vetë gjithë. Cilin aset Kosova e shiti më shtrenjtë se sa sot këtë? Asnjë. Janë privatizuar asetë shumë të rëndësishme strategjike për Kosovën, ma i shtrenjti Feronikeli 33 milionë. E kemi shitur Llamkosin për 4 ose 5 milion, Grandin për 11 milion, fabrikën e auto pjesëve në Pejë për 3 milion, gjigantë të tërë, kurse sot e kemi shitur vetëm një licencë, edhe manipulohet këtu se disa vende e kanë shitur për qindra miliona. Nuk e kanë shitur licencën për qindra miliona, e kanë shitur kompaninë. Kompania i ka asetet e veta, e ka pronën, e ka infrastrukturën, i ka të gjitha. Kompania e licenca dallojnë shumë. Kështu që në rajon jemi dëshmitarë, Maqedonia e Mali i Zi i kanë shitur licencat 10 pikërisht 16 milion, 16 milion e 10 milion, vendet, fqinjët tanë. Bashkëpunëtorët e mi e kanë bërë një hulumentim. Licenca e shitur te ne është 35 euro për kokë banori. Kurse në disa vende p.sh. në Zvicër është shitur për 20 euro, kurse në Belgjikë, Greqi është shitur për 45 euro, kështu që ne jemi diku në mes Zvicrës dhe Belgjikës me çmimin të cilin e kemi shitur këtë aset, dhe nga ky aset ka përfituar buxheti i Kosovës hiq ma pak se 11% të krejt buxhetit që e kemi, 717 milion e kemi buxhetin, 75 milion i kemi sot në buxhet që e kemi shitur licencën vetëm. Mund t'i shesim edhe pesë, edhe 10 të tilla, sa të vlerësojmë ne, ndoshta pesë e dhjetë jo, por nuk është e përjashtuar që edhe një tjetër ta shesim. Kanë përfituar qytetarët, menjëherë me të filluar, jemi dëshmitarë të gjithë, ka filluar edhe PTK-ja -Vala 900 ta ndijë konkurrencën. E ka rritur numrin e shërbimeve, i ka zvogëluar çmimet etj. Përfitojnë qytetarët, pra. Tani qytetarëve u jepet edhe një mundësi më shumë, edhe një zgjidhje më shumë. Përfiton qytetari të mos zvarritet ky proces që ta ketë edhe një zgjidhje tjetër. Konkurrenca do t'i shtojë shërbimet, do t'i zvogëlojë çmimet dhe

përfiton në anën tjetër buxheti i konsoliduar i Kosovës me 75 milion që për Kosovën nuk janë pak.

Ju faleminderit, unë kaq. Jam për atë që dyshimet të vërtetohen përmes organit kompetent, të ftohet auditi gjeneral, të ftohet guarda de financa, të ftohet kushdo, ndonjë kompani tjetër, por deri atëherë unë nuk dua t'u besoj organizatave joqeveritare, nuk dua. Kam dyshim të plotë në motivin e atyre që i shqiptojnë këto shpifje, akuza në drejtim të Qeverisë, por do ta respektoj çdo fakt të gjetur nga organet kompetente qoftë gjykatat, qoftë auditi gjeneral dhe ju ftoj që mos të hezitoni.

Në fund dua të kërkojë falje, besoj që edhe kryeparlamentari, gjithë e kemi një vizitorë sot, Ministrin e Punëve të Jashtme të Francës, unë kam takim me te 11,30 deri në ora 11,20, do të jem këtu, atëherë kërkojë falje, është zëvendës kryeministri do të vjen dhe ministri përkatës që do të vjen prezentë këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA- Nëse ministri nuk e do fjalën atëherë shkojmë me radhë shefat e partive politike. Z. Gashi e keni fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit. Grupi Parlamentar i LDK-së e njeh, dhe e respekton të drejtën e deputetëve, që përmes procedurave parlamentare të ngritë çështje të interesit të tyre, qoftë partiak, qoftë individual.

Duke nisur nga kjo ne e kemi mbështetur që kjo pikë të jetë në rendin e ditës dhe të informohemi lidhur me ecurinë e tenderimit. Ne si grup parlamentar jemi në dijeni, dhe u konfirmuam nga z. kryeministër që ky është një proces i cili ka përfunduar dhe pas përfundimit të një procesi është e paraparë që të pakënaqurit kanë të drejtë ankese institucionale. Dhe ne nuk e përjashtojmë mundësinë që kjo çështje të shkon në instancat tjera, të trajtohet edhe në gjykatë për çështje të pakënaqura, por ajo çka ne na intereson si grup parlamentar është përcaktimi ynë politik për respektim të plotë të ndarjes së tri pushteteve, të legjislativit, ekzekutivit, dhe gjyqësorit. Ne nuk jemi në mbrojtje të ART-së, por njëkohësisht nuk i pranojmë akuzat blanko cilat janë akuza politike. E mirëpresim informatën e ARR-së, e mirëpresim informatën e Kryeministrit të Qeverisë të Kosovës, dhe jemi të hapur për informatat tjera lidhur me këtë çështje duke respektuar ndarjen e pushteteve.

Nëse opozita nuk është e kënaqur me përgjigjen e Qeverisë, nëse ajo kërkon që kjo çështje t'i nënshtrohet një auditimi, ne do ta marrim në shqyrtim atë kërkesë, dhe do ta mbështesim me përpikëri organizimin ligjore – kushtetues të vendit tonë. Andaj e mirëpresim debatën dhe si grup parlamentar e mbështesim vazhdimin e procedurave dhe kjo çështje nëse shkon në gjyq e presim dënimin e gjyqit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! në emër të PDK-së z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë. Unë edhe një herë dua të them para gjithë këtij auditori në Parlamentin e Kosovës edhe para qytetarëve që sigurisht nëse na shikojnë.

Partia Demokratike dhe unë si kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nuk jemi problem me emra të përveçëm. As të bordit të ART-së, as të Qeverisë, nëse konsiderohet se buxheti i Kosovës nuk ka humbje me këtë form të privatizimit të një resursi për kohën moderne shumë ma vital se Feronikeli, e bile se Trepça, atëherë ne mund të tërheqim të gjitha kërkesat tona. Po për këtë duhet vërtet të na mbushet mendja.

Jemi të bindur se çështja e Kosovës, e buxhetit të Kosovës, e zhvillimit të Kosovës, nuk janë vetëm çështje jona se ndoshta edhe pse kemi investuar dikush ma shumë se dikush tjetër, ajo është e të gjithë fëmijëve tanë që kanë për të jetuar në këtë Kosovë. Edhe jeta e tyre do të varet shumë nga përgjegjësia e institucioneve që kanë zgjedhur dhe do të zgjedhin qytetarët e Kosovës. Unë e dëgjova me vëmendje kryesuesin e bordit të ART-së. E dëgjova me vëmendje edhe kryeministrin e Kosovës z. Agim Çekun. Sot kanë ardhur mirë të përgatitur. Po në seancën e kaluar nuk ishin as njëri dhe as tjetri. Edhe ne po dom tu besojmë. Gjithë atë që e thanë këta. Po edhe një gjë duhet tu sigurojë, materialin e organizatave joqeveritare e kamë pas, më ka ardhur, nuk e kam lexuar dhe kërkesat e mia nuk i kam ngritur mbi materialin e OJQ-së “Qohu”. Të jeni të bindur, nuk e kam lexuar atë material. Po, po i besojmë krejt kësaj që u tha këtu. Unë kisha dëshiruar që edhe mund të kërkojmë ta mbyllim debatin, por vërtet e kam një kërkesë.

Nëse Parlamenti s’paska material të bollshëm për të debatuar, ne i kemi ngritur shqetësimet, që besojnë që janë edhe tuajat, nëse janë edhe tuajat, unë jam i kënaqur. Atëherë kërkesat tona reduktohen në një kërkesë të vetme që të jetë kërkesë e Parlamentit, formimi i një auditori nga një, të bëhet një auditim nga një agjension i pavarur, për të vlerësuar a ishin në rregull, a nuk ishin në rregull gjitha procedurat e tenderimit në të gjitha fazat e tij. Edhe përveç kësaj edhe një odë e veçantë që është në AKM për të vlerësuar se a është bërë një privatizim i mirë ose jo, për të verifikuar ligjshmërinë a është respektuar ligjshmëria, ligjet që i kemi cekur ne në seancën e kaluar dhe vlerësimi të jetë transparent dhe në vlerësim të marrin pjesë nga dy deputetë të partive të mëdha të Parlamentit dhe nga një deputet të gjitha partive të përfaqësuara politike të përfaqësuara në Parlament, dhe mbi bazën e këtyre vlerësimeve mbi bazën e kësaj transparente atëherë le të zhvillohet një debat që dikush po thotë parimor.

Unë edhe një herë ju siguroj që nuk e ngrit akuza se ne nuk jemi as prokurori, as gjyqësi, ne kemi ngritë shqetësime të cilat kërkojmë të verifikohen. Unë kisha dëshiruar që kërkesa ime ose kërkesat e mia, të janë kërkesa të Parlamentit dhe Parlamenti pasi t’i merr përgjigjen nga raportet e auditimeve të organeve që i ceka të zhvillohet një debat mbi bazën e atij ose atyre auditimeve.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, ministra, deputetë të nderuar.

Unë me vete kam marrë një numër të letrave, një tubë të letrave për të treguar seriozitetin me të cilin e kemi shqyrtuar secilën nga dokumentet. Me këtë dua të them se Grupi

Parlamentar Aleancës gjithnjë vendimet e veta, por edhe fjalën e vet do ta bazojë vetëm në faktet, dhe jo në thashethemet. Këtu e kam letrën të cilën duke filluar vetë grupi i deputetëve e kanë iniciuar. Është interesat që z. Limaj ,që është iniciues nuk e ka përmendur asnjë herë sulmin për çfarë thotë ka shfaqur dilema dhe shqetësime opinionin publik. Dhe tjetra konsiderojmë se është konflikt interesave dhe kjo është fakt se jeni menaxher i shitjes në PTK-ë z. Llimaj dhe është interesi.

Më tutje, sa i përket ART-së, janë dy raporte, e para të cilën e kemi pas në seancë, dhe kjo tjetra që ka arritur. Po ashtu edhe letrat të cilat janë dërguar nga përfaqësuesi special gjegjësisht të UNMIK-ut, do të thotë i cili i ka emëruar këta, dhe gjithashtu një pako e tenderimit e cila është në gjuhën angleze dhe zotëri të nderuar po të ishit të interesuar me siguri do ta kishit lexuar me shumë vëmendje. Tani parimi nga i cili nisemi ne është pa tjetër përfitimi për qytetarët. Ky është qëllimi edhe zhvillimi të këtij resori shumë të rëndësishëm, resorit të telekomunikacionit, për zhvillimin ekonomik por edhe mirëqenien e vetë të qytetarëve të Kosovës. Qëllimi është që përfituesit e vetëm me qenë qytetarët e Kosovës, dhe jo individët ose grupacionet e caktuara. Ne i kemi përcjell me vëmendje secilin hap duke filluar jo vetëm nga dokumentet por gjithashtu e dëgjova me shumë vëmendje edhe kryetarin e ART-së z. Berisha, kryeministrin dhe jam i sigurt se edhe ministri është i gatshëm në qoftë se deputetët kanë ndonjë pyetje kanë në ndonjë që të përgjigjet në shqetësimet e juaja.

Të nderuar deputetë.

Projektin e zgjidhjes së operatorit të dytë të telefonisë e konsiderojmë të suksesshëm, sepse oferta është e mirë. Argumenti është se 75 milion është shitur licenca, e jo asetet. Z. Krasniqi, Vala 900 dhe vetë PTK-ja sipas ligjit, ju lexoj nenin 11 thotë se është operator publik dhe si i tillë është nën menaxhimin e AKM-së, prandaj kjo çështje është krejt një çështje tjetër krahasuar me përzgjedhjen e licencës për telefoninë mobile.

Pos këtij çmimi prej 75 milion eurove, është me rëndësi që fitohet një shërbim më i mirë për qytetarët, hapen vende të reja të punës, por edhe zhvillohet teknologjia , favorizohet konsumatori dhe përmirësohet rrjeti. Kryeministri e bëri një krahasim të shitjes së licencë në vendet për rreth në rajon, siç e theksojë në Maqedoni 10 milion, dhe pastaj në Malin e Zi 16 milion është shitur licenca. Tani besoj që mundeni vetë me marrë me mend sa është përfitimi i Kosovës.

Unë e kam një dilemë lidhur me, pse deputetët nuk e kanë paraqitur më herët shqetësimin, 4 muaj është shqyrtuar kjo çështje, 4 muaj ka qenë kohë e vazhdueshme për secilin nga deputetët, por edhe ata të cilët kanë qenë të pa kënaqur me e shprehë shqetësimin e tyre. Ky shqetësim paraqitet mu tani kur është bërë përzgjedhja e kësaj telefonie. Në fund do të them se sa i përket rregullshmërisë së procesit unë do t'i referohem letrës së dërguar PSSP-së Ryker nga përfaqësuesit e UNMIK-ut. Z. Qopke dhe Lemun me 7 shkurt 2007, të cilët kanë shkruar se procesi ka qenë i drejt, transparent, i hapur. Fituesi është zgjedhur në mënyrë të drejtë dhe pa ndikime të paligjshme.

Z. Kryetar, Kuvendi ka obligimet e veta dhe përgjegjësitë e veta, dhe siç e cekëm edhe më herët kolegët e mijë, këto përgjegjësi janë të ndara dhe pushtetet janë të ndara.

Mendoj se Kuvendi e din se cilat përgjegjësi ka, në këtë kontest dëshirojë edhe një herë të theksojë se Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se ky është projekt i suksesshëm, sepse përfituesit janë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! nga **ORA** – Nazim Jashari, vetëm një moment Nazim, replikë, urdhëroni z. Limaj.

DEPUTETI DEMIR LIMA- Z. Sylja, ju përmendët që kinse unë kam konflikt interesash, domethënë del iniciativa ose kërkesa ime se konflikt interesash për shkak që jam në PTK. E nderuar me shumë sinjeritet po ta them. Shumë ma mirë dhe ma qartë dhe ma drejtë është konflikt i interesit për kompaninë publik që është pronë e qytetarëve të Kosovës, se sa këtu që flitet me një pasion shumë të madh për një operator që është i huaj dhe që po hynë në Kosovë dhe ta ka dëmtuar buxhetin e Kosovës. Kryeministër, për 700 milion euro mos e harro. Dëgjo Qeveria e Kosovës nuk ka ndikim në PTK. Qeveria e Kosovës ka 51% të aksioneve, 51% të aksioneve që ke që ke mundur me marrë për buxhetin e Kosovës vazhdimisht duke e forcuar buxhetin e Kosovës, këtu shihet qartë i nderuar Kryeministër pa qëllim të keq, ne asgjë më tepër nuk kemi dashur vetëm që është dashur të shkohet fillimisht me operatorin e parë Vala, dhe tani hape derën të dytit dhe të tretit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! urdhëroni z. Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit! Unë e thashë edhe më herët në fjalimin tim se çështja e privatizimit dhe e menaxhimit të PTK-së janë çështje tjetër, por si duket për kolegët e mi kjo nuk është e qartë. Unë dua të sqarojë.

700 milion ashtu si e ka vlerësuar edhe seancën e kaluar vetë shefi dhe tani z. Limaj, por nuk është licenca, 700 milion nënkupton gjithë infrastrukturën gjithë asetet e PTK-së, dhe prapë e them, çështja e privatizimit dhe çështja e shitjes së kësaj licence është një çështje krejt e ndryshme dhe krejt tjetër, besoj që kolegët tani e kanë mësuar këtë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! urdhëroni z. Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, ministra, të nderuar koleg deputetë. T'ju them të drejtën jam i kënaqur sot që e kemi mundësinë që të diskutojmë në mënyrë më teknike, e më pak politike për një problematik që është ngritur sot në Kuvendin e Kosovës, dhe që është mendoj e një rëndësie të veçantë edhe për mbarë qytetarët e Kosovës.

Fillimisht më lejoni ta shpreh zhgënjimin tim me fjalën e kryetarit të Kuvendit z. Kolë Berisha, i cili premtoi këtu para nesh publikisht që nuk do të ndodhë më të mos shpërndahen letrat që ju vijnë deputetëve, as kësaj radhe nuk është shpërndarë zarfi i OJQ-ës “Qohu” për deri sa përdoret në kontekst pezhorativ kjo fjala OJQ, për mua nuk është kontekst pezhorativ ata janë qytetarë të Kosovës edhe si shoqëri civile kanë

përgjegjësi të veçanta për mbarëvajtjen e jetës dhe funksionimin dhe ekuilibrin e shoqërisë kosovare.

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. Jashari, vetëm një sqarim, ma nuk ka ardhur ajo kërkesë në Kuvend, po të kishte ardhur në Kuvend me siguri do ta kishim pranuar.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Mua më vjen keq, unë në qoftë se ju është dhënë selektivisht ,por në grupin tim parlamentar nuk ka ardhur. Pra, në grupin tim që unë e përfaqësoj ai zarf nuk ka ardhur, dua të ju kujtojë kolegë deputetë që në brendinë e atij zarfi përveç të tjerash ka qenë edhe një shkresë e drejtuar nga një kongresmen i nderuar i kongresit të SHBA-ve i cili ngrit shqetësimet e tij sigurisht në komunikim me një të interesuar për të marrë pjesë në tenderin e telefonisë mobile, ngrit shqetësimet e tij të cilat i adreson te kryeministri i Kosovës z. Agim Çeku dhe njëkohësisht me një CC i adreson edhe te sekretarja e shtetit z. Kondoliza Rajs, pra të kemi të qartë për këtë proces të tenderimit ka të interesuar e më shumë se ne që e mendojmë.

Zonja Sylja erdh me një mori letrash këtu, edhe unë kam ardhur me një mori letrash, disa prej këtyre letrave i kam në kompjuter atje nuk i kam marr me vete, por i kam marrë disa dhe në qoftë se moria e letrave dëshmon seriozitetin e angazhimit dhe seriozitetin e analizës së problematikës atëherë nuk mbes pas zonjës Sylja as në aspektin formal. Po do të përpiqem të dëshmojë që as në aspektin përmbajtjesor nuk mbetem mbrapa z. Sylja, sepse për dallim prej saj unë nuk do t'u referohem informatave përfundimeve, perceptimeve të cilitdo qoftë faktori këtu në Kosovë, qoftë UNMIK, qoftë jo UNMIK që të konstatojnë që ky proces ka shkuar i rregullt. Unë ju kam referuar ligjit dhe vetëm ligjit ju kam thënë këtu një herë dhe po e përsëris edhe një herë se jam fanatik i ligjit dhe si i tillë dëshirojë të më kuptoni dhe të mos më keqkuptoni.

ART-ja nuk është një mollë sherri në Kuvendin e Kosovës, as nuk do të duhej të ishte kurë, e cila do të bënte që deputetët e Kuvendit të Kosovës të ndahen në vija partiake, ART-ja është një agjencion i pavarur, i cili ju përgjigjet të gjithë deputetëve pa përjashtim dhe është i pa varur sipas definicionit nga ndikimet politike. Pra, ai nuk është as i opozitës, as i pozitës, dhe si i tillë pra nuk do të duhej që ky Kuvend të ndahej për ART-në në vija pozitë opozitë.

Te Ligji për Telekomunikacionin i miratuar në Kuvendin e Kosovës z. Kryeministër, thuhet qartë: Neni 4.1 ART-në e themelon ministria, me propozim të ministrisë e themelon në Kuvendi dhe i zbaton politikat e Ministrisë, pra, kjo është ajo që e tha edhe zoti nga ART-ja që ne i kemi zbatuar politikat e ministrisë, shumë e vërtetë, janë politikat e ministrisë të zbatuara nga ART-ja. Në këtë aspekt përgjegjësia për gjitha këto zhvillimet qofshin do të mira, ose të pa mira nuk mundet të shmanget nga Qeveria.

TË gjitha aktivitetet, neni 20.2 i këtij ligji thotë: TË gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë e ART-së duhet të jenë në një mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, fjala transparent besoj që është e qartë për të gjithë ju, por edhe fjala jonë diskriminuese duhet të jetë për të gjithë ju.

Neni 36, që flet për tenderin e dytë të telefonisë mobile z. kryeministër thotë: ART-ja, në mes tjerash. pra thotë: Do ta jap licencën e dytë në pajtim me këtë ligj, me Ligjin për Telekomunikacionin dhe ligjet e tjera aplikative në Kosovë, pra, pse po e theksoj këtë moment. Ligjet tjera aplikative po e theksoj sepse, ligjet tjera aplikative e rregullojnë transparencën, të nderuar kolegë deputetë.

Neni 56 i Ligjit për Prokurimin publik e thotë të qartë e thotë katërçipërisht: Tenderët hapet publikisht, nuk hapem mbrapa perdes. Ne të nderuar kolegë deputetë, i nderuar kryeministër duhet ta kemi një gjë të qartë, nuk ka transparencë ku nuk ka opinion publik. Ata zotërinjtë që e kanë hap atë tender atë ditë, ose që kanë hapur zarfe atë ditë, ata kanë qenë 5 veta. Ne mund tu besojmë fjalëve të tyre që gjithçka ka shkuar në rregull, mund t'i besojmë fjalës edhe të atyre pesë të tjerëve që kanë qenë në komision vlerësues, por ata janë vetëm dhjetë.

Hapja publike nënkupton që mos të ketë paqartësi, të mos ketë dilema, të mos lenë vend për dyshime, e që fatkeqësisht ka lënë vend për dyshime. Tash po ju tregoj pse?

Ju të gjithë e dini që kërkesë bazë e këtij tenderi ka qenë që bashkangjitur me ofertën teknike të jetë edhe një zarf ,që përmban ofertën financiare. Zarfë është dashur të jetë i mbyllur kurse në kuadër të zarfit është dashur të jetë një garancion bankar i parevokueshëm nga ana e kërkuarit dhe i cili e ka vlerën 20% të vlerës së ofertës pra, në qoftë se oferta ka qenë 81 milion, vlera e garancionit bankar është dashur të jetë 16.2 milion euro nga një institucion i besueshëm bankar.

Dhe garancioni bankar të nderuar kolegë deputetë, e ka një kuptim dhe vetëm një kuptim, ai i cili është rrenc, i cili është mashtrues, i cili hyn në tender vetëm me duar në gjepa duhet të dënohet për futjen në këtë mënyrë në proces, dhe kompania e parë e shpallur e cila është shfaqë si e pa “përgjegjshme” po them dhe e cila ka hy në tender pa i pasur “paret”, prapë po e them, ajo është dashur të ndëshkohet me ndaljen e atyre 16.2 milion eurove, sepse, të nderuar kolegë deputetë, oferta prej 81 milion eurosh është marrë për bazë për përpilimin e kritereve për t'i vlerësuar ofertat financiare të tjerëve, kështu shkruan në dokument të tenderit. Oferta më e lartë shërben si masë referente për vlerësimin e ofertave tjera. Oferta e parë ma e larta ka qenë ofertë e pa përgjegjshme, dhe si e tillë ajo është dashur të ndëshkohet me ndalimin e atyre 16.2 milion eurove me automatizëm, sepse atë kompetencë e ka pas në dorë vetëm ART-ja, Ministria e Transportit, dhe Ministria e Financave.

Pse nuk ndodhë kjo? Tash lind pyetja, vetëm dy janë rrethanat të cilat ketë mund mos të ndodhë, në realitet vetëm një, sepse garancia bankare ka qenë e falsifikuar. Ajo nuk ka qenë garanci bankare e vërtetë, prandaj nuk mund të ekzekutohet, nuk mund të arkëtohen paret të cilat janë në një çek falsë, ai është një çek realisht.

Pse ka qenë i falsifikuar, ka qenë i falsifikuar pra, kjo është përfundim i imi i cili më lejon krejt kjo logjikë të cilën unë e shtrojë para jush më lejon me përfunduar që është i falsifikuar, sepse ka qenë i falsifikuar në momentin e fundit oferta financiare e ofertuesit të parë të shpallur fitues, ofertuesit prej 81 milion eurosh, kush e ka bërë atë? I është

dashur dikush ta hetojë këtë procedurë, është dashur dikush ta hetojë edhe atë garanci bankare sa ka pas validitet ose sa s'ka pasur validitet. Ne duhet të funksionojmë vetëm sipas ligjit, dhe ligji e thotë qartë në këtë aspekt se si duhet të procedohet tutje. Prandaj, dyshimet kanë mbetur se nuk ka pas hapje publike, kurse në dokumentacionin e tenderit thuhet diku te pika 4.1 të dokumentacionit thuhet . **“Inishell konsiderejshën”** e kam lexuar me shumë kujdes, pra gjykimi nismëtar i cili bëhet pa krahasime, që nënkupton vetëm hapjen dhe shqyrtimin e përmbushjes formale të kërkesave të tenderit. Pra, a janë të gjitha kërkesat që parashtrohen sipas procedurës , a është zarfi me dokumentin financiar, a është aty garancioni bankar, pa krahasime ai është dashur të bëhet në mënyrë të hapur dhe të hiqen të gjitha dilemat nga procesi, nuk është bërë në mënyrë të hapur, është bërë në mënyrë të fshehtë, është bërë prapa perdes, dalin fjalë, dalin akuza sepse njëkohësisht nuk është respektuar ligji i cili e thotë qartë që hapja, neni 56 i Ligjit prokurimit publik thotë që duhet bëhet në mënyrë publike.

Z. kryeministër unë shumë e besoj që ju jeni të sinqertë në atë që e proklamoni këtu, që jeni të kënaqur me tenderin, tenderi nuk është shumë e vogël 75 milion euro, nuk është i vogël, por nuk është thelbi aty, thelbi është te transparenca, te shanset e barabarta. Edhe thelbi është te mundësitë e keq menaxhimit keq përdorimit, e abuzimit me detyrën, këtu është çështja nuk ka kush tjetër kush të interesohet për këtë problematika, në qoftë se nuk interesohet Qeveria, në qoftë se nuk interesohet Kuvendi dhe për ta hequr çdo dilemë mendoj që transparenca e munguar është ajo fajtorja kryesore, po të kishte pash transparenca këto fjalë kishin me qenë të tepërta. Ne të gjithë do të kishim qenë të kënaqur me këtë zhvillim.

Tash dua të dal te një çështje tjetër e cila po ashtu mban me dyshua. Te seksion B. ... informata mbi aplikuesin thotë: përveç informatave standarde do të duhej të përmbajë, informata mbi strukturën e pronësisë së aplikantit së konzorciumit aplikues, përshkrimin e plotë të aksionarëve dhe informatave tjera relevante për të vlerësuar çështjet lidhur me relacione të ngushta të mundshme, pse po e përsëris dhe po e theksoj këtë. Të nderuar kolegë deputetë, e kam këtu një informacion zyrtarë për regjistrimin e biznesit nga regjistri i biznesit në Kosovë ku flet që njëri aplikant në këtë tender ka qenë i përfshirë në dy konzorciume. Tash si është e mundur kjo? Është e mundur edhe pse ndalesa është e qartë në krye të tenderit thotë që asnjë aplikant nuk mund të jetë i ndërlikuar në dy ofertime.

Numri i biznesit 70354394 është një kompani vendore e cila është regjistruar me 5.3.2006 me kapital fillestar prej 1 milion eurosh nga dy aksionarë, njëri shloven dhe njëri vendor, të mos ia përmendi emrin se kam reagime edhe nga dega e partisë time në Pejë.

Shoqëria aksionare e themeluar me këtë datë është me emrin çuditërisht me emrin e konzorciumit që është shpallë së pari fitues në Kosmocel. Nuk është e njëjta, mos u habitni, Kosmoceli shoqëria aksionare është firmë e regjistruar në Kosovë, kurse Konzorciumi kandidues, garues, për frekuencën e telefonisë mobile është diçka tjetër, ai përbëhet prej tjerëve përbërës. Ku qëllon ndërlikohja përmes këtij Kosmoceli që është firmë vendore dhe këtij Kosmocelli që është konzorcium, ndërlikohja është

Në rregullore z. kryesues shkruan shumë qartë, në qoftë se është me interes publik mund ti zgjatet fjala diskutuesit dhe në qoftë se

Polemikë

Interes më të madh publik sesa të ndriçohet e vërteta lidhur me këtë tender unë nuk shohë sot edhe në këtë moment. Ju mund të ma merrni fjalën por ju kisha lutur sinqerisht që të më lejohet ta përfundoj se pse është shumë me rëndësi ta dinë qytetarët e Kosovës procesin se si ka shkuar ky tender.

Njëri pjesëmarrës, njëri aksionar i kompanisë së regjistruar në Kosovë me datën 5.3.2006 ka qenë në konzorciumin e parë të shpallur fitues, në konzorciumin e parë pra, kurse aksionari tjetër është në konzorciumin e dytë të shpallur fitues. Këtu e kemi ndërlidhjen edhe konfliktin total të interesit edhe shkeljen totale të procedurave. Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, unë ju kisha lutur, po e përsërisë edhe një herë që e thash. Kompania Austriake ka me fituar gjyqin, 100 milion euro kanë me dalë prej buxhetit të Kosovës, minimumi, nuk kanë me hyrë 75 milion euro.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! për replikë deputetja GJylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Vetëm shkurt sa i përket ligjshmërisë, Edhe në seancën e kaluar unë e kam cekur që Grupi Parlamentar i Aleancës gjithmonë bazohet në ligjin, edhe kam lexuar bile disa nene të ligjit, dëshiroj t'ia kujtoj deputetit, ndërsa sa i përket transparencës mendoj që nuk e ka të qartë nocionin. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Kundërreplikë ka Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Transparenca është një fjalë e cila po përdoret shumë hapur, shumë gjerësisht sot, e cila nënkupton shikueshmëri, tejdukshmëri dhe nuk di që ka kuptim tjetër. në këtë rast e kemi fjalën për një tender pas perdes aty transparencë nuk ka.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! në emër të Grupit Parlamentar 6+ Mahir Jagcilar

Sayın başkan, bakanlar ve milletvekilleri

Po faleminderit zç Kryesuesç

6+ Parlamenter Grubu, İkinci telefon operatörü için ihale süreci konusundaki gelişmeleri özenle takip etmiştir. Bu olay, Kosova vatandaşları için özel önem taşımakla birlikte, yabancı yatırımlar için ise ilginç bir alandır. Öyleki bu sürecin başarılı olarak sonuçlanması, Kosova'nın uluslararası saygınlığı itibariyle beraber çok önemli bir olaydır. Kosova bugün riskli ve tarihi bir dönemden geçmektedir, dolayısıyla bu ve benzeri süreçler, özellikle telefon operatörü alanında uluslararası ihale gibi bu kadar önemli ve kapital sermayeyi gerektiren süreçler, Kosova'nın geleceğini önemli ölçüde

etkileyebilir. Yabancı yatırımları ve yatırımcıları çakmek ve özendirmek istiyorsak, ihalenin her sürecinde etkili ve halka açık olmalıdır, çünkü yabancı yatırımcılar karşısında güvenilir ve ilgi çekici intibasını yaratılmış olcağızdır. Malesef ikinci telefon operatörü için ilk ihale süreci başarısız olarak tamamlandı ve ne yazık ki sorunsuz ve şikayetsiz geçmeyen yeni bir ihale sürecinin başlaması için 3 yıl beklemek zorundaydık. Bu kez, söz konusu sürecin halka daha açık olması ve daha örgütlü faaliyetine rağmen, ihale listesindeki ilk kazanan operatörünün ihaleden vaz geçmesiyle, listede bulunan ikinci şirkete devredilmesi gibi istenilmeyen olaylara tanık olduk.

Dolayısıyla kalifiyeli sahipleri, gereken evraklara sahip miydi, onların gereken mali garantileri var mıydı, listeye katılmak için depozito ne kadardı, süreçten vaz geçme durumlarında depozitolar geri çevrilmeli miydi, ART temsilcileri, ihale koşullarını yerine getirmek için şirketlerin gerçekten mali ve teknik açıdan hazır olup olmadığını değerlendirebilecek durumda mıydı ve buna göre listeyi adaletli bir şekilde oluşturabilecek durumundaymıydılar gibi sorular ortaya şıkmaktadır. Diğer yandan Kosova dışında yani farklı ülkelerin ad yapmış medya araçlarında bu ihalelere zamanında ve uygun bir şekilde yer verildi mi diye soruyoruz.

Maalesef bu dönemde, Telekomunikasyon Yasası'nda da bazı eksiklerin var olduğunu sezdik, ancak bugüne kadar bunu ne hükümet ne de ART gündeme getirmedi. Hükümet ve ART temsilcileri arasında koordinasyonun eksik olduğu bir gerçektir. Bundan başka, Bakanlık ve ART temsilcileri arasında da işbirliği düzensiz olduğu belli. Tüm bu olgular bulunduğumuz durumun aynasıdır, ancak Kosovanın saygınlığı ve Kosovada ihale süreçleri hakkında genel izlenim lekelenmeden durumu atlatmak zorundayız. Kosovanın, yatırım alanında istikrarsızlığın hüküm sürdüğü ve garantilere yer verilmediği, Yasa üstünlüğünün gereken seviyede olmadığı gibi bir ülke izlenimine düşmesine izin vermemeliyiz.

Bundan dolayı, ihaleler ve bulunduğumuz durumun sorumluları konusunda Hükümetin son sözünü söylemesi gerekir. Sorun Yasa hükümlerinden kaynaklanıyorsa, bu durumda Yasanın değişmelere tabi tutulması için Kosova Meclisinde acilen gündeme alınmalıdır. Eğer bunun nedeni bireylerden kaynaklanıyorsa, bu kişilere karşı gereken önlemlerin alınması kaçınılmazdır. Diğer taraftan Hükümet, bakanlıklar ve ART arasında yasal işbirliğinin, görevler ve sorumlulukların hayata geçirilmesi gerekir ve böylece, süreçteki bütün etmenlerin, yapılması gereken görevlerin ve yetkilerin tam olarak saptanmasıyla birlikte, adaletli işbirliğini kısıtlayan tüm engellerin ortadan kaldırılması gereklidir.

Parlemnter grup olarak, ortaya atılacak değerlendirmeler, gerçeğe ve delillerden sonra, bu süreçle ilgili son düşüncelerimizi elbette biz vereceğiz.

Dikkatinize teşekkürler

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryesues. Mendoj se të gjithë pajtohemi se joshja e investimeve të huaja në Kosovë është me rëndësi strategjike për të ardhmen e vendit tonë. Jemi duke e shqyrtuar një prej këtyre proceseve, dhe jemi dëshmitarë të asaj se paraqiten argumente dhe kundër argumente lidhur me disa paqartësi të themi ashtu dhe ndoshta edhe keq përdorime gjatë këtij procesi.

Në mënyrë që të hiqen të gjitha dyshimet të gjitha hipotekat e dyshimeve mbi këtë proces i cili është edhe në llupën e faktorëve relevant ndërkombëtar Grupi Parlamentar për Integrim pas shqyrtimit të informatës plotësuese të autoritetit rregullativë të Telekomunikacionit dhe dëgjimit me kujdes të fjalës z. kryeministrit dhe kryetarit të Bordit të ART-së është i mendimit që Kuvendi i Kosovës të ftojë auditorin e përgjithshëm të Kosovës për një auditim urgjent të kësaj çështjeje, dhe lidhur me këtë të përgatisë një raport i cili do të jetë subjekt debatit në këtë Kuvend. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputetë. I dëgjuat do të thotë e ekspozetë të shefit të ART-së, kryeministrit, pastaj shefat e grupeve parlamentare. Kemi propozimin konkret pra që del nga vetë propozuesi i kësaj pike të rendit të ditës, e tha z. Demir Limaj në fillim, pastaj shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së u mbështet nga Grupi Parlamentar i LDK-së z. Alush Gashi, para tij e tha si e dëgjuat Grupi Parlamentar i LDK-së pranon çdo lloj auditimi ,verifikimi të ligjshëm. Ishte propozim edhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim. Mendoj se duhet të marrim një pauzë që shefat e grupeve parlamentare të merren vesh, ose të qesim në votim, pra kjo ishte kërkesë e shumicës së shefave të grupeve parlamentare, që ky debat të përfundon me kaq, të thirret auditori i përgjithshëm, dhe në bazë të atij auditit pastaj rezultateve dhe fakteve që i bien ai audit ,pastaj të debatohet në Kuvend. Mendoj a ka nevojë pauzë apo po e qesim në votim, dhe pastaj vendosim për rrjedhën e mëtejme.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Vazhdojmë me punimet e seancës plenare. Pauza ishte që shefat e grupeve parlamentare të koordinohen edhe me grupet e tyre parlamentare, por edhe në mes veti se si do të jetë rrjedha e kësaj seance. Për fjalë janë të paraqitur 10 deputetë në qoftë se vazhdohet debati.

Për këtë pikë të rendit të ditës 10 deputetë janë të paraqitur. Unë ftoj shefin e Grupit Parlamentar të LDK-ës ta marrë fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryesues. Ne kemi mbështetur kërkesën e një grupi deputetësh që të shqyrtohet raporti i ART-ës Ne dëgjuam raportin e ART-ës dëgjuam një informatë shumë të detajuar nga ana e z. kryeministër dhe ne zotohemi për mbështetje të një transparence të plotë të vazhdimit të këtij procesi. Palët e pakënaqura kanë mundësitë ligjore që t'i shprehin ankesat e tyre në instanca tjera. Ne gjatë këtij debati e në veçanti pas fjalës së kryeministrit të Qeverisë së Kosovës nuk kemi vend për dyshim, por ne nuk na pengon nëse cila do instancë e sistemit tonë, duke përfshirë edhe grupet e tjera parlamentare kërkojmë të bëhet një auditim ne do ta dëgjojmë auditimin do të marrim pjesë në debat lidhur me te, por në këtë fazë ne nuk kemi elemente të dyshimit. Nëse të tjerët e kërkojnë ne mirëpresim. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Jakup Krasniqi e ka fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. Kryesues, ne e shfrytëzuar pauzën për të biseduar për çka më tej si Grup Parlamentar dhe me të drejtë vërejtjet e grupit parlamentar janë në fjalën e kryeministrit ,që në vend se të sqarojë përgjegjësinë e vet ai akuzoi të tjerët për konflikt interesi dhe për forma të tjera. Kështu që sa i përket raportit të ART-ës Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka dhënë fjalën e vet, kërkon një auditim të përgjithshëm, auditorin e përgjithshëm dhe kërkon nga Kryesia që ta bëjnë ftesën për auditorin e përgjithshëm dhe mbi bazën e auditorit të përgjithshëm të dihen përgjegjësitë e secilit në këtë proces.

Kurse deputetët e Partisë Demokratike dëshirojnë të debatojnë mbi bazën e fjalës së kryeministrit të Kosovës.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputetja Gjylnaze Sylja

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryesues. Ashtu siç e thashë në fillim ne bazohemi në fakte dhe argumente, me qenë se ne nuk kemi gjet as fakte as argumente ose indikacion për thirrjen e auditorit nuk mund ta bëjmë këtë. Prandaj në qoftë se propozuesi do ta bëjë atëherë i përcjellë të gjitha procedurat që duhet. Nuk mundem me u mbështet në përshtypje subjektive. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Po deputeti Jakup Krasniqi, shef i Grupit Parlamentar të PDK-ës, e keni fjalën z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues, ne nuk kemi pasur për detyrë si deputet me mbledh fakte, prandaj ajo që e thotë shefja e Grupit të Aleancës vërtetë është papërgjegjësi e madhe. Ne kemi ngritë shqetësime, faktet duhet t'i mbledh tjetërkush, deputetët nuk mbledhin fakte, nuk bëhen prokurorë, nuk bëhen hetues, nuk bëhen gjykatës, por ata i ngrisin shqetësimet e tyre. Prandaj pasi deputetët e Partisë Demokratike kërkojnë debat për fjalën e kryeministrit që mendoj ishte e papërgjegjshme, unë kërkoj që të bëhet pauza e drekës dhe pas të vjen edhe kryeministri të vazhdon debati.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Krasniqi. Nazim Jashari në kartelë të Teuta Sahatqisë.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar ORA është gjithmonë për debate në parim. Ne fundamentalisht përkrahim çdo kërkesë për debat. Prandaj në këtë aspekt përkrahim kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-ës që debati të vazhdojë, por sigurisht në praninë e kryeministrit, duke qenë njeriu kryesor përgjegjës për mirëvajtjen e këtij procesi. Mendoj se në fund rekomandimi do të duhej të ishte i qartë që ky proces duhet të hetohet në mënyrë të pavarur nga ekspertët për të konstatuar shkeljet e ligjit. Kjo është ajo e cila do ta bënte besoj të kënaqur pastaj edhe shefin e Grupit Parlamentar të AAK-ës edhe të gjithë të tjerët në këtë sall që janë hezitues dhe dyshues lidhur me faktet që unë i parashtrova më herët në foltore.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Gjylnaze Syla, replikë, vetëm një minutë të lutem.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryesues. Nuk është çështja as nuk jam unë tema, tema dihet cila është, prandaj i referohem deputetit Nazim Jashari që nuk jam unë në pyetje, është në pyetje procesi i tenderit dhe kërkesa të cilën e ka shtrua grupi. Ne qëndrojmë prapë në bazë ta asaj çka është e ligjshme. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Në këtë situatë ne kemi kërkesa, sa mujta unë me i identifiku kësi soji. Grupi Parlamentar i PDK-ës kërkon debat në fjalën e kryeministrit, ashtu unë e kuptova do të thotë, reagim në fjalën e kryeministrit. Kryeministri nuk është këtu prezent.

Grupi Parlamentar i PDK-ës e konsideron të drejtë veten me iniciua procedurën e auditimit përmes Kryesisë, edhe kjo është në rregull Kryesisë së Kuvendit, shkon në procedurë të rregullt.

Kemi vetëm një kërkesë deputeti Emrush Xhemajli që ka kërkesë të marrë fjalën për shkak se nuk është anëtarë i grupeve parlamentare, nuk bënë pjesë në grupet parlamentare është deputet i partisë Lëvizja Popullore e Kosovës, urdhëroni z. Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryesues, zotëri qeveritarë, të nderuar zonja dhe zotërinj, të respektuar të pranishëm. Qe tetë vite Kosova, në Kosovë po sundon monopoli fushën e telefonisë. Sot Kosova vazhdon t'i ketë çmimet më të larta të komunikimit telefonik dhe krejt kjo është duke ndodhur sepse kjo çështje u pa që është duke u përcjellë nga parregullsi që nuk ka si ndodh ndryshe në Kosovë edhe për shumë vite por mbi të gjitha është duke u përcjellurë nga një politizim i skajshëm nga i cili për interesa ngushta politike po humbin qytetarët e Kosovës.

Ndërhyrjet politike nuk ndihmojnë në këtë drejtim, ne duhet t'ia lëmë fjalën konkurrencës që përmes saj të seleksionohen, përparohen apo të eliminohen subjektet. Logjika kundër konkurrencës dhe privatizimit është duke u treguar bllokuese dhe pa efekt. Alternativa të tjera nuk janë sa të mundura. Unë kërkoj që sa më parë të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me ART-ën dhe të filloj sa më parë punën operatori i dytë i telefonisë dhe të vazhdohet me operatorin e tretë. Kjo konkurrencë do të lironte çmimet shumë, shumë të larta të komunikimit në kohën kur qytetarët e Kosovës kanë të ardhura skajshmërisht të ulëta. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputetë. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë dhe ju ministra. Prej ditës së premte kur në rend dite kishim shqyrtimin e informatës së ART-ës lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë e cila agjendë po vazhdon edhe sot. Kërkesa e një grupi të deputetëve ka evaluuar skajshmërisht

Fillimisht atë ditë është kërkuar që të përjashtohet kryeparlamentari nga kryesimi i seancës parlamentare. Më pastaj është kërkuar të largohet edhe anëtari i Kryesisë së Parlamentit të Kosovës ,sepse kinse ai po i sugjerojka ati se si ta udhëheqë seancën. Më pastaj prej shqyrtimit të informatës së ART-ës është kërkuar edhe anulimi i vendimit për zgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile. Më pastaj është kërkuar edhe shkarkimi i bordit i ART-ës, më pastaj është kërkuar të bëhet evaluimi i tërë procesit të tenderimit. Ani pse në rend dite kemi pasur për objekt raportimi vetëm vendimin për përzgjedhjen e operatorit të dytë si fazën përfundimtare të tërë procesit të tenderimit.

Dhe sot doli si kërkesë formimi i auditorit për vlerësimin e tërë procesit i cili vlerësim që është e vërteta është bërë nga një komision ndërkombëtar i përbërë prej dy anëtarëve i cili ka raportuar Përfaqësuesit Special Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sido që të jetë këto janë lojëra të ndyta dhe janë kërkesa të cilat donë ta zvarrisin procedurën që në Kosovë të fillojë së vepruari operatori i dytë i telefonisë mobile. Sot është dash të diskutoj apo të filloj operatori i tretë por për shkak të këtyre lojërave jemi ku jemi akoma nuk ka përfunduar procedura e operatorit të dytë.

Unë nuk dua të debatojë për një material që është futur në mënyrë klandestine në **fjokat** tona, siç diskutuan disa deputetë, por dua të diskutojë për atë që Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka vu në rend të ditës. Pra, me që objekt raportimi është vendimi mbi përzgjedhjen e operatorit të dytë të gjitha kërkesat e mëtutjeshme evoluimet që janë bërë por edhe diskutimi lidhur me fjalën e kryeministrit janë kërkesa të reja dhe le t'i nënshtrohen procedurës së rregullt parlamentare. Sot diskutojmë vetëm për rendin e ditës.

Nga kryesuesi i ART-ës kemi marrë raportin me shkrim dhe sot patëm rastin edhe të dëgjojmë edhe raportin me gojë të cilit raport me shkrim i është bashkëngjitur dokumentacioni përkatës e që lidhet me përzgjedhjen e operatorit të dytë, prej askujt nuk është kontestuar dokumentacioni që është ofruar nga kryesuesi i ART-ës.

Në diskutimin e disa deputetëve në seancën e kaluar dhe sot dëgjuam shumë akuza dhe parregullsi nëpër zgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile të adresuara kryesuesit të ART-ës ndër të cilat pati edhe akuza për korrupsion e çka jo tjetër. Këto akuza vinë pas atentatit që u është bërë kundër kryesuesit të ART-ës pak kohë pas shpalljes së fituesit të tenderit, i cili atentat është bërë nën dritën e diellit, që i ka mundësuar këtij që ta shoh atentatorin ndaj edhe është nisur procedura hetimore për kapjen e atentatorit.

Dëshiroj të them se akuza që i bëhen kryesuesit të ART-ës janë të paargumentuara dhe si të tilla janë të pabazuara. Akuzat e tilla do të ketë gjithmonë, sa herë që do të ketë tender për operatorë të ri të telefonisë mobile sepse dihet mirëfilli se nuk mund të shpallen fitues të gjithë ofertuesit por vetë një, ai me kushtet më të mira dhe nuk është rast i parë që të shpallet fitues ofertuesi i dytë, ne kemi pas shumë raste nga AKM-ja kur është shpallë fituesi i dytë në tenderët kur fituesi i parë është tërhequr apo në një farë mënyre nuk i është përmbajtur rregullave të lojës.

Mirëpo, të pa kënaqurit kanë të drejtë kundërshtimi përkatësisht kanë të drejtë të nisin kontest administrativë siç është vepruar edhe në rastin konkret ndaj, nuk gomojnë t'i paragjykojnë gjërat apo të ndikojnë në gjykata me akuza çfarë po i dëgjojmë sot në këtë parlament ,sepse diskutimet tona deshëm apo s' deshëm në një farë mënyre do të ndikojnë në vendimin e gjykatave.

Sa i përket korrupsionit t'ua lëmë këtë që me te të merren organet e ndjekjes dhe nëse dikush është i korruptuar e bajt me shëndet le të përgjigjet.

Por Parlamenti nuk është organ i ndjekjes dhe nuk mund të akuzojë dikend për korrupsion apo të verifikoj nëse dikush është i korruptuar apo jo, për ato edhe ekzistojnë ndarjet e pushteteve, me ndjekjet merren organet gjyqësore si pushtet i veçantë gjyqësor.

Në Komisionin për përzgjedhjen e operatorit të dytë të përbërë prej pesë anëtarëve vetëm një anëtar ka qenë i ART-ës e jo i tërë bordi i ART-ës siç pretendohet të shtrembërohet ky fakt në debatin që është zhvilluar ditë më parë dhe në debatin që është zhvilluar sot.

Bordi i ART-ës as që ka marrë pjesë në vendimmarrje këtë patëm rastin ta dëgjojmë edhe sot nga kryeministri edhe nga vet kryesuesi i ART-ës. Në Komisioni mbikëqyrës të pakos tenderuese, gjithashtu ,ka marrë pjesë vetëm një anëtar i ART-ës e jo bordi. Në Komisionin vlerësues të cilin nuk e ka emëruar ART-ja prej pesë anëtarëve dy kanë qenë të ART-ës po kështu në Komisionin Mbikëqyrës prej pesë anëtarësh i cili ka aprovuar rezultatet e Komisionit vlerësues bordi i ART-ës nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes.

Më tutje në shkresën dërguar PSSP-ës Komisioni Special për Mbikëqyrjen dhe Monitorimin e tërë procesit tenderues për operatorin e dytë të telefonisë mobile në Kosovë datë 7.2.2007 i përbërë nga anëtarët ndërkombëtarë SHopk dhe Lemon midis tjerash i ka shkruar PSSP-ës edhe këtë citoj. Ne jemi të sigurt se procesi i tenderit për përzgjedhjen, pra për përzgjedhjen për atë që po diskutojmë, e operatorit të dytë të telefonisë mobile është tërësisht i suksesshëm. Në praninë e të gjitha këtyre fakteve vërtet habitem si mund të akuzohet aq rëndë dhe pa forcë të argumenteve bordi i ART-ës përkatësisht kryesuesi i saj se është i korruptuar që në favor të fituesit të marrë vendim për përzgjedhjen e operatorit të dytë çfarë është marrë, kur në asnjë fazë procesit të tenderimit nuk ka marrë pjesë në vendimmarrje as bordi e as kryesuesi i ART-ës.

Sa i përket propozimit për anulimin e vendimit mbi përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë ju përkujtoj se ky parlament nuk e ka mandatin ta anulojë atë vendim sepse sipas Kornizës Kushtetuese pushtetet siç e ceka janë të ndara dhe këtë parim duhet ta respektojmë.

Nga ana tjetër neni 11.8 i Ligjit 2002/7 për telekomunikacionin parasheh se aktet dhe vendimet zyrtare të ART-ës do të shqyrtohen nga gjyqet dhe do të jenë subjekt i çfarëdo apelimi, pra palë në procedurë gjyqësore, nga palët e pakënaqura sipas rregullave të procedurës administrative.

Dhe në fund ART-ja gjatë procesit të tenderit ka vepruar në harmoni me nenin 36 të Ligjit mbi telekomunikacionin që obligon ART-ën të ketë koordinim të ngushtë me UNMIK-un sa i përket lëshimit dhe askush nuk mund të ndërmerr ndonjë veprim jashtë kornizave ligjore, sipas këtij neni ART-ja nuk e ka mandatin ta përgatit pakon tenderuese, ta shpallë tenderin për operator telefonisë mobile por dikujt po i konvenon tej zgjatja e paraqitjes së operatorit të dytë mobile këtu në Kosovës për të cilat arsye unë i di, por nga e gjithë kjo që ceka më sipër unë e mbështesë në tërësi raportin e kryesuesit të ART-ës dhe kundërshtoj propozimin për anulimin edhe për auditimin e propozuar sot.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Unë jam i obliguar të jap një sqarim për letër klandestine që u përmend këtu, jo është letër që u dorëzua zyrtarisht në Sekretari të Kuvendit, mirëpo t’i njoftojë deputetët që deputetët nuk e kanë marrë të gjithë për shkak se ju ka dërgua që ku është lista e deputetëve të cilët e kanë marrë atë letër por ajo është regjistruar në Kuvend të Kosovës që kanë të drejtë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe disa deputetë që nuk e kanë marrë z. Nazim Jashari pra, janë lista vetë organizata “Qou” e ka përzgjedh emrat e deputetëve.

Replikë nuk e di që ju ka përmend emri dikujt por urdhëro Jakup Krasniqi e ka fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Unë do të përgjigjem në pse i kemi reduktuar kërkesat. Fillimisht dua të them me profesion nuk jam avokat edhe se kam zgjedh atë profesion se duhet ta mbrosh edhe dreqin edhe të birin. Po kjo është një çështje tjetër. E keni reduktuar kërkesat tona me kërkesën e shefit të bordit të ART-ës me kërkesën e kryeministrit për shkak të gatishmërisë së tyre për tu përballur me një auditim të përgjithshme me profesional. Prandaj, ne mendojmë që vetë caktimi ose kërkesa e parlamentit për t’u bërë një auditim i përgjithshëm profesional në të gjitha procedurat e tenderimit konsiderojmë që e suspendon vendimin që e ka bërë dhe e nënshkruar Qeveria e Kosovës.

Unë po ju përkujtoj edhe kisha dëshiruar që përfaqësuesit e bordit të ART-ës ta japin një përgjigje para këtij parlamenti, cilën ajo është. Kërkoj që ta shpjegojë ligjin kush me ligj, me ligjet në fuqi e ka pas të drejtën ta nënshkruaj vendimin për dhënien ose për licencimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile. Kjo është një kërkesë e imja shtesë. Prandaj ju kisha lutur që nëse debaton mos akuzoni.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Replikë Nekibe Kelmendi e keni fjalën.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Nëse i konsideron që i kam mbrojtur dreqin e të birin, ia përkujtoj që i kam mbrojtur edhe kolegët e tij të luftës, Grupin e Llapit. Vetëm kaq.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Z. Jakup Krasniqi kërkoi pyetje për kryetarin e ART-ës Anton Berisha.

KRYETARI I ART-ës ANTON BERISHA – Faleminderit, mendoj që përgjigja në kërkesën dhe gatishmëria që auditor të pavarur ekspertizë për ne jo vetë që është e mirëseardhur, por është edhe obligim ligjor. Aty ka një nen i cili kërkon prej ART-ës që

ta angazhoj çdo vit auditor të pavarur të cilët shqyrtojnë punën e këtij organi. Ky dispozitë është nxjerrë prej legjislacionit evropian sepse ne në bazë Ligjit për telekomunikacionin është mbështet në direktivat evropiane të 98-tës. Prandaj ne kemi obligim ligjor që të jemi të hapur ndaj auditimit dhe unë e mirëpres çfarëdo ideje që aty të shqyrtohet jo vetëm çështja e operatorit të dytë po e gjithë puna e institucionit sepse ky institucion për fat të keq është bërë peng i tenderit për tri vite, por roli i institucionit është shumë më i gjerë ka shumë punë, ka shumë për çka për t'u bërë në të mirë të zhvillimit sektorit të telekomunikacionit. Po ashtu u përmend dhe e përkrahu plotësisht që Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe nëse kërkohet edhe ne si ekspertë punojmë së bashku me përshtatjen e ligjit konform pakos së re tash evropiane 2003 dhe ky Ligji duhet sa më shpejtë procedohet, në mënyrë që t'i përshtatet shpresojmë statusit të ri kur do të ketë kompetenca të reja dhe kur do të shkojmë në një udhëheqje tipike profesionale dhe kur puna e këtij organi mos të jetë më pjesë e diskutimeve politike por të pastra profesionale.

Autoriteti Regullativ ka obligim që auditorët të jenë vazhdimisht dhe unë e mirëpres atë ide. Sa i përket nënshkrimit, nënshkrimi se është përmendur nuk do të marrë shumë kohë. Ka një përshtjellim nëse muj me thanë, mes neneve 20 dhe 36. do të thotë Ligji për telekomunikacionin i jep Autoritetit Regullativ një kompetencë të gjerë për gjithë sektorin e telekomunikacionit në parim. Mirëpo ligji ka kufizuar vetëm një rast dhe ky rast është operatori i dytë. Do të thotë për operatorin e dytë është futë një nen i veçantë në 36 mënyrën e menaxhimit dhe të udhëheqjes së tij procesi, pra ky proces është udhëheq në koordinim të ngushtë me PSSP-ën dhe në drejtën e Ministrisë për të përgatitur pakon tenderuese dhe këtu është kufizua me ligj kompetenca jonë. Për ndryshe në parim ky ligj sikurse të gjitha legjislacionet evropiane atje ku krijohet një institucion rregullator ai është kompetent për të nënshkruar të gjitha marrëveshjet, sepse në fund të fundit, pika 11.2 u përmend ajo palë, kanë të drejtën e inicimit konfliktin administrativ ndaj organit në fjalë respektivisht ART-ës. Prandaj çdo nënshkrim është obligim ligjor i imi dhe ndoshta ai perceptim se nënshkrimi ka ardhur edhe te perceptimi i gabuar se çdo gjë është vendosur nga një person, ndërsa këto procese janë shumë komplekse.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka ministri, Qemajl Ahmeti.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Faleminderit z. kryesues. E ndjeva obligim vetëm sa i përket Ligjit të telekomunikacionit që u përmend edhe z. Mahir edhe tash kryesuesi.

Në Qeveri janë nis procedurat për ndryshimet e këtij ligji, **meqë ka** proceset. Prandaj, kemi zgjedhur komisionin dhe presim në një takim tjetër që ky ligj t'ju vjen para parlamentit. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Vazhdojmë me debatin, fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit, i nderuari kryesues, ministra të nderuar, deputet të respektuar ,zonja dhe zotërinj. Në materialin e dërguar nga ART-ja shihet se ne si komision funksional në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2007 jemi informuar për disa çështje rreth procedurës së telefonisë së dytë mobile. Çka nuk dua të përsërisë sepse është

procesverbali i hartuar nga përfaqësuesja e ART-së dhe e falënderoj ART-ën që ju ka përgjigj ftesës së Komisionit, thash për disa çështje për arsye se pikërisht ditën kur ka mbajtur mbledhje Komisioni Parlamentar mu atë ditë janë hapë edhe ofertat e konkurruesve për telefoninë e dytë mobile në mënyrë që përfaqësuesja e ART-së më mirë me thanë kryesuesi ka qenë i kufizuar t'i japë të gjitha informatat që i ka kërkuar edhe Komisioni funksional.

Kërkesa e Komisionit është bërë më kohë që edhe më tutje ART-ja të raportojë për çështjen e telefonisë së dytë mobile. Do të thotë ne kemi kërkuar edhe më datën 20 të njëjtit muaj që përfaqësuesja e ART-së të vijë dhe të informojë Komisionin funksional për procedurën e punës së telefonisë së dytë mobile po edhe atë ditë nuk ka qenë e mundshme për arsye se kemi marrë shkresë me shkrim nga ART-ja se duhet të respektohen procedurat e ligjet nëse veç dalin ankesa në mënyrë që të mos vjen deri te një kontest tjetër.

Materialet shtesë të dërguara nga ART-ja krijojnë mundësinë që deputetët të jenë më mirë të informuar për çështjen për të cilën po debatohet sot, krahasuar me seancën e kaluar do të thotë mundësitë janë 100% më të mëdha që ne të jemi shumë më mirë të informuar se në kaluarën.

Neni 4 i Ligjit për telekomunikacion përcakton ART-ën si autoritet i pavarur që zbaton politika e institucioneve vetëqeverisëse, pyetja është? A janë zbatuar këto politika me përpikshmëri në rastin e tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile në Kosovë?

Pastaj neni 22 i Ligjit për telekomunikacion përcakton minimumin e kushteve të përgjithshme për marrjen e një licence, a mendon ART-ja që këto kushte janë përmbushur. Dhe krejt për fund nëse mendohet apo dyshohet se janë bërë shkelje të rregulla tenderuese apo të ligjit, atëherë në këtë çështje duhet të merren organet kompetente dhe gjykata. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Rexhepi, le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – I nderuari kryesues, unë as që e kisha ndërmend të diskutoj dhe arsyeja pse u lajmërova ishte fjala e kryeministrit i cili ndoshta e kishte qëllimin që të bëjë sqarime lidhje me procedurat e tenderimit të gjitha, por në bazë të fjalës së tij ai ka mbjellë më tepër konfuzion edhe disa dyshime. Prandaj, qëllimi im ishte që në mënyrë kronologjike pika të shkurta prej momentit të fillimit të tenderimit për operatorin e dytë të telefonisë mobile në ish Qeverinë të cilën e kam udhëheqë të jenë të kjarta edhe për anëtarët e parlamentit por ndoshta edhe vet kryeministri, d. m. th. unë e akuzoj se e ka bërë me tendencë për njeriun që ja ka shkruar ose ka përgatit këshilltari i tij ai ka mbjellë konfuzion dhe disa konstatime të tij nuk qëndrojnë, prandaj u rezervova. Nëse do të jetë z. kryeministër këtu kisha desh që të ballafaqohem edhe nëse unë e kam gabim t'i ballafaqojmë mendimet, mirëpo nëse jo nuk mendoj se do të ketë shumë kuptim diskutimi im, ndërsa indikerkt disa sqarime duhet të bërë se janë disa gabime në atë çka janë përgatit se s'kanë qenë ashtu dhe nuk qëndrojnë si ka thënë kryeministri.

Prandaj, rezervoj të drejtën nëse do të jetë kryeministri nëse jo nuk e shoh të arsyeshme të vazhdojë më.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Informacionin që unë e kam ai nuk do të mund të jetë sot prezent më në seancë dhe ju mund t’i parashtroni pyetjet në procedurë të rregullt parlamentare për t’u përgjigj ai në seancat e ardhshme, pra dhe lus të gjithë deputetët që fjalën e tij e kanë të lidhur me kryeministrin që në këtë formë se nuk do të mundet me qenë sot prezentë. Xhevat Bislimi e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Drita Statovci.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryesues, z. deputetë. Mua po më provokon fakti dhe insistimi i dikujt, dikujt që kërkesa për këtë debat, kërkesa që të debatohet për këtë çështje po kualifikohet me lloj-lloj ngjyrimesh politike me lloj-lloj akuzash jo për interesat privat e tjera e tjera dhe po jepet një karakter që nuk e ka në fund të fundit Kuvendi është organ legjislativ, por edhe organ që kontrollon punën e Qeverisë por edhe organ që heton edhe ka të drejtë me hetua punë e Qeverisë, nuk e di ku po mbështetet ata që po mundohen çdo që me e kalua te gjykata, krejt botën krijohet komisionet hetuese parlamentare do me thanë hetim parlamentar jo hetim policorë.

Tjetër më provokoj edhe fjala e kryesuesit të ART-së i cili përveç tjerash u mundua ta zhvendosë këtë çështje edhe në terrenin fetarë gjë që kisha kërkuar që ta tërheqë atë fjalë sepse nuk besoj që najë herë në historinë e Kosovës ka ndodh urrëjtje fetare sidomos brenda shqiptarëve që s’është bërë llafe asnjëherë ajo punë. Prandaj, s’ka nevojë me u mbështetë as pas fesë e as pas partinës e as pas politikës, as pas moralit e as pas drejtësisë. Ju lutem, kërkesa e deputetëve që e kanë bërë është shumë e qartë, dyshohet se nuk janë respektuar procedurat për dhënien e tenderit dhe ky dyshim po bazohet, po shpjegohet gjatë debatit dhe secili sigurisht që po jep mendimin e tij dhe s’ka asgjë të keqe.

Një tjetër është një fakt shqetësues është edhe fjala e kryeministrit që polemizoi bukur gjatë me shoqata joqeveritare, me shoqëri civile dhe u krijua përshtypja te qytetarët tanë se kryeministri, institucionet, deputetët janë të paprekshëm qytetari nuk ka të drejtë. Shoqatat nuk kanë drejtë të japin vlerësime të ndjekin punën e tyre, në një mënyrë kushtimisht “po e them të hetojnë punën e tyre”,

Ne z. deputetë edhe z. kryeministër pa varësisht pse s’je këtu, nuk jemi të paprekshëm sidomos në raport me qytetarët tanë dhe shoqëria civile edhe OJQ-të janë pjesë e këtij vendi dhe kanë të drejtën e tyre që të merren edhe me neve nga pak se nuk na bjen teli pse merren me neve. Nuk jemi edhe ne të shenjtë as të paprekshëm qysh po mundohet dikush me u paraqitë këtu.

Prandaj, unë mendoj që është e udhës që kryeministri që u thirr edhe te interesat e dikujt private është e udhës që ta rishqyrtoj këtë fjalë të vetën, këtë pozicion të vetin, sepse në qoftë se bëhet fjalë për interesat private gati më shumë se Qeveria që është e përfshirë në interesat private nuk është askush i përfshirë, tetë nga ministritë e kësaj Qeveria janë të

vendosura në shtëpi private dhe janë ndërlidh keq me konflikte interesash dhe me interesa private. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Faleminderit z. deputet. Zonja Drita, deputeti Bajram Rexhepi për shkak ndoshta të asaj çka e pat. Deputeti Bajram Rexhepi e ka fjalën.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – Po ndoshta mund t'i bjen edhe aty, por qëllim im që është tek e fundit para kolegëve anëtarëve të Parlamentit mos të det dilema në lidhje me ato çka u tha. Prandaj, dëshira ime ishte që të ballafaqohemi dhe të jetë prezentë edhe kryeministri por në pamundësi atëherë do t'i them disa gjëra për të cilat mendojnë se nuk qëndruan ashtu si i prezantoi kryeministri.

Së pari nuk do të flas me data për arsye se ka kalua një kohë mjaft e gjatë por dihet se ART-ja është themelua me propozimin e Ministrisë që e ka përkrahur edhe Qeveria dhe në fund është votuar në parlament. Dihet cilat janë kompetencat e ART-së dhe pas procedurës së tenderimit ku pakon tenderuese e ka përgatit Ministria, mandej kanë vazhduar me komisionin vlerësues dhe Bordi i ART-së, arsyeja pse na si Qeveri kemi reaguar pasi që është shpallur operatori i dytë ka qenë se asnjëherë s'kemi dash me interferu dhe me ra ndesh me ligjin, kjo ka qenë arsyeja pse na s'jemi përzierë në procedurat e tenderimit deri në momentin kur është shpallur.

Sipas ligjit, po ashtu, nuk është e drejtë e kryeministrit që ta anulojë, mirëpo unë e kam marrë një vendim për suspendim deri në momentin e ekspertizës ose hulumtimit të një agjencioni të specializuar. I vetëdijshëm se ndoshta s'mund ta ekzekutojmë këtë, kam kërkuar përkrahjen e PSSP-ës që ata edhe pse qëndrojnë mbi gjyqin edhe mbi ligjin në një mënyrë e kanë anë mundësi të ekzekutimit dhe me qenë se ballafaqoheshim me tenderin e parë të një rëndësie të veçantë kemi dashur që çdo gjë të shkojë në mënyrë të rregullt.

Një agjencion i specializuar HELM i ka bërë hulumtimet e veta ka pasur në procedura edhe në pakon e tenderimit edhe ka pas, mirëpo kanë qenë edhe disa dyshime të cilat nuk kanë qenë vetëm të Qeverisë po kanë qenë edhe të KFINT-it edhe të grupës së kontaktit. Prandaj ka pas mjaftë elemente që të bëhet një hulumtim i tillë dhe ka vazhduar procedura më tutje ku operatori i cili ka pas nënshkrimin e ART-së është ankuar në gjyq është vazhduar kjo procedurë dhe nëse ju kujtohet gjatë Qeverisë Kosumi është bërë edhe një rivlerësim me një kompani tjetër me sa di unë nga Anglia nuk e di emrin tash, dhe ata kanë konstatuar në një mënyrë se në ato procedura ose vlerësim veç pjesa e vlerësimit nuk ka pas ndoshta shumë defekte por defektet kanë qenë të një natyre tjetër në procedurë edhe disa ndryshime të tjera se dokumentacioni i ofertës është përmirësuar në momentin e fundit që është shkelje ligjore.

Prandaj, fjala e kryeministrit kur thotë që Qeveria e ka përkrah operatorin e dytë të telefonisë mobile nuk qëndron, prej momentit fillimisht unë e kam marrë atë vendim, është përkrahur nga Qeveria dhe tërë kohën na kemi qenë kundër asaj., lënda ka shkua në gjyq dhe pastaj dihet se si ka rrjedhë situata. Edhe sot sikur të ishim kon në situatën e njëjtë papë e kishim marrë vendimin e njëjtë për arsye se kemi pas arsyet për atë. Pse

është vonuar pastaj procedura e tenderimit, ose ritenderimit janë çështje të tjera në të cilat unë nuk dua të futem. Nuk qëndron diçka që mendoj se kryeministri e ka pas të panjohur, këtu thuhet nuk është bërë vërejtje pse operatori i dytë i ka qenë i detyruar t'i paguaj vetëm 6.5 milion euro. Kjo nuk qëndron. Operatori aktual Vala 900 si operator publik e ka paguar licencën 6.5 milion edhe dihet se në atë kohë PTK-ja është udhëhequr nga AKM-ja, mirëpo është marrë u bë marrëveshje që ato t'i ndahen buxhetit të Kosovës, bile na i kemi caktuar edhe prioritetet se kah të shkojnë ato mjete, mirëpo ato ju kanë derdhë buxhetit dhe nuk janë shkuar në destinimin final qysh jemi marrë si Qeveri për infrastrukturë për disa shkolla etj.

Edhe dy tri gjëra të tjera të cilat përmenden të kemi të kuartë që na e kemi përfunduar mandatin pa përfunduar krejt kjo procedurë, procedura ka vazhduar me qeveri pasuese. Nëse ju kujtohet mirë në ditën e fundit të kolegut tim po ashtu ish- kryeministri Kosumi një ditë para se me e përfunduar mandatin e ka nënshkruar, e ka përkrahur operatorin e dytë të telefonisë mobile në atë kohë Mobi-kos, Mobi-tell dhe menjëherë pas nderimit të kryeministrave nëse jo në ditën e parë, ditën e dytë kryeministri Çeku e anulon edhe kërkon ritenderimin. Prandaj këtu ai i bënë disa pështjellime të cilat nuk qëndrojnë. Qëllimi im ishte vetëm me tregua kronologjinë se si kanë shkuar dhe është e vërtetë që sikur të ishte privatizuar Vala 900 para se me ardhur operatori i dytë kishte me pasur vlerën më të madhe edhe vlerën e asetëve edhe të licencës. Por unë jam i vetëdijshëm që Zyra Ligjore e UNMIK-ut në Nju Jork edhe këtu nuk ka lejuar deri në atë kohë që ndërmarrjet publike të privatizohen para se me u bërë inkorporatizimi i tyre, tash nuk e di si qëndron a kanë drejtë apo nuk s'kanë, se të kishim pas atë drejtë si shumë vendet e regjionit shumë më mirë kishte qenë të privatizoj kur e ka një vlerë më të madhe dhe operatori i dytë që vjen sigurisht që do të kishte ofertë më të mirë. Pra buxheti do të përfitonte me shitjen ose privatizimin e Valës në të njëjtën kohë TVSH-në edhe të gjitha ato, ato i thith buxheti i Kosovës si prej operatorit publik ose Valës 900 si prej atij privat janë disa rregulla që nuk e kishin me dëmtua në të ardhmen buxhetin e Kosovës por kishte përfituar me atë. Këtu nuk po hy në spekulime mundona t'i respektoj ligjshmërinë prandaj pengesa është në rregulloren e AKM-ës për privatizim, jo në Ligjin për telekomunikacion.

Ndërsa sa i përket ART-së dua t'i them vetëm edhe nja dy fjalë: ART-ja ka bërë një transformim të veprimtarisë së saj prej momentit kur ka qenë një super institucion dhe absolut ka qëndruar edhe mbi Qeveri, edhe mbi Ministri edhe mbi Parlament dhe ndoshta konform ligjit i ka pasur kompetencat të vendoste për këto gjëra, deri te rasti i fundit tash kur në bazë të raportit thotë se ART-ja edhe pse me ligj ART-ja në fund ka drejtë me nënshkruar jo kryeministri, thotë se na ma tepër kemi qenë në cilësinë e ekspertëve dhe teknikëve por në një mënyrë barra më tepër i bie Qeverisë këto janë disa çështje që unë desha me i sqarua, aty ishte qëllimi im, ndërsa sa e ka merituar operatori i dytë apo jo nuk kam fakte as nuk hy as nuk e kam ndërmend me diskutuar, por nga fjalët e kryeministrit u inspirova që t'i shpjegoj disa çështje të cilat një kronologji të shkurtër. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Deputet. Fjalën e ka deputetja Drita Statovci, le të përgatitet deputeti Zef Morina.

DEPUTETJA DRITA STATOVCI –I nderuari kryesues, ministra, kolegë deputete e deputetë, zonja dhe zotërinj të pranishëm. Fjalën e kam kërkuar që në fillim nuk di si u bë dhe erdhi nga fundi dhe tani bjen disi që përsëritet një pjesë e fjalës së kolegut tim.

Unë dola këtu ta shpreh një shqetësim dhe një kundërshtim timin që besoj se duhet të jetë edhe juaji për një pjesë të fjalës së kryetarit të Bordit të ART-ës z. Berisha. Përdorja dhe manipulimi i diçkaje që është e shenjtë në një kulturë është e gabueshme është e dëmshme për ne këtu për nivelin tonë intelektual për Kosovën në përgjithësi.

Toleranca fetare te shqiptarët është një dukuri e formuar lashtërisht është një dukuri që jeton natyrshmërisht me jetën tonë është një dukuri që vazhdojmë e kultivojmë dhe do të vazhdojë të jetojë me bukurinë e vetë derisa sa të jem edhe ne këtu. Nuk është e hijshme, nuk është politike dhe nuk është aspak e dobishme por e kundërta që të përdoret në raste vetanake për të justifikuar diçka që nuk mund të justifikohet me parametra të këtillë. Prandaj, që në fillim desha ta shpreh këtë shqetësim. Mua thellë më ka prekur në kodin dhe etikën morale timen dhe besoj edhe te ju edhe te ne të gjithëve. Prandaj, dukuritë e këtilla nuk e besoj se duhet t'i lejojmë të ndodhin edhe ndonjë herë sidomos në këtë Kuvend. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputete. Vetëm t'ju them se fjalën po e jeap me radhë qysh janë të paraqitur deputetët. Nuk jeni në fund po as në gjysmë nuk jeni, ka edhe shumë deputetë. Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

DEPUTETI ZEF MORINA – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Pa dyshim që Kosova ka shumë nevojë që në fushën e telekomunikacionit të ketë edhe operatorin e dytë të telefonisë mobile, për arsye se është interesi edhe i vet Kosovës, por edhe i qytetarëve të saj. Ajo pse ka ardhur deri tash natyrisht mund të them që është një neglizhencë e cila duhet të kuptohet se në një vend si Kosova është vështirë që të jemi prefekt në veprimet tona me zbatimin e ligjit. Por, për fat të keq ende kemi njerëz që mendojnë se ligji mund të interpretohet dhe zbatohet sipas dëshirës së tyre, sepse veten e konsiderojnë mite dhe mbi ligjin duke aluduar në meritokracinë dhe duke u thirr në thirrur në kombëtarizim a në fakt veprojnë kundër interesave kombëtare.

Me vëmendje dëgjuam raportin e anëtarit të Bordit të ART-ës, i cili në një afat kohor më pak se 6 muaj ka raportuar në të njëjtën mënyrë, duke u mundurat t'i bindë deputetët e parlamentit për sukseset që i ka arritur ART-ja. Me keqardhje mund të them se me punën e vet ART-ja jo vetëm që na ka zhgënjyer ,por jemi edhe të turpëruar, sepse veprimet e gjertanishme kanë krijuar një marrashë të keq për Kosovën.

Për tenderin e telefonisë mobile është humbur shumë kohë bashkë me të edhe shumë miliona euro. Kjo pikërisht për shkak të punës joefikase, joprofesionale dhe jotransparente të ART-ës. U desh të kalojnë mbi dy vjet e gjysmë për t'u bindur ART-ja se licencimi i fituesit për tender të parë nuk ishte i rregullt. Më në fund e pranoj ART-ja

se duhet të rishpallur tenderin për të cilin u desh të humbi edhe një viti deri në përzgjedhjen e kompanisë fituese.

Isha i bindur se tani gjërat duhet të shkonin më mirë dhe më me transparencë, por si duket jo, sepse menjëherë pas publikimit të fituesit filluan reagimet nga kompanitë tjera pjesëmarrëse të cilat paraqiten vërejtjet e tyre për parregullsi.

Materiali që na është dërguar dje nga ART-ja edhe pse me vonesë nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar saktë ecurinë e punës së Komisionit në përzgjedhjen e fituesit.

Në raport nuk janë paraqitur kriteret në mënyrë të detajuar mbi bazën e së cilës është zgjedhur kompania fituese. Në bazë të pikëve të grumbulluara del se kompania më e mirë teknikisht ka rezultuar Mobil-kom Austria, e cila ka grumbulluar më shumë pikë, ndërsa vlera e pikëve është rritur nga çmimi që ka ofruar kompania fituese. Mendoj se nuk është hap i qëlluar një zgjedhje e tillë, sepse për qytetarët më me rëndësi është të fitoj ajo kompani që ofron kushte më të mira se një kompani që në start ofron një vlerë simbolike me të madhe të parave.

Nga materiali i prezantuar nuk mund të them ka apo jo parregullsi, por ajo që më ka bërë të dyshoj është se kushtet në pakon tenderuese e predikojnë fituesin duke i mundësuar kompanive pjesëmarrëse për një marrëveshje, flas për shtojcën tre të paragrafit 22. të pakon tenderuese, që është në kundërshtim me ligjin. Kështu që pas tërheqjes së ofertuesit të parë të fitoj i dyti e kështu me radhë.

Gjithashtu, duhet të shikohet arsyeja e tërheqjes së fituesit të parë është tërhequr për shaka të mos kryerjes së pagesës me kohë gjegjësisht që është vonuar dy ditë apo, sepse ishte pjesëmarrëse edhe në kompaninë e ranguar e dyta. Nëse e njëjta kompani ka konkurruar në dy oferta gjegjëse, gjegjësisht në dy konzorciuma atëherë tenderi është i pavlefshëm dhe licenca nuk është valide, sepse bëhet shkelje e ligjit.

Më mirë do të ishte që të pritej edhe dy ditë dhe buxheti të fitonte 6 milion euro më shumë se të ngutshëm dhe të fitonim për dy ditë kohë ndërsa t'i humbim 6 milion euro duke i dhanë të drejtë operatorit, gjegjësisht kompanisë radhitur në rangun e dytë. Nuk jam ithtarë që gjërat të prejudikohen, duke akuzuar për keqpërdorime, por kërkoj që e tërë puna të jetë transparente.

Pavarësisht që materialin që e kemi marrë nga Organizata “Çohu”, e cila ka gjëra vërtet të çuditshme. Mendoj që ne duhet të jemi të vëmendshëm sepse si deputetë dhe si parlamentar duhet dhe bartim përgjegjësinë që na takon. Andaj, me qenë se procesi i cili është paraqitur edhe në pakon tenderuese ka gjëra të cilat mund të konsiderohen jo të ligjshme dhe të cilat gjykata ndoshta mund t'i dënoj mendoj që duhet t'i kemi kujdes si Parlament dhe mirë kishte me qenë që të formohet një komision që do të vlerësonte punën e ekipit apo të komisionit pasi që në komision anëtari i bordit ka qenë kryesues i Komisionit që mendoj sipas ligjit është konflikt interesi.

Kërkoj edhe një herë që të gjithë deputetët të meritojnë një qëndrim që të kemi një komision parlamentar i cili do ta vlerësojë punën e procedurës së udhëheqjes së këtij tenderi. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Dua t' ju informoj se vazhdimisht po paraqiten deputetë për fjalë, pra po shtohet numri i deputetëve që kërkojnë fjalën, fjalën e ka Besa Gaxherri dhe pastaj do të merremi vesh a do të shkojmë në pauzë apo do ta vazhdojmë debatin.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Faleminderit z. kryesues, kolegë deputetë.

Para se të flas për tenderin e operatorit të dytë telefonisë mobile, po ndalem te tenderi i bufesë së Kuvendit të Kosovës se provokoi se nuk mundëm me pi kafe, dolëm në pauzë e s'mujtëm me pi kafe, dy herë e keni shpallur e keni mbyllur edhe nuk keni bërë asnjë arsyetim s'e keni dhënë rreth kësaj çështjeje dhe pikërisht kjo më provokoi natyrisht edhe disa kolegë që unë e shohë në prizmin tim ndryshe këtë çështje dhe natyrisht jam shumë parimore dhe për çdo çështje mendoj dhe kërkoj dhe do të mundohem që çështjet të ngritën gjithmonë çështjet parimit.

Sa i përket temës në fjalë ne vërtet kemi përkrahur edhe kemi kërkuar që të ketë liberalizim tregut me qëllim që të mos ketë monopol në tregun e Kosovës, natyrisht me qëllim që qytetarët e Kosovës të kenë shërbime të mira edhe të arsyeshme në çmim.

Derisa është ngritë apo kanë lindur ndryshimet për shkelje të ligjit e të procedurave ka deputetë që marrin guximin dhe thonë edhe korrupsion. Unë e shoh të arsyeshme ndoshta duhen çdo çështje që ka të bëjë me qytetarin e Kosovës ajo pikë duhet të preket pra edhe në Kuvendin e Kosovës Por mënyra e shtruarjeve të problemeve në këtë praktikë qysh ne kemi filluar në Kuvend mua nuk më pëlqen.

Nuk mendoj se duhet gjithmonë çdo çështje qoftë edhe kjo ta personalizojmë apo ta grupizojmë. Kuvendi është e vërtetë që duhet të merret me çdo çështje me çdo qetësim të qytetarëve.

Por kur jemi tek operatori i dytë i telefonisë mobile dua të ju them kolegëve të mi se vërtetë Kuvendi është organ politik dhe ndër çështje të tjera, duhet ta kemi parasysh dhe çështjen në fjalë; sa po i kontribuojmë klimës pozitive për investimin në Kosovë në qoftë se ne i shtrijmë çështjet në këtë formë qysh po i shtrijmë duke akuzua dhe duke mos u pajtuar asnjëherë se asnjë tender në Kosovë nuk mund të aplikohet apo të përfundoj në mënyrën ashtu si duhet. Mendimi im është për shembull janë dy- tri vjet që ka filluar ky farë privatizimi apo dhënia e licencës këtij operatori të dytë edhe është bërë histori, edhe sot kur disa raporte i kemi këtu para veti të cilët e verifikojnë se çështja ka përfunduar në procedura të rregullta na kemi vërejtje që unë në një formë deputetët kanë të drejtë të japin vërejtjet e veta, por mendoj se duhet ta gjejmë kulturën parlamentare dhe çështjet t'i shtrijmë gjithmonë në formë parimore dhe në nivelin e duhur.

Nuk pajtohem edhe me disa kolegë që thanë se këtu ka konflikt interesash se punon në PTK e ku ta di unë. Është e vërtetë se telefonia mobile publike Vala 900 tashmë me

privatizimin dhe operimin e këtij operatori është e diskriminuar dhe unë e shtroj këtë çështje kështu. PTK është një kompani profitabile ndoshta më profitabile në Kosovë derisa buxheti i Kosovës ndanë mjete për KEK-u miliona, për Hekurudhën, për Aeroportin, PTK-ja është një kompani profitabile cilën kompani duhet punojmë edhe Kuvendi edhe ne deputetë, që t'ia përshtatim legjislacionin se këtu automatikisht a takohet me ligjin e prokurimit dhe automatikisht operatori i Valës 900 tash më nuk është në kushte të barabarta të veprimit me operatorin e dytë. Prandaj, ne duhet ta kryejmë punën tonë si deputetë të punojmë, ta shqyrtojmë Ligjin e prokurimit konkretisht, njëkohësisht Qeveria duhet edhe të përkrah edhe të mbështetë po edhe ta kontrolloj PTK-ën se tek fundi i fundit PTK-ja është kompani publike dhe është kompani e Kosovës.

Të gjitha këto çka u diskutuan deri tash nga kolegët e mi, ngritjen e çështjeve të auditimit e ku ta di unë që kërkon prapë shpenzime, shpenzime. Unë mendoj se tash më vërtetë ky Kuvend nuk është as prokuri as gjykatë as agjencioni kundër korrupsionit, fatbardhësisht i kemi ngritur këto organe i kemi dhe unë mendoj se në qoftë se ka dyshime të mjaftueshme fatbardhësisht i kemi organet dhe duhet t'ia vlejme fjalën e organeve tona të vendosin dhe gjithmonë çështjet i shtrojmë në mënyrë më parimore. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. për fjalë janë paraqitur edhe 7 deputetë. Të nderuar deputetë, marrim pauzë apo vendosim ta vazhdojmë seancën. Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-ës, do vazhdojmë, apo shkojmë në pauzë.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Mendoj z. kryesues kjo është një mbledhje plenare e rregullt në kuadër të këtyre rregullave është e parapamë edhe pushimi për drekë.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Vazhdojmë në 14,30.

Plenarja

KRYESUESI NAIM MALOKU – Për fjalë është paraqitur Teuta Sahatqija, kurse le të përgatitet deputeti Gani Koci.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - Faleminderit z. kryesues. Unë nuk do të hyjë në arsyeshmërinë se a i duhet Kosovës apo jo operatori i dytë edhe nuk do të flas se a i duhen Kosovës investimet e huaja, konkurrenca e lirë etj, pasi nuk është as temë e kësaj seance. Do të flas për atë që jemi mbledhur sot, për punën e operatorit të dytë dhe për punën e ART-së. Dokumentacioni që na është dorëzuar nga ana e ART-së, për procedurat, për tenderin e operatorit të dytë të telefonisë mobile nuk ju kanë përgjigjur në versionin e parë kërkesës që është bërë prej Kuvendit. Në dokumentacionin e dorëzuar ishin dokumentet e formimit të komisioneve të ndryshme, në shqip dhe anglisht, por nuk patë shënime për punën e ART-së para mbylljes së tenderit dhe pas mbylljes së tenderit dhe gjatë evaluimit. Në përmbledhjen e dytë ka më shumë shënime nga puna e ART-së, por edhe në këtë ka mungesa. Puna e ART-së gjatë gjithë kësaj kohe është përcjellë me një publicitet, me një publicitet fatkeqësisht negativ, kombëtar dhe ndërkombëtar gjë që e cila ishte eliminuar, nëse jo plotësisht atëherë në masë të madhe po të kishte pasur më tepër transparencë. Veprimet e lidhur për tenderin e telefonisë mobile si herën e parë, po

ashtu edhe kësaj here janë të mbuluara me mos transparencë dhe me shumë pakënaqësi, herën e kaluar kjo ka rezultuar me dështimin e tenderit e kësaj here me gjasë me padi qindra milionësh dhe dokumenti i tenderit brenda vetes ka ngërthyer mungesa të shumta, disa prej tyre janë përgjigje të pakta apo mungesa e përgjigjes në pyetjet e ofertuesve potencial, mungesa e kriterëve dhe nën kriterëve për evaluimin e ofertave, mungesa e caktimit të çmimit të **interkonicionit** pasi në çdo vend kjo është detyrë e autoriteteve rregullative të vendit e jo detyrë e njërit prej operatorëve. Askund operatori i dytë nuk kërkon ofertë për ndërlidhje me sistemin nga operatori i parë sepse si konkurrent apriori operatori i parë i jep çmimin më të lartë dhe minon punën e operatorit të dytë, kjo me siguri ka ndikuar edhe me eliminimin e ofertuesve serioz dhe me renome që janë prezentë në tregun e telekomunikacionit.

Gjatë fazës së evaluimit të tenderit dhe gjatë kësaj faze ka pasur gjëra për të cilat duhet të flitet dhe të përmenden. Kjo fazë është përcjellë me një mungesë të madhe, përsëri të transparencës, fjalës e cila është përdorur jashtëzakonisht shumë gjatë kësaj seance është ofruar zgjidhja teknikisht më e përshtatshme në dobi të çmimit fillestar i cili në afat të gjatë mund të jetë financiarisht edhe jo më i favorshëm. Nuk është bërë e ditur vlefshmëria e garancive bankare, nuk është bërë e ditur kontroll e konzorciumeve për pamundësojnë e pjesëmarrjes së dyfishtë dhe nuk ka pasur hapje publike, gjë e cila ka ngritur edhe më tepër tensionet edhe dyshimet për një mos transparencë dhe nën kriteret janë bërë të ditura pas dorëzimit të ofertave. x Duke pasur parasysh rëndësinë e tenderit do të kishte qenë e udhës që hapja të përcillet edhe nga mediat, këtë gjë e kërkon edhe ligji për telekomunikacion dhe ai për prokurim.

Është e pamundur që këtë gjë nuk e ka ditur ART-ja apo komisioni i cili e ka përcjellë këtë tender. Nëse ka arsye pse kjo ka ndodhur apo kush ka ndikuar që të mos bëhet hapja publike, atëherë tash është rasti që të tregohen të gjitha arsyet. Pse bordi i ART-së i cili sipas ligjit duhet të bartë barrën e procesit nuk ishte aty në përbërje komplete, por u formua komisioni tjetër. Si është e mundur që në analizën e dokumentacionit që është strikt teknik, si është e mundur që prej njërit anëtar të jepen 136 pikë, kurse prej tjetrit 106 pikë, prej anëtarëve të të njëjtit komision.

Kriteret dhe nën kriteret e këtij tenderi i cili është tender teknik dhe pikat duhet të jenë teknike, për dallim prej ndonjë konkursi për këngën e Evropizionit apo për ndonjë hartim etj që mundet me qenë ndryshim i madh i pikëve në tenderin teknik duhet të jenë pikat strikte, dihet për çfarë vlerësimi, për çfarë kriteri merren sa pikë e jo për të njëjtën gjë dikush të jep më tepër apo dikush të jep më shumë pikë.

Për fazën pas tenderit dhe për mesazhin i cili del nga i tërë ky proces edhe për këtë ka mjaft çka të flitet. Është humbje e vazhdueshme për buxhetin e Kosovës duke pasur parasysh dështimin e tenderit të parë dhe gjasa për dështimin e tenderit të dytë dhe padija potenciale nuk japin një mesazh çfarë duhet të del prej tërë këtij procesi.

Pakënaqësitë si brenda edhe jashtë Kosovës janë gjithashtu produkt i këtij procesi. Mungesa e hapësirës për konkurrencë të lirë dhe shanset e barabarta ka munguar, ndërsa është krijuar hapësirë për diskriminim dhe mos transparencë.

Dëmtimi i imazheve të institucioneve dhe i imazhit të vendit si vend i papërshtatshëm për investimet e jashtme e sidomos në këtë kohë kur jemi duke u përgatitur për formimin e shtetit është një mesazh jashtëzakonisht i dëmshëm për të ardhmen e shtetit të Kosovës.

Padia nga ofertuesi i parë e cila padi mund të sjellë jo në fitime të buxhetit të Kosovës, por në humbje të thellë është përsëri mesazhi dhe një prej produkteve të cilat dalin nga i gjithë ky proces.

Unë i kisha bërë disa pyetje, pasi njëra prej pyetjeve do të kishte qenë: Pasi prezenca e ofertuesit si operator i telefonisë mobile në ndonjë treg kërkohet në mënyrë eksplicite në dokumentin e tenderit, duhet të pyes a është analizuar, a ka konzorciume operatorë që veprojnë si të tillë? Në konzorciumet që kanë marrë pjesë si ofertues a janë ofertues të cilët janë prezent në ndonjë prej tregjeve si operator të telefonisë mobile? Pyetja e dytë është: Në dokumentin e tenderit nuk lejohet që e njëjta firmë të merr pjesë në ofertat e ndryshme, a është bërë analiza e konzorciumeve dhe a është evidentuar pjesëmarrja e firmës së njëjtë në të dy konzorciumet.

Pyetja e tretë ka të bëjë me garanci bankare: Për pjesëmarrje në tender duhet të dorëzohet garancia valide bankare në vlerë prej 20% të vlerës së tenderit.

Ju lutem të na sqaroni a është analizuar vlefshmëria e garancive bankare të ofertuesve duke pasur parasysh që kjo është një kusht për mos eliminimin e ofertuesit prej fazës së evaluimit të tenderit.

Nëse tenderuesi i parë nuk i ka plotësuar kushtet në tender atëherë ART-ja duhet të inkasoj 16 milion në buxhetin e Kosovës, pyetja a është garancion bankar valid dhe a do të inkasohen ato dhe cila është arsyeja e mungesës së hapjes publike të ofertave.

Pasi patëm mendime diametralisht të kundërta prej anëve të ndryshme të cilat edhe përkonin me pozitën dhe me opozitën, atëherë duke pasur parasysh që secila anë mendoj që auditimi apo komisioni hetimor, apo çkado që do të kishin sjellë një transparencë dhe do të kishin eliminuar ato dyshime të pa baza që thonë, apo i kishim vërtetuar dyshimet me baza të cilat i thotë tjetërkush, atëherë edhe ne mendojmë që është e nevojshme që me këta hapa të cilat kishte qenë mirë që Kuvendi t'i ndërmerret që të qartësohen, sepse nuk mbrohen institucionet tona me fshehjen e fakteve, nuk mbrohen institucionet me largime prej debateve, por përkundrazi ato mbrohen me debat të hapur, me mbikëqyrje dhe kontroll. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputeti Gani Koci, kurse le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI GANI KOCI – Faleminderit z. kryesues. Nuk dola në foltore se kamë shumë letra, materiale për të dëshmuar, kamë më shumë se znj. Gjylnaze dhe nëse ngatërrohem këtu nuk i kamë fajet unë, por i kanë letra që i kam shpërndarë në tavolinë.

Do të nisem prej interpretimit të ligjit aq sa kam mundësi unë dhe eksperiencë në këtë çështje.

Neni 3 pika 1 nën a thotë: Ministria do të mbajë përgjegjësinë për hartimin e politikave, d.m.th Ministria harton politika, ndërsa nën b) ART-ja e themeluar nga ky ligj si një trup i pavarur për brenda IPVQ-së mban përgjegjësinë për implementimin e këtyre politikave.

Dhe në këtë rast shtrohet pyetja, në rastin konkret: Cilat kanë qenë ato politika të Qeverisë sepse nuk i ka implementuar ART-ja veç po shihet, e shohim nga faqja e parë e informatës së parë që thuhet se: Kjo informatë do të dëshmojë që bartës të procesit për përzgjedhjen e operatorit të dytë ka qenë Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u. ART-ja e ka pasur vetëm rolin teknik. Kam mund me pas edhe unë me një komision që nuk jam

anëtar i ART-së hiq dhe nëse është kështu sipas ligjit, atëherë thyerja e parë e procesit të tenderimit është mosrespektimi i nenit 3, pika 1 nën **a** dhe **b**.

Te neni 20 thotë: Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë ligj ART do të ketë pushtetin e vetëm për të lëshuar autorizime dhe licenca për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë. Në këtë rast ART nuk ka lëshuar licencë, këtë e ka bërë Qeveria, respektivisht këtë e ka bërë kryeministri Çeku me dhënien e nënshkrimit në marrëveshjen në mes ofertuesit që është përzgjedhur si ofertuesi i pranueshëm në këtë tender. A nuk është kjo shkelja e dytë e këtij ligji për të cilin është e nevojshme dhe është e domosdoshme kërkesa që u shtrua nga shumë diskutues për një rivlerësim, një rishikim të të gjitha procedurave rreth tenderimit.

Z. Anton Berisha i ngatërroi nenin 36 me nenin 20 ku në një farë mënyre jep disa autorizime Qeverisë për nënshkrimin.

Neni 36 thotë: Përkundër kushteve të tjera të këtij neni ART në koordinim të ngushtë me PSPP-në do të lëshojë të drejtën për shfrytëzimin e radio- frekuencave për GSM. Në këtë rast rrolli i Qeverisë është ky: Ministria do të përgatis dokumentet e tenderit, ndërsa ART do ta implementojë tenderin. A nuk është kjo thyerja e 3 apo 4 e ligjit mbi telekomunikacionin.

Përveç këtyre thyerjeve edhe vetë rregullat ose procedurat që i ka parapa Ministria përkatëse rreth këtij tenderi, edhe ato janë thyer në përzgjedhjen e ofertuesit për operatorin e dytë.

Nuk dua t'i përmend të gjitha ato rregulla, por rregullën 4.2 ku thuhet se: Mund të përzgjidhet ai ofertues që ka eksperiencë në më shumë se 1 treg. Është përzgjedhur operatori që ka vetëm një treg dhe nuk ka dy tregje ose tri tregje. A nuk është kjo thyerje përveç thyerjeve të tjera të ngatërimit të subjekteve juridike ose fizike siç thuhet, herë në një konzorcium e herë në konzorciumin tjetër.

Kjo është sa i përket thyerjes së Ligjit mbi telekomunikacionin rreth tenderimit për operatorin e dytë.

Sa i përket fjalës së kryeministrit që ndoshta për publikun është dukur shumë tërheqës kur thotë se nuk kemi shitur asgjë, kemi shitur "etër", por ai atë etër nuk e ka mbushur në ballona dhe me qit në treg dhe krejt lufta sot bëhet luftë për etër dhe nuk e dinë që ai etër dhe ajo hapësirë e ajrit është pasuri kombëtare dhe me pasurinë kombëtare duhet të sillen ndryshe dhe në anën tjetër sikur kryeministri është mësuar të vendos nënshkrime ku dhe kur se ka për detyrë dhe përgjegjësi duke u nisur prej simulimit të nënshkrimit në ligjin për invalidët dhe veteranët e luftës, deri te nënshkrimi për licencimin e rezervarëve të naftës të INA-s ose operimit të një kompanie të huaj brenda dhe te nënshkrimi i një marrëveshje për të cilën nuk besoj se dinë Kuvendi, e Qeveria nëse e di rreth minierave të Sibovcit në Bankën Ndërkombëtare dhe me Petersenin që kurrë nuk është bërë publike dhe kurrë nuk i është ofruar këtij Kuvendi për shqyrtim ose për ratifikim të mundshëm të asaj marrëveshje.

Në qoftë se është kështu, unë mendoj se defektet janë pikërisht te ky Kuvend në radhë të parë, në radhë të dytë defektet janë te Qeveria e Kosovës. Shefi i grupit tim parlamentar në diskutimin e kaluar shtroi çështjen e ndarjes së pushtetit dhe sigurisht që sot u përmend nga shumëkush këtu ndarja e pushteteve, por kanë harruar pse dhe për çfarë arsye është bërë kjo ndarje e pushtetit dhe në kohën kur është bërë ndarja e pushtetit është krijuar edhe një mekanizëm tjetër, një institucion tjetër i kontrollit parlamentar të atyre pushteteve që dalin prej Parlamentit, prandaj nëse është kështu atëherë kërkesa për një

rivlerësim të këtij tenderi duhet të rrjedh nga ky Kuvend, mos i presim gjykatat, të mos i presim paditë private, por të fillojë këtu nëse jemi institucion ligjvënës atëherë e kemi edhe të drejtën e kontrollit të zbatimit të ligjeve dhe në këtë formë ne nuk jemi duke vepruar.

Defekti tjetër qëndron sepse me pasurinë kombëtare po veprohet kujt si t'i teket dhe kjo është mungesë e ligjit mbi koncesionet, kanë ngatërruar licencën me koncesionet, unë këtë e quaj koncesion dhe nuk është licenca e njëjtë me koncesionin. Po të jem unë berber më duhet me shkuar me marrë një licencë, por nuk duhet krahasuar kjo licencë me një licencë për telefoninë mobile, me një licencë për shfrytëzimin e minierave, me një licencë për shfrytëzimin e Aeroportit dhe me licenca të kësaj natyre, prandaj ju lutem urdhëroni përcaktoni çka është pasuri kombëtare, çka është lëndë që mund t'u nënshtrohet koncesioneve dhe ne kemi filluar prapsht. Kemi bërë ligjin mbi procedurat e koncesionit, ndërsa nuk kemi ligj për koncesionet, te ne gjithçka mund të jetë objekt i koncesioneve. Në këtë rast kujt t'i teket nga Qeveria mund të jap dhe të bëjë koncesione të natyrave të ndryshme që gjithsesi shkojnë në dëm të interesit të qytetarëve të Kosovës, në dëm të interesit të Kosovës, deri kur kështu nuk di, por unë konsideroj se është momenti i fundit t'u thuhet stop të gjitha lojërave rreth dhe me pasurinë kombëtare.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Faleminderit, për replikë Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryesues. Gani unë pajtohem me ty që letra është e rëndësishme për krejt akuzat që i tha në emër të Qeverisë pres me i pa letrat, jo vetëm fjalët.

E dyta z. kryesues ju lutem të përdorni autoritetin tuaj dhe zbatoni rregullën 10 në të cilën thuhet se kryetari i Kuvendit këtë rast ju si ushtrues t'ia tërhiqni vërejtjen secilit deputet ose anëtarit të Qeverisë kur diskutuesi largohet nga çështja e parashtruar. Çështja e parashtruar për diskutim është shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit dhe jo të ligjit dhe akuzave tjera që i shtroj në emër të kryeministrit. Rregullat janë rregulla mbase z. Gani Koci mësohet në këtë praktikë. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi.

Për replikë është paraqitur z. Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – I pranoj sugjerimet e koleges Gjylnaze Sylja, por ne po bisedojmë për veprimet që janë bërë në përputhje me këtë ligj, prandaj duhet ta interpretojmë këtë ligj.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Fjalën e ka Behxhet Brajshori, kurse le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari kryesues i seancës, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputet.

Fillimisht më gëzo fakti që kryetari i ART-së z. Berisha pat rastin që t'i adresohet Kuvendit për informatën lidhur me ecurinë e procesit të tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile pas rastit që e kishte pas disa ditësh dhe mendoj se kjo duhet të na gëzoj

të gjithëve. Çështjet tjera që lidhen me këtë operator të nderuar kolegë mendoj se ne shumë po vonohemi në procese e sidomos në procese zhvillimore të cilat e kanë ndikimin e vetë të përgjithshëm ekonomik dhe politik dhe në këtë drejtim pa dyshim se njëri prej projekteve më të madh dhe më profitabil për Kosovën është operatori i dytë i telefonisë mobile. Çka në të vërtetë pas këtyre adresimeve që sot shefi i ART-së i bëri para Kuvendit dhe kryeministri i Kosovës. Mendoj se ne duhet të mbledhim forcën të gjithë bashkërisht dhe natyrisht mendjen dhe të krijohen kushtet për një fillim sa më të shpejtë të punës së operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë, jo në kundërshtim me rregullat dhe ligjin, por që ajo të mbetet objekt i organeve përkatëse nëse ka shkelje të këtilla, sepse një vonesë e këtillë na ka kushtuar shumë që 4 vite e më shumë. Merreni me mend të nderuar kolegë në këtë opinion dhe në këtë mes tonin në Kosovë të kemi operator të vetmin të telefonisë mobile në Kosovë prej të cilit edhe ashtu pak ka mundësi buxheti i konsoliduar i Kosovës që të shfrytëzojë mjete për të financuar zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj kjo nevojë e kyqjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile është e kamotshme dhe në këtë drejtim duhet angazhuar të gjitha forcat tona.

Çështja tjetër që është shumë me rëndësi kolegë edhe mund të jetë jo shumë e paraparë në kuadër të ligjit është çështja që Qeveria e Kosovës të iniciojë procedurat për ndryshimin e Ligjit për telekomunikacionin dhe të krijojë mundësi tjera për hyrje të operatorëve tjerë telefonik në Kosovë me qëllim të rritjes së konkurrencës, kjo do të ndikoj në rend të parë në rritjen e të hyrave për buxhetin e Kosovës dhe në rend të dytë gjithsesi jo më pak të rëndësishëm për krijimin e kushteve për shërbime më cilësore dhe më të mira për qytetarët e Kosovës. Mendoj se ky është qëllimi themelor i asaj që ne e quajmë shërbim në shërbim të qytetarëve dhe këtë duhet ta bëjmë sa më shpejt me qëllim që konkurrenca vërtet të krijoj kushte për shërbime më të mira në Kosovë në shërbimin e telekomunikacionit. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajete Hyseni – Kaloshi, kurse le të përgatitet deputetja Selvije Halimi.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – **KALOSHI** – Faleminderit z. kryesues. Znj. dhe z. deputetë.

Edhe unë nuk e kisha ndërmend të diskutoja, por janë nganjëherë disa çështje për të cilat siç thuhet edhe po të mos kesh gjuhë del në qafë një gjuhë dhe duhet të flasësh. Si shumë tendosje në këto tendat tona të tenderimit, na terën tenderët, na terën bordet. Shikoni çdo kund borde, tenderë. Ne bisedojmë këtu jo për funksionimin, por vetëm për tenderët, gjithçka lidhet disi me tenderë dhe diçka tjetër që lidhet po ashtu me këto. Në këtë mjegullnajë njëfarë fetfaje tash për të justifikuar krejt këtë lojë me tenderët e me bordet etj, me ndarjen e pushteteve, me pavarësinë e pushteteve dhe jo çfarëdo ndarje dhe pavarësie, por totale. Kur flasim për pavarësinë e Kosovës aty pranojmë edhe të kushtëzuar edhe të mbikëqyrur dhe lloj-lloj epitetesh, por kur flasim për pavarësinë e këtyre pushteteve feudale që dikush i ka shti në dorë, aty pavarësia është totale, ndarja është totale edhe përpiqemi edhe të japim njëfarë petku profesional etj, Ekzekutivi përpiqet të funksionojë si i ndarë krejtësisht nga Kuvendi, s'ka transparencë. Bordet i formon Kuvendi, por në fakt ato veprojnë fare të pavarura nga Kuvendi, pa raportuar, pa transparencë. Kur shfaqen dyshime thuhet le të bartet çështja në gjyqësi, kur vjen puna për të shkuar në gjyqësi atje me gjithë atë e dimë si e kemi gjyqësinë dhe

përsëri në emër të pavarësisë së gjyqësorit gjinden mundësi për të pamundësuar sundimin e ligjit edhe atje dhe kjo është gjendja znj. dhe zotëri që ne na ka lënë këtu ku jemi. Dikush e përmendi sa kjo na kushton në çështjen e investimeve. Unë do të thosha pikërisht kjo gjendje është ajo që pengon investimet dhe jo vetëm kaq, pengon edhe pavarësimin e Kosovës znj. dhe zotëri dhe ne, prandaj, duhet ta marrim seriozisht këtë që po ndodh.

Në këtë mes dikush ka harruar diçka e qytetarët ku janë, flasin për pushtetet, por le të mos harrojnë se neni i parë i një kushtetute shumë të çmuar për të gjithë ne thotë ne qytetarët i delegojmë pushtetin këtyre e këtyre, por ne jemi sovranët, prandaj unë do t'i sugjeroja edhe kryeministrit që ta rishikojë qasjen e tij ndaj njëfarë OJQ-je siç u tha. Unë jam nga ata që e kanë marrë shkresën e OJQ-së që më vjen keq që për shkaqe objektive nuk e kam hulumtuar sa e si duhet, megjithatë dua ta them hapur se më ka imponuar respekt për qëndrimin e argumente, krahasimi, referenca etj. Ku të jetë e mira që ne të kemi zë më të fuqishëm të shoqërisë civile, në fund të fundit çka përfaqësojmë ne? Përfaqësojmë qytetarët, prandaj ne nuk mund të kërkojmë t'i monopolizojmë pushtetin edhe në ato pushtete e ndarje, pavarësi të tyre. Le të hapen portat, le të hapet edhe ky Kuvend, le të ndizen reflektorët, ka nevojë për atë të Gëtes, “**Merrli**”, “më shumë dritë”, nuk humb kurrkush dhe kur ka më shumë dritë më pak do të ketë vend për lojëra, për keqpërdorime, për abuzime që e dëmtojnë aq shumë imazhin e Kosovës.

Unë nuk do të dëshiroj ta zgjas sepse argumentet këtu që u than vetëm do të humbja kohë për t'i përsëritur, por nuk do të dëshiroja ta përmbyll fjalën time pa e theksuar edhe një faktorë, e ai faktori ndërkombëtar UNMIK-u a ka ai një përgjegjësi këtu, a ka nevojë që një auditim, një kontroll t'i përfshijë edhe ata dhe komisioni që u propozua këtu të përfshijë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile sepse ka ndalur ato vërejtje, zotëri ato vërejtje ose duhet ti hidhni poshtë ose duhet ata t'i tërheqin, duhet t'i bindim se ata e kanë gabim, por për pjesën ndërkombëtare do të duhej që prania ndërkombëtare t'i gjendët instrumentet që edhe atje të bëhet një mbikëqyrje, të bëhet një audit dhe vetëm atëherë ne do të krijojmë kushte për një angazhim komplementar, vërtet demokratik, duke i respektuar punë ndarjen dhe pavarësinë e pushteteve, por edhe kontrollin dhe ndërlidhjen e tyre, ajo që në anglisht quhet “çek end bars”. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputetja Selviqe Halimi, kurse le të përgatitet deputetja Saniqe Alijaj.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – I nderuari kryesues, të nderuar kolegë deputet.

Nëse ne të gjithë këtu që kemi një mandat politik si deputetë të Kosovës i japin të drejtën vetës që të flasin në emër të qytetarëve të Kosovës e në veçanti të atyre që na kanë votuar, nuk i japin të drejtën vetes që të tolerojnë shkelje të ligjeve apo t'i amnistojmë ato, se qenka interesi që të përshpejtohet një veprim se paska një rëndësi shumë të madhe për atë interes të atyre qytetarëve. I gjithë debati po zhvillohet në atë se asgjë më tepër nuk po kërkohet e në veçanti po kërkohet zbatimi i ligjeve të aprovuara nga ky kuvend, e në rastin konkret po flitet për zbatimin e ligjit të telekomunikacionit dhe zbatimin e Ligjit të prokurimit publik. Nëse ka shkelje të ligjeve ato duhet të faktohen dhe hulumtohen nga një organ i pavarur mbikëqyrës ashtu si edhe nga një auditor i pavarur ashtu si deklaroi edhe shefi i grupit të PDK-s. Unë nuk e di se si ne adresojmë akuza ndaj njëri tjetrit, unë nuk di arsye por kujt po i konvenon ose ata të pakënaqurit le t'i drejtohen gjykatës.

U përmendën edhe ndarjet e tri pushteteve. Unë po ju them shumë sinqerisht se në Kosovë siç e di unë e dini edhe ju dhe e dinë të gjithë qytetarët se vetëm formalisht ekzistojnë ndarjet e pushteteve, ende për asnjë çështje, asnjëri nga këto pushtete nuk e tha fjalën e drejtë të arsyetuar mirë, të argumentuar mirë dhe të mbështetur në një ligj apo në një konventë ndërkombëtare, pse po ndodh kjo: Atëherë pse jemi ne si Kuvend, nëse ne nuk e ushtrijmë të drejtën tonë ashtu siç na ka hije si një Kuvend. Pra, nuk kemi të drejtë t'i akuzojmë as qytetarët që veprojnë në forma të organizuara e as qytetarët që mbështesin forma të tjera të veprimit për shkak se ne i mbyllim sytë apo gojën t'i amnistojmë shkeljet e ligjit në emër të vetë atyre qytetarëve të cilët na kanë pru këtu me votën e tyre.

U tha këtu nga Qeveria në seancën e paradites se gjoja PDK-ja një herë kërkon të bëhen privatizimet e pasurive, njëherë kërkon që të mos bëhen.

Të nderuar kolegë deputet, askush nuk është fajtor që ne si institucione nuk kemi vepruar me kohë dhe të bëjmë një ndarje të një pasurie kombëtare e cila do të rezervohet nga privatizimi në këtë kohë pa kohë, sepse procedurat e përshpejtuara dhe tendenca që gjithçka të privatizohet në këtë kohë pa kohë, atëherë nuk e dimë se në duar të kujt po shkon dhe nuk e dimë se cilat grupe vendore po i mbështesin ato. U përmend nga një referues këtu se paska pasur një paqartësi në ligjin e telekomunikacionit të neni 20 dhe 36. Po që se ka zbrazësi juridike apo konfuzion në mes të dispozitave ligjore në kuadër të ligjit dhe interesi qytetarë është për të vepruar shumë shpejt për një çështje të caktuar siç është rasti me operatorin e dytë atëherë Qeverinë askush se ndalon, as neve si deputet që të bëjmë plotësimin dhe ndryshimin e atij ligji me procedurë të përshpejtuar e më pastaj të veprojmë konform ligjit.

Unë nuk dua ta zgjas më tepër se të gjitha u thanë nga kolegët e mi të grupit tim, mirëpo nuk mund të themi se nuk ka pasur shkelje, nuk mund të themi se nuk ka bazë për dyshim, por ato duhet të dokumentohen nga një organ i pavarur e pastaj të shohim se si do të veprojmë, por jo në emrin e asaj të ngutemi e shkeljet t'i lëshojmë se qenka interesi i qytetarëve. Qytetarët nuk janë të interesuar të gëzojnë benifit prej diçkaje që është në mënyrë të paligjshme, nuk duhet t'i mësojmë ne që asisoj të veprojnë sepse edhe ata dikun punojnë nëpër institucione që janë në nivel më të ulët hierarkik se Kuvendi dhe Qeveria dhe si t'i arsyetojmë ata kur i bëjnë shkeljet në vendet e tyre të punës, kur ne tolerojmë kaq shkelje të rënda. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputetja Sanije Alijaj, kurse le të përgatitet deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ – I nderuari kryesues, të nderuar ministra, të respektuar deputetë.

Është e drejtë e Kuvendit të kërkojë nga Bordi i ART-së informacion për rrjedhjen e procesit tenderues për telefoninë e dytë mobile në Kosovë, por e konsideroj se nuk është në interes të askujt të vazhdohen debate deri në atë masë sa të kërkohet anulimi i tenderit si dhe të kërkohet shkarkimi i Bordit të ART-së, pa u paraqitur fare informacioni për rrjedhjen dhe realizimin e këtij tenderi sepse po të vazhdonin debate të tilla për çdo kompani të madhe do të dekurajoheshin të thithë ata investitorë që dëshirojnë të investojnë në Kosovë. Vendimi i parë është anuluar nga Qeveria me kërkesën e shteteve anëtare të “Kuintit” kanë kaluar afër 4 vjet për të rifilluar ky proces, tani kemi të bëjmë

me një vendim të Qeverisë të marrë për këtë çështje. Bazuar në këtë vendim dhe ligjin për telekomunikacionin Ministria e Transportit dhe Post telekomunikacionit ka përgatitur pakon tenderuese, kurse ART-ja të menaxhon procesin e zgjedhjes së ofertës më të volitshme, si dhe një kompani konsultuese ndërkombëtare për mbarëvajtjen e tenderit të telefonisë së dytë mobile në Kosovë. Qeveria dhe UNMIK-u kanë nxjerrë një vendim me të cilin është themeluar komision ekspertësh në përbërje prej 5 anëtarëve. Përbërja e këtyre anëtarëve tanimë është e njohur për Kuvendin.

Kuvendi duhet të shikojë sa janë respektuar procedurat, por bazuar në dokumentet e ofruara nga ART-ja me rastin e tenderuesit të dytë të operatorit të telefonisë mobile nuk ka indikacione për shkeljen e procedurave, sepse i tërë procesi është përcjellë nga ndërkombëtarët.

Nuk është serioze për një kompani të konkurrojë dhe të mos i respektojë afatet. Dështimi i kompanisë së parë domosdo legjitimon kompaninë e dytë pa ua mohuar mundësinë e apelimit të tjerëve. Konsideroj se është e domosdoshme që Qeveria të punojë më shumë që të njihet siguria e investitorit në Kosovë për investime duke i nxjerr ligjet e domosdoshme sepse Kosova pa status të zgjidhur nuk është treg aq me interes për kompanitë e mëdha dhe të njohura ndërkombëtare. Mendoj se në këto momente shumë të rëndësishme për ne të përkrahet dhe të inkurajohet Qeveria për marrjen e vendimeve për realizimin e projekteve të mëdha që e ndihmojnë zhvillimin ekonomik e jo siç tentohet sot nga ana e opozitës me qitë Qeverinë në defanzivë për të marruar vendime të rëndësishme. Është shumë i domosdoshëm liberalizimi i tregut, në mënyrë që të eliminohen monopolizimet e vetëm një kompanie, sepse qytetarët e Kosovës me një standard më të ulët të ardhurave në Evropë detyrohen të bëjnë shpenzime të mëdha për komunikim mobil. Konkurrenca në treg ofron cilësi dhe lehtëson standardin jetësor të qytetarëve. Prandaj unë e përkrah legalizimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile se është në interesin tonë. Sjellja në Parlament për debat synohet të shkojë drejt një hapi konkret, mirëpo kërkesa për anulim të tenderit mendoj se nuk qëndron, sepse është përzjerje kompetencash, se anulimin e vendimit për tenderin e dytë të telefonisë mobile e bëjnë organet gjyqësore. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Hatixhe Hoxha, kurse le të përgatitet Xhelal Canziba.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. kryesues të nderuar deputet. Preokupimi ynë këto ditë ishte pa dyshim licencimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile sepse gjykuar në bazë të ankesave të kompanive që morën pjesë në tender dhe pas reagimeve nga masmediat dhe shoqëria civile, por edhe mbi bazën e informacioneve që na janë ofruar natyrshëm ngritët shqetësimi ynë dhe gjykuar mbi këtë bazë na krijohet opinioni se përkundër fateve se ART-ja ishte dashur të punoj mbi bazë të ligjit dhe rregullave që i ka përpiluar vetë, me gjithë atë duket se edhe ky proces është përcjellë me shkelje dhe keqpërdorime.

Të nderuar deputet dëshiroj t’ju rikujtoj se pash dështimit të pagesës së 81 milion eurove të premtuara nga “Kosovmosel”, ART-ja mori vendim të menjëhershëm që licencën t’ia kalojë tenderuesit të dytë, pra “Ipko Mobitel Sllovenia”. Edhe përkundër vërejtjeve të vazhdueshme për shkelje të ligjit siç ishte rasti nga “Telekom Austria”, që është ankuar se përbërja e konzorciumit ka qenë jo transparente dhe se e gjithë kjo është bërë në

mënyrë të paligjshme për faktin se Mobitel Sllovenia ishte partnere me z. Luka dhe e cila njëkohësisht është një nga dështuesit e pagesës prej 81 milion eurosh. Për këtë mund të shihet se fletëregjistrimi i biznesit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i cili u përmend pak më parë ka shkaktuar një paqartësi rreth konzorciumit që ka fituar tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile sipas të dhënave për Kosmocel me biznesin pronarë të sajë është një pronarë vendor me 49% dhe Telekom Sllovenia me 51%, që ku është materiali. Me këto veprime duket se ART-ja si ka bërë transparente ose e ka injoruar faktin se kompania Sllovene ka qenë pjesë e konzorciumit me z. Luka dhe me kompaninë Ipkonet.

Të nderuar deputet, dëshiroj të veçoj vetëm disa nga vërejtjet që disa nga kompanitë me zë kanë ngritur.....

Ekzistojnë fakte se firma globale e telefonisë mobile Vodafon ka hetuar parregullsi në mënyrën e bërjes së tenderit dhe për këtë ja ka tërhequr vërejtjen komisionit special,

Telenori norvegjez sipas informatave nga Mobitel Austria është duke përgatitur padi për shkak të shkeljeve që ART-ja i ka bërë në tenderim,

Edhe Kompania Kepitel Menaxhment akuzoi ART-në se anulimi i fitores së tyre në tenderin e telefonisë mobile është bërë në marrëveshje të fshehtë me një kompani vendore.

Mobilkom Austria ka njoftuar se ka kërkuar kompensim prej 100 milion eurosh për shkak të dëmit që ART-ja i ka shkaktuar kësaj kompanie, për këtë Mobilkom ka dorëzuar padi në gjykatë dhe ankesë në Komisionin Evropian dhe në zyrën ligjore të OKB-së.

Një ankesë të ngjashme lidhur me këtë çështje e ka adresuar edhe kongresmeni amerikan z. Dan Burton dhe këtë e konfirmon edhe z. Qirezi kur tha se kryeministri ka marrë një letër nga kongresisti Dan Burton me të cilën ky i fundit shpreh brengosjen e tij për dyshimet e veta lidhur me kompaninë ofertuese.

Ja këtu është edhe materiali.

Duhet të nënvizohet fakti se mundësia për të menduar se ka pasur shkelje rritet veçmas e sidomos me fatin se përfaqësuesit e UNMIK-ut në panelin vlerësues për aq sa kemi informacione janë involvuar në procedurat e tenderit vetëm 2 ditë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Nga vërejtjet e parashtruara shihet se ART-ja dhe Qeveria nuk kanë respektuar:

Ligjin për Telekomunikacionin,

Ligjin për Prokurim, si dhe dokumentacionin e tenderit.

Për fatin se:

Ka lejuar se Mobitel të paraqitet me dy oferta në cilësinë e konzorciumit Kosmocel, Mobitel plus Ipkonet.

Kompozimi i konzorciumit Kosmocel ka ndryshuar pas dorëzimit të ofertave.

Një ofertues mund të ofrojë vetëm një ofertë, ndërsa në këtë rast Mobitel ka marrë pjesë me 2 oferta.

ART-ja nuk i ka zbatuar principet e transparencës për faktin se ajo nuk u ka dhënë tenderuesve rezultatet e evaluimit që bien ndesh me standardet ndërkombëtare dhe ligjin në fuqi.

ART-ja nuk e ka bërë hapjen zyrtare të tenderit si kërkesë elementare e Ligjit.

Sipas kësaj që u tha krijohet përshtypja sikur kriteret e parashtruara nuk kanë mundësuar të përzgjidhet më i miri ,sepse:

Nga tenderi për telefoninë e dytë mobile janë larguar kompanitë më të mëdha botërore si Vodafon Austria, Mobilkom etj.

Tenderuesit e shpërblyer nuk kanë pasur eksperiencë në telefoninë mobile në asnjë treg.

Nuk është kërkuar garanci bankare për pagesën e licencës, Mobilkom Austria ka kërkuar 100 milion dëmshpërblim.

Këtu kam ankesën e Mobilkom të Austrisë që ju ka adresuar Gjykatës komunale si dhe kjo tjetra që i është adresuar Gjykatës Supreme, e ku ndër të tjera kërkohet të pezullohet zhvillimi i procedurës të tenderit deri sa të merret një vendim lidhur me ankesën që ata e kanë bërë.

Të nderuar deputet dëshiroj të ceku faktin që lidhet me nënshkrimin e deklaratës për licencë nga ana e kryeministrit Çeku. E kemi thënë edhe në një seancë të kaluar të Kuvendit se nuk është detyrë e kryeministrit të nënshkruajnë licenca. Të nderuar deputet për të sqaruar faktin se pati apo jo shkelje procedurale, apo parregullsi mbështes kërkesën për auditim të tërë këtij procesi. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit dhe lus deputetët që të kthehen në sallë. Xhelal Canziba e ka fjalën.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA – I nderuari z. kryesues, të nderuar ministra dhe ju koleg deputetë

Shkeljet ligjore dhe procedurale me rastin e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile janë të shumta.

Që në fillim dua të theksoj se me një shkresë kryesuesi i ART-së z. Anton Berisha konstaton se ART-ja ka pasur një rol shumë teknik. Kjo bie ndesh me Ligjin për telekomunikacionin.

Neni 3.1 alineja (b) citoj: ART-ja e themeluar nga ky ligj si një trup i pavarur për brenda IPQ-ve mban përgjegjësi për implementimin e politikave të IPQ-ve dhe Ministrisë të udhëhequr nga ky ligj si dhe të gjitha pjesëve legjislative në pajtim me këtë ligj. Citati mbaron, njëherri kjo shkresë bien ndesh me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 03/192 të datës 28 mars 2006.

Pika 5 citoj: Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit në pajtim me legjislacionin në fuqi zgjedh ofertën më të volitshme, mbaron citati. Menaxhimi i procesit të përzgjedhjes së ofertuesit nga ART-ja shihet edhe në vendimin e ART-së nr. 18/07 të datës 22 janar 2007, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave. Në këtë komision ART-ja nga 5 anëtarë ka pasur 2 përfshirë edhe kryetarin e Komisionit.

Z. Qemajl Ahmeti ministër i Ministrisë së Transportit dhe Postë telekomunikacionit merr vendim duke u mbështetur në rregulloren 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të IPVQ-ve. Ligji 2002/7 për Telekomunikacionin, themelon komisionin për zgjedhje të kompanisë konsulente për shpalljen e tenderit publik këtë operatorin e dytë të telefonisë mobile duke i shkelur ligjet në fuqi, si ligjin për financa publike, ligjin e prokurimit publik dhe merë kompetencat e ekzekutivit brenda Ministrisë që janë kompetencë e sekretarit, shefit të prokurimit, kur këta persona janë të autorizuar sipas ligjeve në fjalë dhe definitivisht stafi

politik nuk ka të drejtë të involvohet në procedurat e prokurimit, as në caktimet e komisionet e hapjes, as vlerësimin e ofertave tenderuese.

Është thyer Ligji për telekomunikacionin, neni 20.2 citoj: ART-ja do t'i ushtrojë të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, ART-ja e ka shkelur këtë ligj në bazë të kompanive të diskualifikuara, pasi nuk i ka bërë publike të gjitha dokumentet përcjellëse me kohë. Shkelja e radhës vazhdon kur prapë ministri i Ministrisë së Transportit dhe Post telekomunikacionit formon komisionin mbikëqyrës për procesin e përzgjedhjes së operatorit të dytë. Ky vendim është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik në Kosovë, sepse i vetmi autoritet për mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit publik të Kosovës është Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i paraparë me nenin 94 deri 121 të Ligjit 2003/17, Ligji i Prokurimit Publik.

Sikur të mos mjaftojnë këto shkelje kryeministri Agim Çeku cakton këshilltarin politik të tij në Komision vlerësues z. Arben Çirezi, këshilltar politik, këtu kemi dy shkelje. Së pari kryeministri nuk ka të drejtë me Ligj të prokurimit të formojë asnjë anëtar të çfarëdo komisioni që ka të bëjë me procedurat e prokurimit publik.

Kurse shkelja tjetër në kundërshtim edhe me Ligjin e shërbimit civil 2001/36 dhe Ligjin e prokurimit publik, kur asnjë anëtar i stafit politik nuk ka të drejtë të marrë pjesë në hapje dhe në vlerësimin e ofertave tenderuese. Shkeljet që janë bërë shihen edhe më qartë në deklaratën mbi vendimin që është joprofesionale dhe e paqartë kur thuhet se: “Komisioni mbikëqyrës nuk ka hasur në ndonjë parregullsi procedurale dhe ligjore”, kur vetë kjo deklaratë mbi vendimin për shpalljen e kompanisë fituese e nënshkruar nga kryeministri dhe kryesuesi i ART-së Anton Berisha janë në kundërshtim me ligjin 2003/17 sepse këtë të drejtë për nënshkrim e ka menaxheri i prokurimit. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Të nderuar deputetë, debati është shterrur. Fjalën e ka Demir Limaj si propozues i kësaj pike të rendit të ditës.

DEPUTETI DEMIR LIMAJ – I nderuar z. kryesues. Nga debati që u bë dhe nga të gjithë deputetët, kolegë të nderuar për çështjen e zgjedhjes së operatorit të telefonisë mobile dhe për qëndrimet që patën gati të gjitha grupet politike të Kuvendit të Kosovës si iniciues i kërkesës në emër të grupit të deputetëve duke u mbështetur edhe në qëndrimet e grupeve parlamentare që e dhanë dhe të kryeministrit, kërkoj që Kuvendi të marrë vendim për auditim të pavarur lidhur me procesin e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe në afatin prej 15 ditëve të na sjell raportin në Kuvend. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – A do ta marrë fjalën dikush nga shefave të grupeve parlamentare?

E dëgjuat propozimin e z. Limaj në emër të grupit të deputetëve që e kanë kërkuar këtë pikë të rendit të ditës, unë e qes në votim propozimin e Demir Limajt.

Pra deklarohet Kuvendi për auditim, pra Zyra e Auditorit Gjeneral të bën auditivin e procesit të tenderimit ose jo.

Shkojmë me votim.

Votojmë tash:

Për.....30

Kundër32

Abstenim2

Kuvendi e hodhi poshtë propozimin e z. Demir Limaj.

Kalojmë në pikën e të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i informatës për ngjarjet e 10 shkurtit.

Konstatimet hyrëse. Me kërkesë të 24 deputetëve e në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së punës Kryesia e Kuvendit kërkoi nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Punëve të Brendshme që të përgatitë dhe para deputetëve të paraqet informatën zyrtare për ngjarjet e 10 shkurtit 2007.

Informata e Qeverisë është proceduar në Kuvend më 16 mars 2007, ndërsa deputetëve u është shpërndarë me 19 mars 2007.

Informata për ngjarjet e 10 shkurtit ka qenë temë shqyrtimi në Komisionin Parlamentar për Siguri.

Ftoj deputetin Emrush Xhemajli ta marrë fjalën si përfaqësues i deputetëve që e kanë bërë kërkesën për këtë pikë të rendit të ditës.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Z. kryesues, z. ministër Kuçi, të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm.

25 deputetë të Kuvendit të Kosovës më 22 shkurt 2007 patën kërkuar debat në Kuvend për ngjarjet e 10 shkurtit, ku u vranë me armë zjarri 2 qytetarë të respektuar të Kosovës, Arben Xheladini dhe Monë Balaj, si dhe patën kërkuar në kërkesën me shkrim krijimin e Komisionit Parlamentar për konstatimin e kësaj ngjarjeje tragjike. Materiali i Ministrisë së Brendshme dhe ai që ka buruar nga dëgjimi parlamentar në komisionin përkatës të Kuvendit është i mirëseardhur edhe pse kualifikimet në to nuk mund të mbështeten.

Fillimisht të them se nga raporti del se SHPK-ja është e politizuar skajshmërisht. Me këtë polici që kemi nuk ka nevojë për Gjykata, ajo i din të gjitha gjërat dhe jep kualifikime politike e gjyqësore. Të nderuara znj. dhe zotërinj . Me legjislacion të vendit tonë qytetarët, subjektet e ndryshme të organizuara kanë të drejtë të protestojnë për politikën që nuk u pëlqejnë. Kanë marrë pjesë edhe në protestat që quhen demokratike në Perëndim edhe në ato që kanë qenë pa leje dhe megjithatë ato janë kualifikuar në kuadër të kornizave demokratike të shprehjes së revoltës. Kur ka dhunë të protestuesve ka reagim proporcional nga ana e policisë, por policia në Kosovë ka qenë e parapërgatitur qysh më herët për t'u dhënë një lëksion tragjik protestuesve. Një fjalë e urtë thotë: “Mos e vet se të kallxon vetë” Edhe këta të Inspektoratit të policisë në raportin në faqen 6 kanë pranuar hapur se e kanë paragjykuar protestën e 10 shkurtit 2007 me protestën e 28 nëntorit 2006, me gjithë se po të kishte rrjedhën e protestës së 28 nëntorit protesta e 10 shkurtit nuk do të quhej dështim për policinë. Pasojat materiale të protestës të 28 shkurtit ishin të riparueshme dhe si të tilla ndodhin në shumicën e protestave në Evropë që quhen shprehje demokratike e revoltës, ndërsa pasojat e 10 shkurtit nuk do të riparohen përjetë, sepse aty ka ndodhur tragjedi. Në asnjë nga informacionet nuk jepet përgjigje për pyetjen konkrete rreth përdorimit të forcës së policisë. Ndërhyrja e policisë kundër protestuesve a ishte përgjigje proporcionale apo e tepruar, në vend të përgjigjes jepen arsyetime, e arsyetime gjenden gjithmonë, Ja p.sh ndër to: Në raport thuhet se mungon legjislacioni për shkallën e përdorimit të dhunës, pastaj e dyta, ata d.m.th “Vetëvendosja,” asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë për lajmërim të protestave dhe krejt protestat e” Vetëvendosjes “janë

të paligjshme, thuhet në informatën e policisë. Me një fjalë arsytetime sa të duash, pajtohemi, protesta e paparalajmëruar edhe e pa ligjshme, por ju lutem shumë nëse dikush nuk paraqet kërkesë te policia për protestë, mos do të thotë se policia direkt po e fitojka të drejtën të vrasë njerëz, kush është përgjegjës për vrasjen dhe plagosjet del nga vetë fakti se protestuesit kanë qenë duarthatë dhe nuk kanë rrezikuar për vdekje askënd që të marrin kundërpërgjigjen me armë zjarri deri në vrasje. Është e mirëseardhur ajo si shkruhej në materialin e SHPK-së se po përpiqet të kësaj metoda dhe përvoja perëndimore, kryesisht metoda Daneze për menaxhimin e protestave publike. Kjo ndoshta ndikon që SHPK të largohet nga intervenimet në forma policore të lindjes, por për këtë nuk duhet pasur shpresë të madhe deri sa në krye të SHPK-së të jenë persona që janë kalitur qysh moti me forma policore të lindjes dhe me këto përvoja e kemi kreun e SHPK-së z. Sheremet Ahmeti dhe drejtuesit e tjerë. E di se këto që po i them duan fakte, por këto janë të mjaftueshme, pas heqjes së autonomisë së Kosovës nga Serbia në mars të vitit 1989 populli u ngrit në protesta masive dhe ato nuk u ndalën as në vitin 1990. Policia ato i shtypi me dhunë dhe në këtë shtypje ishte aktiv edhe Sheremet Ahmeti, por brutaliteti i tij u shqua sidomos më 24 janar 1990 në demonstratën e Prishtinës. Në atë kohë znj. e zotërinj në Kosovë u vranë dhjetëra demonstrues, listën e të cilëve duhet ta ketë Ministria e Drejtësisë dhe nëse nuk e ka le të urdhërojë dhe le t'i marrë. Unë këtu nuk po i lesoj se në listën e protestuesve të vuarë gjatë vitit 1989 janë 58 persona që janë me emër dhe mbiemër dhe prej nga janë, ndërkaq në listën e protestuesve të vuarë gjatë muajit janar shkurt janë 49 persona.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Të lutem përqendrohu në protestat e 10 shkurtit.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI - Jemi në protestat e 10 shkurtit se i njëjti person gjendet në krye të policisë, jemi pikërisht në temë, është për keqardhje se disa vite më vonë z. Sheremet Ahmeti dhe të tjerët që ishin pjesë e aparatit represiv në duar të Serbisë u burgosën nga okupatori, por që erdhi në kohën kur Millosheviqit më nuk i interesonte kush ku ka qenë dhe ky fakt nuk e liron nga përgjegjësia, për të cilën ne po flasim këtu. I them këto znj. dhe zotërinj se nuk ka asnjë kuptim që të jenë në krye të SHPK-së ata që kanë marrë pjesë në represionin tragjik që ka ndodhur me vite në Kosovë dhe që marrin edhe sot pjesë. Në raport nuk është thënë asnjë fjalë lidhur me sjelljen e policisë ndërkombëtare kundër protestuesve, e sidomos nuk është sqaruar përgjegjësia e policisë rumune me 10 shkurt. A kanë komunikuar pjesëtarët e kësaj njësie rumune me strukturat e Serbisë dhe a ka pasur zotime të mos them marrëveshje lidhur me rolin e tyre në këto protesta. Znj. dhe zotërinj nuk duhet harruar se pikërisht shefat politikë të policisë rumune që kanë marrë pjesë në këtë protestë, janë më të zëshmit në Bukuresht kundër Kosovës dhe pavarësisë së saj. Kemi dëgjuar se njësia rumune ka marrë lëndë nga Bukureshti lidhur me sjelljet e saja në Kosovë, madje edhe dekorata, por kësaj të fundit nuk dua t'i besoj derisa të jepet një sqarim zyrtar dhe kush ka vendosur që rumunët të marrin pjesë në menaxhimin e protestës, ka bërë një gabim thjesht elementar. Gjykatat e Kosovës pasi janë lënë me qëllimi pa mbështetje financiare dhe pa personel mbrojtës për të qenë të paafta të gjykojnë paanshëm janë po shtruar duke ua marrë lëndën e Albin Kurtit, gjykatat dhe gjykatësit ndërkombëtarë të mbuluar në çdo aspekt për të fshehur më lehtë të vërtetën rreth protestës dhe për të marrë vendime arbitrare që nuk burojnë nga vullneti i këtij populli. Nga shkresat që na kanë ardhur e kuptuam se banori i Kosovës z.

Albin Kurti ishte mirë në burg. Të vetmin kundërshtim e paska pasur punën e një konserve me barkod 680 të Serbisë dhe dëshira ju paska plotësuar- qenka zëvendësuar me një tjetër, por asgjë më tepër. Shtrohet pyetja: Çka mbërrihet me mbajtjen në burg politik. Z. Kurti praktikisht është i zënë peng dhe po mbahet peng, si po mendohet të gjykohet kur është e pamundur të bëhet kjo pa u komprometuar definitivisht ajo gjykatë dhe ata gjykatës që do ta bëjnë këtë dhe mbi të gjitha ai sistem i drejtësisë. Cili vend në botë mund të quhet i lirë kur ka të burgosur politik. Jo z. Kurti, por për mendimin tonë ata që e mbajnë në burg duhet të përgjigjen për peng marrje politike. Qarqet politike të Kosovës dhe jashtë saj kanë vendosur për arrestimin e z. Kurti me këto intervenime politike, gjykatat ndërkombëtare kanë ndërhyrë në politikë duke u instrumentalizuar në mënyrë që nuk u ka hije, andaj ne mendojmë se politika duhet të ndërhyjë jo vetëm për lirimin e z. Kurti. Për pikëpamjen tonë menaxhimi i situatës së tashme nuk bëhet me arrestime, dënime e diferencime ideopolitike, por me veprime konkrete për qetësimin e situatës dhe kjo do të përfshinte në radhë të parë të lirohet z. Albin Kurti, të rikthehet rendi dhe sundimi i ligjit, pasi ai nuk ekziston më, Të ndalohet veprimtaria antiligjore e policisë për shkatërrimin e organizimeve politike që nuk i pëlqejnë Qeverisë dhe policisë, të krijohet Komision Hetimor Parlamentar për ngjarjet e 10 shkurtit 2006, të bëhet ekspertizë e plotë dhe e paanshme se si ka ardhur deri te vrasja dhe plagosja e protestuesve.

Të suspendohen Sheremet Ahmeti, Reshat Maliqi dhe funksionarët e policisë që kanë marrë pjesë në komandim kundër protestuesve të viteve 80 – 90 ,derisa të sqarohet përgjegjësia për vrasjet e atëhershme dhe vrasjen e 2 qytetarëve tash. Të bëhet transparente sjellja dhe përgjegjësia e kontingjentit rumun gjatë protestave të 10 shkurtit. Zyrtarisht Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës përmes mekanizmave që sundojnë këtu të bëhet kërkesë Qeverisë Rumune lidhur me rolin e kontingjentit të saj në Kosovë gjatë protestave të 10 shkurtit.

Më lejoni në fund znj. dhe z. të them edhe atë që e dimë të gjithë, por shpesh po e harrojmë, e keqja Kosovës nuk i ka ardhur nga fjala dhe protesta e protestuesve duarthatë, por nga kundërshtari që dihet Serbia –antishqiptare. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputete. Fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme z. Blerimi Kuçi.

MINISTRI – BLERIM KUÇI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë. Në materialin që e keni edhe ju para vetes, përveç informatën e protestës së 10 shkurtit është edhe një raport i Inspektoratit të policisë. Po ashtu në këtë material është edhe një informatë nga Shërbimi Policor i Kosovës. Normalisht që unë jam munduar ta bëj një rezymë për të mos ju lodhur juve dhe për të mos jua humbur kohën, Me rëndësi është që ju atë material e keni në përgjegjësi. Kjo rezymë lidhur me informatën e protesës së 10 shkurtit unë e kam quajtur informatë mbi protestën e 10 shkurtit. Fillimisht konstatojmë se ngjarjet e 10 shkurtit rënduan gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe dëshmuam se sa e brishtë është gjendja e sigurisë me të drejtë të cilësuar si stabile, por e ndjeshme. Gjatë kësaj periudhe vendimtare për përcaktimin e statusit final të Kosovës, po ashtu shpresojmë se ngjarjet që pasuan 10 shkurtin bindën të gjithë, elitën aktuale politike, apo ekipin e Unitetit që është bartës i procesit të definimit të statusit final, institucionet e Kosovës, mekanizmat e sigurisë që janë përgjegjës për sigurimin e të gjithë qytetarëve të

Kosovës e edhe qytetarët e pakënaqur me rrjedhën e definimit të këtij statusi që dëshirojnë këtë pakënaqësi ta manifestojnë duke protestuar se pa maturi, pa pjekuri të përhershme politike dhe bashkërenditje dhe koordinim të veprimit të stabilitetit të gjendjes së sigurisë mund të luhatet.

Ngjarjet e 10 shkurtit si asnjëherë më parë në një protestë pas ngjarjeve të marsit 2004, sidomos që qe rezultuar me humbjen e jetës së 2 protestuesve, tërhoqën vëmendjen e opinionit kosovar dhe më gjerë. Në këtë rast edhe njëherë shfrytëzoj rastin të shprehi ngushëllime familjarëve të vdekurve.

Faktorët si humbja e jetës së protestuesve, procesi i protestës së 10 shkurtit në përgjithësi, reagimet e strukturave relevante vendore dhe ndërkombëtare politike të sigurisë gjatë dhe pas 10 shkurtit, ndjenja e brishtë e gjendjes së sigurisë që u thellua pas 10 shkurtit 2007, si dhe vëmendja dhe interesimi i opinionit e bënë kërkesën e Parlamentit të Kosovës plotësisht legjitime, kurdoherë të diskutohet për këtë ngjarje dhe një javë pas mbylljes së bisedimeve për definimit e statusit final të Kosovës në Vjenë.

Për këto arsye Ministria e Punëve të Brendshme, paraqet informatën e kërkuar nga Kryesia e Kuvendit për **ngjarjet e 10 shkurtit 2007. Kjo informatë raportit** zyrtar të Shërbimit Policor të Kosovës lidhur me këto ngjarje që ka më tepër karakter të shpjegimit të ngjarjeve në nivel operacional dhe raportet e Inspektoratit policor të Kosovës që shqyrton sjelljen e SHPK-së gjatë trazirave të qytetarëve në Prishtinë me 10 shkurt 2007. Në këtë informatë i kemi bashkangjitur edhe informatën e policisë në Protestën e 10 shkurtit edhe përmbledhjen e raportit të IPK-së, ndërsa raporti i plotë i Inspektoratit policor të Kosovës e kemi bërë publik edhe më herët dhe atë mund ta gjeni në Ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pra kjo informatë që paraqesim në Kuvend politikisht kompletton raportet e bashkangjitura duke përshkruar dhe analizuar prej pikëpamjet politike çështjet në vijim.

Rrjedhën e protestës së 10 shkurtit, raportin e policisë, raportin e IPK-së dhe vazhdimin e hetimeve, rolin e institucioneve, zhvillimet pas 10 shkurtit për të përmbledhur këtë informatë me rekomandime. Duhet thënë se gjatë përpilimit të kësaj informate është pasur parasysh roli i kufizuar në aspektin e autorizimeve të një dege specifike të dikasterit siç është Ministria e Punëve të Brendshme ndaj faktorëve aktual të sundimit të ligjit. Gjithashtu duhet cekur se Ministria e Punëve të Brendshme ka paralajmëruar në disa paraqitje publike dhe brenda tatimeve zyrtare përfshirë këtu edhe raportin e fundit në disa paraqitje publike të punëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kuvend. Si sfidë të mundshme protestat pas propozimit të presidentit Ahtisari, më saktë Ministria e Punëve të Brendshme ka radhitur si sfidën kryesore për gjendjen e sigurisë në Kosovë procesin e përcaktimit të statusit të Kosovës, duke spikatur se propozimi që pritet të bëhet së shpejti publik mund të zgjoj pakënaqësi të individëve apo grupeve të caktuara të vogla në Kosovë. Për më tepër gjatë këtij raporti në mënyrë shumë eksplicite ka cekur se bazuar nga aktivitetet dhe veprimet e shfaqura në forma protestash ,duke përfshirë edhe veprimet e dhunshme gjatë protestave të organizuara nga “Vetëvendosja.”

Konsiderojmë se veprimet dhe format e këtilla mund të paraqesin sfidë dhe provokim për rendin dhe qetësinë në Kosovë.

Rreth rrjedhës së protestës së 10 shkurtit. Ministria e Punëve të Brendshme në takimet me komisararin e policisë dhe zëvendëskomisararin nga SHPK-ja na kërkuar raportet zyrtare nga policia lidhur me këto ngjarje. Më tutje kjo kërkesë është bërë edhe me shkrim me datën 14 shkurt 2007 me anë të së cilës janë kërkuar në veçanti shpjegimet lidhur me të gjitha

çështjet që kanë të bëjnë me rrjedhën dhe procedurat e veprimeve të ndërmarra gjatë protestës së 10 shkurtit. Me datën 12 mars 2007 Ministria e Punëve të Brendshme ka marrë një informatë nga policia mbi zhvillimet, planifikimin dhe veprimet e policisë për protestën e 10 shkurtit.

Sipas informatës së policisë të dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme më 12 mars, planifikimi për 10 shkurtin është bërë në bashkëpunim të Policisë Ndërkombëtare dhe SHPK-së, ndërsa KFOR-i ka pasur një rrol të limituar mbështetës, por sidoqoftë ata kanë qenë të përfshirë në procesin e planifikimit. Inteligjenca ka theksuar se grupi “Vetëvendosja” ka pasur për qëllim dëmtimin e pronës dhe thyerjen e gardhit, pra barrikadës së policisë sikur të ishte e mundur. Synimi i policisë ka qenë ndalimi i shkatërrimit masiv të pronës së qytetarëve dhe lëndimit të oficerëve dhe demonstruesve. Komanda dhe kontrolli i përgjithshëm i këtij operacioni ka qenë në shtabin qendror të policisë.

Rreth orës 15,20 z. Kurti ka ftuar demonstruesit të largojnë barrikadat, masa është paralajmëruar përmes megafonit që të mos i largojnë barrikadat dhe të qëndrojnë mbrapa, masa ka refuzuar dhe këmbëngulte të veprohet sipas urdhrit të Kurtit, aq më tepër dhe me vrull kanë vozitur kamionin duke thyer barrikadën dhe 351 shishe me ngjyrë janë gjetur më pas në kamion, gurë, shkospinjë dhe gjësende të tjera janë hedhur mbi policinë të cilat provonin të mbanin masën që të mos e thyejnë portën e ndërtesës qeveritare.

Pajisjet mbrojtëse individuale, siç janë shufra policore prej djegies janë përdorur dhe ishin të pa efektshme ndaj masës. Gazi lotsjellës është përdorur në një interval prej 2 orësh pa arritur efektin e dëshiruar, janë përdorur gjithashtu, pushkët për projekte plastike. Njësitë policore të formuara të Rumanisë dhe të Polonisë janë të vetmet njësi me pajisje të tilla. Detajet e mëtejme në këtë çështje janë çështje e hetimeve të pavarura. Si pasojë e këtyre protestave 72 civil kanë kërkuar përkujdesje mjekësore për lëndime të lehta, 4 prej tyre me lëndime serioze dhe dy nga ata kanë vdekur. Po ashtu edhe 6 oficer të SHPK-së dhe 5 të policisë ndërkombëtare kanë marrë lëndime të lehta, janë dëmtuar dy vetura të OKB-së, një veturë e Ministrisë së Kosovës, dy vetura civile janë thyer dritare në një restorant dhe një butik.

Për shkelje të ligjit janë arrestuar 13 protestues, si dhe lideri i “Vetëvendosjes” z. Albin Kurti. Rasti i tij është në Departamentin e Drejtësisë. Në ndërkohë PSPP-ja ka shpallur kërkime të pavarura për hetimin e rrethanave për lëndimin fatal të Mon Balajt dhe Arben Xheladinit. Inspektorati i policisë së Kosovës po i mbikëqyr hetimet. Si rezultat i ngjarjeve të 10 shkurtit janë marrë të paktën këto masa, është krijuar një **taskforc** që merret me hetimin e rastit që nga fillimi i protestës e deri në fund. Në kuadër të këtij hetimi përfshihen edhe të gjitha hetimet kriminale në bashkëpunim edhe me prokurorinë. Ministria e Punëve të Brendshme në kuadër të kompetencave të veta ka angazhuar menjëherë Inspektoratin Policor të Kosovës që të bëjë hetimet në vazhdim, përkatësisht që të merr rolin e vetë inspektues në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe obligim ndaj familjeve, qytetarëve dhe opinionit publik e veçanërisht lidhur me rastet e rënda që kanë rezultuar me vdekjen e dy personave. Më saktësisht Inspektorati Policor i Kosovës është angazhuar në dy rrafshë, të hetohet procedura dhe veprimet e përgjithshme të SHPK-së gjatë kësaj proteste dhe të mbikëqyr inspektimet e Policisë Ndërkombëtare për procedurat edhe veprimet gjatë asaj dite. Inspektorati policor i Kosovës ka përfunduar raportin e inspektimit të tij mbi procedurat dhe veprimet e përgjithshme të SHPK-së dhe këtë raport ja ka dorëzuar Ministrisë së punëve të Brendshme me 1 mars 2007. Këtë

raport ne më pas e kemi dërguar edhe tek presidenti, kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe më pas e kemi publikuar edhe në media.

Pas protestave të dt. 10 shkurt në kuadër të kompetencave të sajë ndaj SHPK-së ministria e Punëve të Brendshme ka kërkuar të njoftohet për planet operative të SHPK-së, pa qëllimi të ndërhyrjes në ato plane, njoftimi ka qenë vetëm një informim verbal i shkurtër gjatë takimeve me SHPK-në dhe jo i detajizuar sa i përket këtij operacioni. Në rrethanat aktuale, përgjegjësia e përgjithshme mbi SHPK-në i takon Komisarit ndërkombëtar dhe PSPP-së. Gjithashtu duhet theksuar edhe njëherë se ndonëse llogaridhënia kërkohet kryesisht nga një adresë lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë, pra në Ministrinë e Punëve të Brendshme, adresimi ndaj strukturave legjitime janë të fragmentuara në faktorët jashtë Ministrisë së punëve të Brendshme, pra edhe në këtë situatë ndërkombëtarët kanë qenë të mandatar ta menaxhojnë situatën edhe në aspektin operativ edhe në atë politik, përkundër se ka ekzistuar një presion i madh publik dhe një perceptim të ndërhyrjes së politikës në çështjet policore ekziston një vendosshmëri e thellë që një tendencë ose veprim i tillë është i pamundur dhe i papranueshëm e sidomos në rrethanat aktuale politike të vendit. Një veprim i tillë do të ulte dukshëm besimin te faktori politik vendor dhe do ta ngadalësonte procesin e bartjes së kompetencave.

Zhvillimet pas 10 shkurtit. Zhvillimet pas 10 shkurtit janë karakterizuar me dorëheqjen e ministrit të Punëve të Brendshme z. Fatmir Rexhepi e më pas edhe të komisarit të Policisë z. Stefan Kurtis, këto veprime kanë ndikuar mjaft shumë në uljen e tensioneve në përgjithësi në Kosovë e sidomos apeli i z. Rexhepi ka qenë ruajtja e qetësisë dhe stabilitetit në vend, ndërsa dorëheqja e tij ka qenë akt moral pas ngjarjeve të 10 shkurtit, ndërkohë gjykata i pat dhënë 30 ditë paraburgim liderit të Vendosijes z. Albin Kurti. Rreth tri javë më pas me 3 mars lëvizja “Vetëvendosje” organizoi një protestë tjetër në Prishtinë e cila kaloi e qetë dhe pa incidente, disa ditë me radhë liderët e vendit, Qeveria, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera bënë apel për mos dhunë në këtë protestë. Sipas informativ të policisë rreth 2.000 persona protestuan rreth 2 orë në Prishtinë, ndërsa policia u kujdes që në asnjë mënyrë të mos provokojë masën. Ne kemi përshëndetur si policinë për qasjen e saj demokratike dhe profesionale, po ashtu edhe qytetarët për sjelljet e tyre paqësore gjatë protestës së 3 marsit.

Përmbledhjet dhe rekomandimet.

Shikuar në përgjithësi humbja e jetës së dy protestuesve dhe implikimet politike kanë ngritur interesimin të opinionit Kosovarë lidhur me protestën e 10 shkurtit 2007. Kjo protestë edhe si e paralajmëruar si paqësore sipas informatave zyrtare nga policia, pas thirrjes së z. Kurti është filluar me thyerjen e barrikadave dhe sulmi ndaj pjesëtarëve të policisë, pasojat nga ajo protestë i theksuam më lartë.

Hetimet në aspektin kriminal të kryera në kuadër të **taskforcës** për derisa Ministria e Punëve të Brendshme ka angazhuar inspektoratin e policisë të Kosovës të hetoj procedurat dhe veprimet e përgjithshme të SHPK-së gjatë kësaj proteste dhe të mbikëqyrë inspektimet e policisë ndërkombëtare për procedurat dhe veprimet gjatë asaj dite. Raporti nga IPK-ja është finalizuar dhe përcjell autoriteteve relevante.

Sidoqoftë Ministria e punëve të Brendshme duke pasur parasysh të gjitha, në këtë fazë sugjeron rekomandimet në vijim:

Që me gjasë se do të plotësohen me rekomandime shtesë pas diskutimit në Kuvend. Rekomandimet e IPK-së të jenë bazë për politikën zhvillimore të Shërbimit Policor të

Kosovës dhe realizimi i tyre të bëhet në nivelin afatshkurtër eventualisht për aktivitetin me rëndësi më të ulët strategjike dhe poste të lartë në nivelin afatmesëm.

Të insistohet në transferimin e kompetencave në planin politik prej PSPP-së tek Ministria e Punëve të Brendshme dhe atë operacional prej policisë së UNMIK-ut tek SHPK-ja, kjo e fundit sidomos në aspektin e planifikimit të implementimit të planeve operationale të përballjes me protesta eventuale.

Në mënyrë urgjente të organizohen trajnime shtesë dhe të kemi pajisje adekuate për ballafaqim me protestat e qytetarëve për pjesëtarët e SHPK-së. Duhet inkurajuar dialogimi me të gjitha grupet e interesit dhe me to të pakënaqura në procesin e definimit të statusit dhe kjo duhet bërë në suaza të përgjegjësive institucionale, por edhe atyre kombëtare.

Institucionet Kosovare dhe faktori politik kosovar duhet t'i bashkërendisim përpjekjet dhe këto veprime duhet të jenë koherente në situatat e ngjashme kur të rrezikohet situata e sigurisë në vend. Sidomos në periudha kritike për të ardhmen e tij. Për më tepër të apelohej për punë konsultative të gjitha partive politike në kuadër të sistemit politik në Kosovë në të mirë të gjendjes stabile dhe sigurisë, zhvillimeve dhe rrjedhës së proceseve për pavarësimin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. fjalën e ka kryetari i Komisionit përgjegjës raportues Naim Maloku

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit i nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar. Komisioni Parlamentar për Siguri në kuadër të kompetencave që i ka marrë nga ky Kuvend me rastin e ngjarjeve të 10 shkurtit ka organizuar dëgjimi para Komisionit për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Shërbimin Policor të Kosovës të mbajtur më 15 shkurtë 2007.

Që në fillim të këtij prezantim tim dua t' ju njoftoj se dëgjimin me dyer të mbyllura të këtyre dy segmenteve të sigurisë e kanë lëshua dy deputetë, anëtarët e Komisionit, në mënyrë demonstrative nga Partia Demokratike e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Komisioni Parlamentar për Siguri në fund të dëgjimit të këtyre dy mekanizmave të sigurisë në Kosovë ka ardhur në këto përfundime. Vlerësojmë lartë dorëheqjen e ministrit Fatmir Rexhepi si akt moral dhe se ky akt ka ndikuar pozitivisht në zbutjen e tensioneve të krijuara si rrjedhë e demonstratave, pavarësisht se nuk ka pas ministri përgjegjësi direkt për këto ngjarje.

Komisioni Parlamentar për Siguri vlerëson dorëheqjen e komisionarit të Policisë Stefan Kurtis i cili ,gjithashtu, do të ndikoj dhe ka ndikuar pozitivisht në uljen e tensioneve dhe në zbardhjen e rastit në tërësi

Komisioni kërkon hetimet e detajizuara siç edhe e ka bërë të ditur në letrat e dërguara institucioneve të sigurisë nga ky Komision në sjelljen e shërbimit Policor të Kosovës dhe Policisë së UNMIK-ut gjatë protestës.

Komisioni është i shqetësuar me përdorimin e plumbave të gomës dhe vlerëson se një përdorim i tillë sidomos në afërsi dhe duke vënë në shënjestër konkën dhe pjesët vitale të trupit është e papranueshme. Komisioni ,gjithashtu, vlerëson si të papranueshme dhe të jashtëligjshme dhunën e shkaktuar nga protestuesit dhe qëllim që të vandalizohet prona publike dhe konsideron se është formë joadekuatë shprehjes së pakënaqësisë në mënyrë publike.

Komisioni shpreh besimin tek institucionet e drejtësisë për trajtim të drejtë dhe adekuatë të personave në paraburgim nga lëvizja “Vetëvendosje” dhe në të njëjtën kohë pa asnjë parashikim dhe për hir të transparencës kërkon informim të Komisionit lidhur me trajtimin e këtyre personave nga Ministria e Drejtësisë.

Të nderuar deputetë,

Nga ajo ditë Komisionit Parlamentar për Siguri i kanë ardhur raportet nga këto subjekte nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga Ministria e Drejtësisë, në lidhje me trajtimin e të burgosurve dhe gjendjen e tyre dhe nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Komisioni Parlamentarë për Siguri nuk ka marrë përgjigje në letrën e dërguar Komisionerit të Policisë z. Stefon Kurtis apo zëvendësit të tij.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që t’i them disa fjalë në emër të Komisionit në lidhje me raportin e Inspektoratit Policor të Kosovës i drejtuar Komisionit Parlamentar për Siguri i cili përmban 26 faqe. Raporti në fjalë është i punuar në mënyrë profesionale, unë përgëzoj Inspektoratin Policor të Kosovës për arritjen e shkallës së profesionalizmit në hetimin e rastit, duke marrë parasysh se ky segment apo agjencion i pavarur për hetimet në polici është ende në ngritje e sipër dhe trajnim dhe ende i paplotësuar me kuadro të mjaftueshme.

Nga ky raport të nderuar deputetë, dalin dy çështje: Inspektorati Policor i Kosovës ka bërë hetimet vetëm të sjelljes së Shërbimit Policor të Kosovës ndërsa jo të Policisë së UNMIK-ut. Sigurisht për shkak të kompetencave që nuk i ka në hetimin e Policisë së UNMIK-ut. Nga hetimi që po e përsërisë edhe një herë i kryer në mënyrë shumë profesionale i sjelljeve të Shërbimit Policor të Kosovës nga Inspektorati Policor i Kosovës del se Shërbimi Policor i Kosovës më 10 shkurt ka qenë i paorganizuar dhe në rastin e demonstratave pa komandë të mirëfilltë dhe pa veprim të koordinuar. Kjo edhe për një arsye. Shërbimi Policor i Kosovës për herë të parë është përballë me situata të tilla Shërbimi Policor i Kosovës apo Njësia Regjionale, njësitë regjionale për mbështetje operative kanë qenë të trajnuara në dy modele të ndryshme, Njësia Regjionale për mbështetje operative që ka ardhur nga Peja ka qenë e trajnuar në modelin që e aplikojnë karabinieria italiane ndërsa njësitë e tjera regjionale për mbështetje operative kanë qenë të trajnuara në modelin danez që do të thotë modeli defensivë.

Pjesëmarrje në një komandë dhe në një detyrë të këtyre njësive të trajnuara me koncepte të ndryshme ka pas ndikim të madh në shfaqjen e asaj të atij dezorganizimi të vetë Shërbimit Policor të Kosovës. Mendimi im personal është, ju lutem kufizohem pra nga Komisioni se Shërbimi Policor i Kosovës nuk ka reaguar fare, pra reagimi i tij ka qenë në panik pasi që masa prej 200, 300 protestuesve ka shpërthye do të thotë barrikadën e hekurit, pastaj kordonin e policisë dhe për tetë sekonda në atë panik ka përdorë sasi të tepërt edhe Shërbimi Policor i Kosovës te gazi lotsjellës, pra paniku ka shkaktuar të veten që është përdorur sasi e tepruar e gazit lotsjellës dhe pajisjet mbrojtëse nuk i ka përdorur vetë shërbimi, pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, ka bërë që një numër i madh i tyre në minutat e parë të qitet edhe jashtë rendit.

Të nderuar deputetë. Më lejoni që në emër të Komisionit Parlamentar për Siguri, ti sugjeroj Shërbimit policor të Kosovës, që në mënyrë shumë serioze ti merr raportin e Inspektoratit të Policisë, që del si hetim i Shërbimit policor të Kosovës, dhe ti eliminoj të gjitha pjesët negative, të gjitha dobësitë të cilat janë identifikua me këtë hetim të inspektoratit policor të Kosovës. Mos eliminimi i këtyre dobësive, do të vonon procesin e bartjes së kompetencave nga Policia e UNMIK-ut në Shërbimin Policor të Kosovës.

Dua t' jua përkujtoj të nderuar deputetë, se Komisioni Parlamentar për Siguri, dy herë ka vizitua Qendrën për trajnim në Vushtrri, kemi të bëjmë për nisi të cilat kushtojnë shumë shtrenjtë, i kushtojnë shumë buxhetit të Kosovës, trajnimi i tyre dhe pajisjet që ata i kanë janë vërtet të shtrenjta. Është kryer një trajnim, siç thashë, në dy modele të ndryshme, Shërbimi Policor i Kosovës seriozisht duhet të merret me mënjanimin dhe eliminimin e dobësive që janë shfaqur në reagimin e Shërbimit policor të Kosovës gjatë protestave të 10 shkurtit.

Të nderuar deputetë!

Për Kuvendin ,për Qeverinë dhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme, sugjerimi duhet të dalë nga ky Kuvend. Ligji për tubimet publike dhe protestat ka qenë në shqyrtim në mandatin e kaluar, por nuk ka hyrë në fuqi dhe se duhet ta kthejmë në Kuvend dhe Kosova të bëhet me ligj, për tubime publike dhe protesta.

2. Sa më shpejt nga Ministria e Punëve të Brendshme duhet të procedurat në Kuvend Ligji për përdorimin e forcës, nga policia pra. Është ligj i veçantë, që duhet të procedohet në Kuvend dhe quhet Ligji për përdorimin e forcës dhe ligji për përdorimin e armëve në situata ku ato duhet të përdoren. Pra Shërbimi policor i Kosovës ka qenë edhe pa këtë ligj, nuk ka pasur ligj, për përdorimin e forcës. Kjo ishte në emër të Komisionit Parlamentar për Siguri. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Në radhë janë shefat e partive politike. Fjalën e ka zoti Alush Gashi

DEPUTETI, ALUSH GASHI- Ju faleminderit zoti kryetar, ne si grup parlamentar jemi marrë për këtë çështje që nga dita e parë, duke respektuar të drejtën për protestë. Më lejoni të them se kemi qenë të trishtuar, nga lajmi për vrasjen e protestuesve paqësorë dhe ripërsërisim se tash ndiejmë dhimbje me familjarët, me të gjithë ata që kanë qenë të

përfshirë në këtë tragjedi. Si grup parlamentar e mirëpresim mendimin në tri nivele e presim fjalën e ministrit dhe në veçanti e mbështesim punën e Komisionit Parlamentar në pjesën e hetimit të analizës si dhe të rekomandimeve. Kërkojmë nga organet e sigurisë, që t'i shtojnë angazhimet në kuadër të mundësive ekzistuese, deri në implementim të rekomandimeve, të shtruara sot nga Komisioni parlamentar për siguri.

T'i shtojnë angazhimet që edhe me kapacitete ekzistuese të sigurojnë jetën e protestuesve në protesta paqësore. Ne dëgjuam nga propozuesi, respektivisht, numri i deputetëve që e kanë kërkuar këtë raport se kërkojnë edhe një hetim tjetër. Ne jemi të përkushtuar që t'i mbështesim të gjitha proceset që do ta ngrisin nivelin e sigurisë në vendin tonë, por do të jetë një siguri e cila do ti respekton të gjitha normat demokratike. T'i respektojmë vlerat e vendeve demokratike, në të cilat Kosova synon. Andaj, çështja e formimit eventual të ndonjë trupi apo Komisioni hetues, nuk e di sa mund të ofron pas këtij rekomandimi të Komisionit parlamentar për siguri.

Ne nuk e kundërshtojmë një mundësi të tillë, por lusim që t'i jepet mundësi zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Parlamentar dhe natyrisht nëse gjatë seancës ka ide të cilat e begatojnë rekomandimin ne do t'i mirëpresim. Edhe një herë ju falënderoj për punën si Komision Parlamentar. Falënderoj ministrin dhe Inspektionin Policor të Kosovës, që në këtë tragjedi, ku e kanë humbur jetën dy qytetarë të Kosovës, kanë filluar institucionalizimin në një qasje tjetër, një qasje të një përgjegjësie të cilën fatkeqësisht, ne nuk e kemi pasur në jetën tonë publike as parlamentare, me rastin ngjarjeve të marsit 2004, ku kanë humbur jetën 19 qytetarët të Kosovës dhe ne nuk kemi pasur as një hetim, të niveleve të cilat i kemi sot.

Andaj, ne jemi shumë të përkushtuar si grup, që gjendja e sigurisë në Kosovë, të jetë e nivelit e cila do të garantojë paqe dhe siguri në vendin tonë dhe duket që ndërtimi apo ngritja e kapaciteteve të organeve të sigurisë në Kosovë, është një prioritet të cilin ne e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të PDK-së, deputeti Jakup Krasniqi,

DEPUTETI, JAKUP KRASNIQI – Zoti kryetar! Të nderuar deputetë është një e vërtetë e madhe që po të krahasohen vitet e kaluara me këtë që po ndodh tani, ka një ndryshim cilësor. Por, megjithatë dua ta them se informata nuk sjell informacione të bollshme për protestën ku gjeten vdekjen dy njerëz dhe u plagosën dhjetëra të tjerë. Ne jemi të bindur se kërkesat e protestuesve janë anakronike e paragjyqese për statusin politik të Kosovës. Për faktin se populli i Kosovës ka vetëvendosur për të ardhmen e tij me luftë çlirimtare dhe nuk ka për një popull të pushtuar vetëvendosje më të fuqishme se lufta çlirimtare. Edhe lufta ne të gjithë e dimë se ndodhi pasi populli shqiptar i Kosovës dhe qytetarët e Kosovës i shfrytëzuan të gjitha format e shkrimit dhe të shlyerjes së parullave, pasi përdori të gjitha format e protestave dhe të demonstratave paqësore aktive e pasive.

Prandaj lufta çlirimtare është ajo që ka krijuar këtë realitet që e kemi sot dhe ne vetë jemi prodhues të saj. Kosova tani po e pret njohjen ndërkombëtare nga organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Sigurimit dhe jemi të bindur se bashkësia ndërkombëtare,

Këshilli i Sigurimit dhe gjithë mekanizmat e tjerë, do të respektojnë vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Përndryshke kjo njohje mund të shtyhet, por populli shqiptar, nuk pranon fat tjetër përveç atij fati që e ka përcaktuar në luftën e tij çlirimtare.

Ne jemi të bindur se populli i Kosovës, për të realizuar të realizueshmen nuk ka nevojë për protesta të dhunshme, e as për flijimin e jetërave të njerëzve, as për plagosje e gjymtime, Kosova ka nevojë për jetën e njerëzve. Por as Kosova, as qytetarët as institucionet e saj nuk kanë burgje dhe nuk paguajnë njerëz për ato burgje për të burgosur njerëzit për bindjet e tyre politike. Ne jemi të bindur se në këtë sallë ka shumë njerëz që me vite të tëra kanë kaluar në burgje për bindjet e tyre politike. Dhe mendoj se koha e të burgosurve politikë ka kaluar. Ajo çka me shqetëson mua dhe Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike është që, si organet e ndjekjes të hetuesisë, prokurorisë, gjyqësisë, që shtatë vite në Kosovë kanë ndodhur shumë vepra kriminale- të krimit politik, të krimit ekonomik, të kontrabandës, trafiqeve të ndaluara e shumë veprave tjera që janë të dënueshme dhe këto organe të drejtësisë dhe sigurisë nuk kanë treguar aftësi për t'i futur në burgje kriminelët që duhet të jenë prapa grilave.

Por kanë pasur mundësi dhe kanë mundësi t'i mbajnë prapa grilave njerëzit se kanë bindjet politike, kanë pikëpamje politike, ndonëse të gabuara e vjetruara, por nuk e kanë vendin aty, ata njerëz që kryesisht janë të ri, duhet të jenë në liri. Ata njerëz nuk bënë të mbahen burgjeve. Prandaj kisha kërkuar nga organet e sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë. Kriminelët le t'i sjellin prapa grilave, ata që rrezikojnë të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës e kanë vendin në burgje. Por je njerëz se kanë bindje politike. Njerëzit për bindje politike duhet të jenë në liri, duhet të jenë familjet e tyre dhe duhet të jenë jashtë burgjeve. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA, GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit, i nderuari zotëri kryetar, të nderuar ministra, Grupi Parlamentar i AAK, me shumë seriozitet e ka shqyrtuar raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe dëgjo me shumë vëmendje raportin e Komisionit të prezantuar nga Kryetari i Komisionit zoti Naim Maloku. Na i mbështesim të dy raportet dhe përgëzojmë sidomos Komisionit në punën që ka bërë, që ishte një sqarim i hollësishëm i tërë situatës.

Për Grupin Parlamentar të Aleancës siguria është prioritet si dhe zbatimi i ligjit mbrojtja dhe ruajtja e pronës dhe mbi të gjitha ruajtja e jetëve të qytetarëve të Kosovës. Nga raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kemi kuptuar se megjithatë në përgjegjësi të tyre të jenë të limituar, kurse përgjegjësia e përgjithshme mbi Shërbimin Policor të Kosovës i takon komisarit ndërkombëtar. Dëshiroj së pari të shprehë mendimin e grupit parlamentar se ne përkrahim dhe mbështesim të shprehurit demokratik, të një mendimi tjetër, por në mënyrë të qetë dhe pa dhunë, dhe jemi kundër çfarëdo përdorimi të dhunës në këtë ushtrim demokratik.

Gjithashtu , për grupin parlamentar janë të papranueshëm përdorimi i plumbave të gomës ,siç e theksoji edhe kryetari i Komisionit në pjesët vitale të trupit. Në raport qëndron se,

vetëm nisia polake e policisë ndërkombëtare dhe e rumune ka pasur pushkët për projektme plastike, por nuk ka informata më shumë se këta. Dëshiroj gjithashtu në emër të grupit të shpreh ngushëllimet e mia e grupit për humbjen e jetëve dy qytetarëve Mon Balajt dhe Arben Xheladini, shprehë ngushëllime dhe keqardhjen familjes së tyre.

Gjithashtu ,sa i përket inspektoratit policor të Kosovës, konsiderojmë se kanë bërë një punë të mirë dhe në këtë aspekt lidhur me raportin e Ministrisë por edhe të inspektoratit do të përqendrohem në tri pika.

E para është, pikërisht rekomandimi se duhet të bëhet sa më shpejtë bartja e përgjegjësi në aspektin politik, por edhe në fushën e sigurisë, se nevojitet profesionalizimi i mëtijmë i shërbimit policor të Kosovës, qoftë në fund të trajnimeve por edhe të mjeteve të pajisjes me mjete të nevojshme. Natyrisht ashtu që ajo të jetë e gatshme me u ballafaqua me trazirat e mundshme konform autorizimeve që ka.

Një tjetër është sidomos vërejtja e inspektoratit se zyrtarët e SHPK-së janë trajnuar në sistemin e parimit të nisive taktike mobile, por kjo nuk është përdorur në protestat e 10 shkurtit. Prandaj ne përkrahim rekomandimin e inspektoratit që këta zyrtarë duhet t'u nënshtrohen trajnimeve të ricertifikimit. Gjithashtu, mbështesim rekomandimin e Komisionit për plotësimin e infrastrukturës ligjore lidhur me ligjet e përmendura, sepse konsiderojmë se ato jo vetëm që do të ndihmojnë menaxhimin e tubimeve në të ardhmen, por gjithashtu ,do të parandalojmë dhe shmangin përdorimin e dhunës si nga ana e policëve ashtu edhe nga ana e shkelësve të ligjit.

Në fund mendojmë se task-forcë duhet sidomos të përshpejtojë punën e vetë, dhe hetimet e prokurorisë të kryhen më shpejtë, të përfundojnë ,sepse çdo zvarritje, e këtyre hetimeve do të ndikojë negativisht në opinionin e qytetarëve. Insistojmë pra që procesi i hetuesisë të kryhet, ftojme qytetarët e Kosovës që një kohë kaq të rëndësishme për të tanishmen dhe të ardhmen e qytetarëve tonë, por edhe të ndjeshme të ruajnë qetësinë dhe gjakftohtësinë dhe një fund edhe një herë ju theksoj se Grupi Parlamentar i AAK respekton dhe përkrahë të drejtën demokratike të shfaqjes së mendimit dhe veprimeve në mënyrë të qetë dhe paqësore. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të orës Teuta Sahatqiu,

DEPUTETJA, TEUTA SAHATQIU, - Ju faleminderit zoti kryetar!

Më lejoni që në emër të grupit parlamentar dhe në emër të partisë të shprehi gjithashtu të bashkëngjitë ngushëllimit të familjeve të protestuesve të cilët vdiqën gjatë protestave të 10 shkurtit dhe gjithashtu të shprehi keqardhje dhe për familje tjera dhe për individ tjerë të cilët u lënduan gjatë këtyre demonstratave gjatë këtyre protestave. Protestat janë një e drejtë demokratike e cila nuk duhet të ndalohet, por e drejtë në bazë të së cilës qytetarët, grupimet e ndryshme, në mënyrë paqësore, në mënyrë demokratike do të duhej të shprehin mendimet dhe, mendimet e tyre me mënyrë paqësore ti shprehin mendimet e tyre. Por protestat do të duhej sikur edhe çdo gjë tjetër ti nënshtroheshin rregullave, ti nënshtroheshin ligjit dhe që institucionet të respektohen në atë mënyrë në të cilën ato do të duhej të respektohen.

Edhe ne si opozitë shpeshherë kemi shprehur mendimin që nuk jemi të kënaqur me veprimin e institucioneve, por në këtë fazë në të cilën ne jemi duke dashur të dëshmojmë që jemi të pjekur për shtet dhe jemi të pjekur për sundimin e ligjit. Mendoj që secila anë do të duhej në mënyrën e vet, me fuqinë e vetë të japë kontributin e vetë për sundimin e ligjit dhe për respektimin e institucioneve.

Është për t'u përshëndetur dorëheqja e zotit Fatmir Rexhepi, ish- ministrit të Punëve të Brendshme, e cila së pari si akt moral dhe pastaj edhe si veprim i cili shkaktoj uljen e tensioneve dhe qetësimin e situatës. Gjithashtu raportet të cilat patëm rastin ti shohim dhe veprimet të cilat pasuan pas demonstratave, treguan një kërkesë, një veprim i cili duhet të ndërmerret në mënyrë që protestat e ardhshme dhe veprimet e institucioneve përkundër këtyre protestave të jenë të kontrolluara dhe të jenë demokratike dhe sa më paqësore.

Prandaj, përdorimin e dhunës në mënyrën në të cilën patëm rast të shohim me 10 shkurt, e shohim si të papranueshme gjithashtu edhe përdorimin e atyre mjeteve të cilat u përdoren gjatë këtyre protestave i bashkohemi edhe të tjerëve të cilët thanë që janë të pa pranueshme dhe se prej gjithë kësaj do të duhet të del mësimi që në të ardhmen mos të ndodhin më ngjarje të dhimbshme të cilat ndodhën gjatë këtyre demonstratave të shkurtit. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Nouman Baliq

DEPUTETI, RAMADAN KELMENDI- Ju faleminderit, i nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë të pranishëm,

Institucionin e lirive dhe të drejtave politike të njeriut, shtetasit gjegjësisht të qytetarit, e konsideroj një ndër të drejtat më të rëndësishme dhe fundamentale juridike. Si kategori e së drejtës kushtetuese si domosdoshmëri e rrespektueshmërisë nga secili veç e veç, dhe nga shoqëria në tërësi edhe gjatë protestave dhe demonstratave që ndodhën dhe që eventualisht, që nuk dëshiroj po mund të ndodhin. Liritë dhe të drejtat qytetarit janë të garantuara dhe të mbrojtura me ligj, qysh nga kohërat më të lashta e gjer më sot, po në emër të ligjit veprohet shumë herë, në kundërshtim me te.

Është e kuptuar se në shoqëri demokratike mbi ligjin nuk është askush, por në të njëjtën kohë në këto shoqëri njeriu është në qendër të vëmendjes dhe aty ku vritet njeriu, shtrohen shumë pyetje që kurrë nuk marrin përgjigje dhe pikërisht ata që duhet dhënë përgjigje vazhdojnë ti ushtrojnë ato funksione dhe mjerisht në Kosovë është përsëritur decenie me kohë dhe vite të tëra.

Romakët e vjetër patën thënë: „Mos më vrit se nuk më duhet drejtësia pastaj.“ Tek ne ndodhi dhe ndodhën vrasjet, por drejtësia nuk doli kurrë në shesh. Ndodhën ngjarjet e 10 shkurtit 2007, u vranë 2 qytetarë, ministri Fatmir Rexhepi, në shenjë të ndërgjegjes së ushtruarjes së profesionit dhe përgjegjësisë që ndjeu dha dorëheqje. Ishte akti i parë dhe i rrallë fatmirësisht shembull shumë i mirë, por fatkeqësisht aty mbetën njerëz të paktë kuptohet në numër, por të cilët ,po ashtu ,kanë derdhur gjak me punën dhe mos-punën e

tyre, në shumë e shumë protesta paraprake që u cekën këtu më parë dhe vërtet, nuk e kanë vendin aty dhe për këtë nuk u tha asnjë fjalë.

Kultivimin e qëndrimit parimor ndaj ushtrimit të funksionit në pajtueshmëri me përgjegjësitë dhe autorizimet ligjore, në harmoni me parimin e ligjshmërisë ku në çdo formë të tejkalimeve, si dhe përgjegjësi të secilit në pajtueshmëri me shkallën e veprimit apo të mosveprimit adekuat, kjo vlen edhe për ngjarjet e 10 shkurtit 2007, gjegjësisht në protestat e vetëvendosjes. Edhe në Kosovë të gjithë ngjarjet duhet shikuar, analizuar dhe vështruar edhe në prizmin e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave pozitive të aplikueshme në Bashkësinë Evropiane, në të cilën synojmë dhe nga e cila kishte policë këtu.

Mundësitë e shprehjes së pakënaqësive, duke krijuar sigurinë e institucioneve në të cilat askush nuk mund të jetë i pacenueshëm dhe i papërgjegjshëm, po që se tejkalohen autorizimet e tij të caktuara me Kushtetutë dhe ligj në rastin konkret as zyrtarët më të lartë pa dallim por fatkeqësisht ata vazhdojnë të ushtrojnë funksionet. Sepse në të kundërtën, në klasifikimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të gjitha kushtetutat në botë, parimisht garantojnë pacenueshmërinë e jetës së njeriut. Kjo do të thotë se, pjesëmarrja në protestat politike si shprehje e pakënaqësive e cilësdo natyrë qofshin ato, askujt nuk i japë të drejtë, tija mohoj e as tija marrë jetën dhe kjo na ka ndodhë shpejtë dhe mos u përsëritet më. Por funksionet për dikë janë më të rëndësishme se jeta dhe vazhdojnë t'i ushtrojnë u cekën me emra dhe mbiemra, nuk dua ti përsëris.

Me 10 shkurt 2007, ka ndodhur shprehja e lirë dhe e drejtë politike si garancë e aktivitetit politik të njeriut dhe qytetarit si e drejtë aktive duke pasur çdo herë parasysh mos keqpërdorimin dhe mos-tejkalimin. Të drejtat politike, vështirë është për ti ndarë nga liria e të drejtave personale si shprehja e lirë e të menduarit, liria e ndërgjegjes, liria e protestës, liria e bojkotimit, liria e mospajtimit, liria e refuzimit, po edhe liria e kërkimit të informimit të plotë e cila na mungojë relativisht gjatë për protestën në emër të secilës u organizua. Por në raste të tilla, njeriu duhet të jetë i ndërgjegjshëm ndaj të tjerëve, ndaj mjedisit, pronës, shoqërisë, punës, të mirave të përbashkëta dhe ndaj pushtetit.

Në të njëjtën kohë në raste të tejkalimeve ,pushteti mund t'ua kufizojë liritë, lirinë e lëvizjes, mund të bëjë edhe arrestime, por jo edhe vrasje. Pa vendime gjyqësore të bazuara në ligj të miratuar paraprakisht. E në kemi raste konkrete, janë vra njerëzit, duhet gjendur fajtorët në veçanti urdhër-dhënësit, të cilët pa të drejtë ushtruan funksionin të cilin nuk e kishin obligim. Në të cilin edhe në emër të të cilit në funksionet më të larta të policisë si akt moral duhet të japin dorëheqje ashtu siç vepruan individit konkret dhe siç veprohet në shtetet demokratike. Duke dalluar çdo herë përgjegjësinë morale, për të cilën nuk mund të mbahet askush në burg, përgjegjësinë politike që i ka tejkualuar koha e burgut dhe përgjegjësinë penale e cila duhet vërtetuar për çdo kënd. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nauman Baliq, le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi

DEPUTETI, NOUMAN BALIQ – ju faleminderit zoti kryetar!,

Dozvolite mi najprije na samom početku da da selamim sve prisutne u sali i da kažem nešto što će biti u prilog pravednom razmatranju ove situacije. Mada je zaista teško biti pravedan i teško je donjeti pravi sud. Najprije, mislim da rasprava o ovom pitanju je, nažalost, došla suviše kasno. Danas je 40 dan nakon ubistva dvojice mladića, na Kosovu, rahmetlji Mona Baljaja i Arbena Dželjadinija, i zašta je žalosno da Parlament Kosova nije doneo odluku o hitnom zasijedanju, odmah nakon ovog memilog događaja. Takođe, grupa poslanika koja je podnela zahtjev još prije mjesec dana da se ovome rasptavlja nije uvažena, dok je druga greška, koja prema mom shvatanju, potpuno neprihvatljiva. Mi, kao Parlament Kosova, imamo obavezu da raspravljamo o svim važnim pitanjima koja se tiču ove zemlje i njenih građana.

Druga stvar, trebamo pokušatiž staviti stvari na sto i nači prave odgovore. Toga dana, tačnije 10 februara, ono što se desilo, posmatrajući sa vanjske strane, jeste sukob policije i protestanata. Međutim, ovde nije samo riječ o tome da se sukobila policija sa građanima Kosova jer, prosjednici, oni koji protestiraju -demonstranti su, u stvari, građani Kosova. Treba govoriti o mnogo dubljim motivima toga sukoba i posledica toga sukoba. Mislim da djeluje otužno u izveštaju koji smo čuli od gosp. Ministra Kućija, gdje jasno kaže da je policija dobila zadatak da brani imovinu Vlade. Policija je, dakle, dobila obavezu da brani imovinu Vlade, ali nije odbranila i živote ljudi.

Molim vas, obratite pažnju na to. Ovdje se nije, naravno, radilo samo o događaju, o sukobu između policije i građana. Radi se o nečemu što ima mnogo dublje korijene. Radi se o tome, od koga je policija dobila naređenje, posebno onaj deo policije koji nije pod kontrolom kosovskih institucija, posebno međunarodna policija i njihovi pripadnici, te međunarodne strukture koje su prisutne, predstavnici UNMIK-a, predstavnici onih kancelarija koji su ovdje, i koje su, očigledno, bile spremile snažni i odlučujući udarac, jendu lekciju koju je trebalo dati demonstrantima i pokazati silu i dati im doznanja, staviti im do znanja, da oni moraju shvatiti da ovdje trebaju biti, trebaju činiti, i da se zna ko je gazda i da tarebaju znati šta trebaju činiti ovdje na Kosovu.

To su stvari o kojima moramo znati i koje trebamo imati u vidu i o kojima trebamo voditi računa. U izveštaju takođe, kako stoji, govori se o dva nestala života, o dvije osobe koje su izgubile život. Čuli smo i od prestavnika parlamentarnih grupa, da se ne radi o ljudima koji su izgubili život. Radi se o ubistvo dvojice ljudi, dva čovjeka su ubijena. U izveštaju nedostaje najvažniji dio koji se tiče sudskog medicinskog viještačenja. Pošto sam ja ljekar, a oni koji se u praksi, pravnoj praksi bave tim pitanjima, oni znaju da postoje tri vrste oblika smrti čovjeka; to je zades, smoubistvo i ubistvo. Mi nemamo izvještaj kako su ubijena, na koji su način ubijena ta dva mladića. Govori se o tome da je pucano i da su rumunjske i poljske jedinice pucale.

U ime naroda Kosova, familija tih ljudi, ja, kao čovjek, kao vjernik, kao musliman, tražim odgovor koji je ubio te ljude, koji je pucao na njih? To je ono što nas zanima. Ako hoćemo da pričamo o zakonu, o državi, više puta je ovdje govoreno o zakonu, o sili, o upotrebi sili, itd. Da vam kažem da sam jako osijetljiv na priči o sili i o nezakonitoj upotrebi sile, i da sam jedan od onih koje baš u prošlosti preživeo upotrebu sile, upravo od strane onih koji predstavljaju zakon.

Protiv sam bilo koji upotrebe sile na bilo čiju štetu, ali sam posebno osetljiv, koji mnogi od vas, ako se u ime zakona upotrebljava sila, posebno ona sila nakon čije je posledica ubijanje ljudi. Dakle, moramo neke stvari da razjasnimo. I ovaj izveštaj, prema mome shvatanju, ne može biti prihvatljiv sve dok u njemu nema odgovora na ova dva pitanja koja se tiču života ovih ljudi. Naravno da ću još, na kraju, reći jednu kratku poruku koja se, takođe, tiče i onoga što stoji u izveštaju, a što je dobra stvar. U izveštaju, takođe, stoji da treba razgovarati. Sa ove govornice, upravo sa skupštinske govornice 9. februara, jedan dan prije protesta ja sam pozvao Grupu initeta, koju smatram velikim djelom odgovornim za ovo što se desilo, pored predstavnika međunarodnih institucija. Da se razumijemo, predstavnici Grupe uniteta institucije Kosova, jedan deo međunarodnih predstavnika su velikim delom odgovorni za ovo što se desilo.

Dakle, tada sam rekao da se mora razgovarati sa ljudima, da se treba razgovarati sa svim ljudima i sa veteranima rata, i sa ljudima koji su se borili, i sa Vetvendosjom i sa svima njima. Ni dan danas nema spomena oko toga da se razgovara sa njima, uprkos onome što stoji u izveštaju. Oprostite molim vas, to je veoma licemjerno. Ako ministar u izveštaju kaže treba razgovarati, ja nisam čuo da je iko od institucija Kosova razgovarao sa vođama demonstranata, niti sa gospodinom Kurtijem.

Gosp. Kurti je u zatvoru. Zašto je gospodin Kurti u zatvoru, jeli i zašto je samo on u zatvoru. Recimo da je on kriv, ali zašto je samo gospodin Kurti u zatvoru, ako je samo on kriv, onda je problem najmanje težak. Ali je problem što postoji jedan čitav lanac odgovornih ljudi koji su odgovorni za sve ovo, i nije dovoljno što je gospodin komesar Krtis dao tu ostavku, nije apsolutno dovoljno. Treba govoriti o odgovornosti a ne samo dati ostavku. I naravno mislimo ovde kada je već reč o ovome da gosp. Fatmir Redžepi, uopšte nije trebao dati ostavku. Postoje drugi ljudi koji su odgovorni i mi trebamo biti uporni u svemu tome sve dok se ne nađe odgovor ko je stvarno, i ko je odgovoran. Postoji odgovornost i postoji krivica. Prema tome, pouka za sve nas, za ono što se može desiti u buduće. Vetvendosja je samo izrazila onaj osjećaj nezadovoljstva, a koji ima jedan značajan dio naroda Kosova.

U budućnosti će biti sve više ljudi, sve vjeći deo naroda Kosova, koji će biti nezadovoljan. To je naša obaveza gospodo poslanici, da nađemo odgovor kako da postupamo prema tom djelu nezadovoljnog naroda. Vetvendosja možda je sasvim slučajno izrazila to što taj dio naroda misli. To je mogao biti gospodin Kurti, mogo je biti i bilo tko. Ali, mi moramo razgovarati sa tim ljudima, i protestujem protiv toga što je gosp. Kurti u zatvoru, i zahtjevam da se pusti iz zatavora. Ne za to da bi ovde držao bilo kakve govore, nego govorim kao čovjek, kao vjernik i kao musliman i ne možete mi to osporiti. U tom smislu ja pozivam, na kraju na razgovora, na dogovor, na onaj zaključak u Raportu- Izveštaju koji poziva na dogovaranje, na dijalog. To do sada nije postojalo. Hvala vam veliko!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, le të përgatitet deputeti Mazllum Kumnova.

DEPUTETI, XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit zoti kryetar. Pas teje do ta falënderoja ministrin Blerim Kuqi, i cili sipas meje nuk ka pa obligim të vijë dhe të raportojë, sepse në këtë Kuvend kryeministri i tij as nuk e ka prezantuar si ministër të Qeverisë e lere më të jetë votuar për të në Kuvend, të paktën me një votë formale. Prandaj është vullneti i mirë i tij që ka ardhur e falënderoj për atë .Ky është një shembull se si punojnë institucionet tona dhe një fakt që këto institucionet duhet të pësojnë një reformim të thellë, të gjedhet të emërohet dikush ministër dhe nuk prezantohet para Kuvendi nga kryeministri, nuk votohet të paktën formalisht, kjo mund t'i bëjë vaki veç Kosovës ,si shumë budallaki të tjera që i kanë bërë vaki edhe do të bëjnë. Ju faleminderit,

Tjetër, zotërinj deputetë, janë bërë shumë fjalë, shumë shkrime, shumë komente, shumë debate për 10 shkurtin. I vetmi Kuvendi është që më së voni prej të gjithëve po debatoni, e do të duhej të debatonte i pari. Shumëkush ka paragjykuar pakënaqësinë, protestën, të drejtën, leje pa leje, etj. për mua i rëndësishëm është fakti që janë vrarë dy qytetarë dhe pyetja kush ka të drejtë të vendosë për vrasjen e qytetarëve të Kosovës. Në dorën e kujt është jeta e qytetsrëve të Kosovës? Cili polic, cila polici, cila politikë? Në fund të fundit këtu policia më së paku ka faj. Ajo që më shqetëson është përcaktimi i politikës, gjuha që politika ka përdorur dhe politikanët tanë, për pakënaqësi të qytetarëve, qofshin ato të shoqatave të ndryshme, qofshin ato të lëvizjes, qofshin ato të organizatave të ndryshme politike.

Dhe shkakut i pakënaqësisë së qytetarëve për mua qëndron tek uzurpimi dhe monopolizimi ose koncentrimi i së drejtës për të vendosur për Kosovën në një grup njerëzish dhe përjashtimi nga, jo vetëm nga vendimmarrja, por edhe na konsultimi edhe nga shfaqja e mendimit të gjithë shoqërisë tjetër civile, edhe të gjitha shoqatave joqeveritare, organizatave e tjera politike, etj.

Prandaj në këtë pikë, në këtë aspekt mendoj që, politika jonë dhe politikanët tanë, duhet të mësojnë shumë nga demokracia qytetare, nga demokracia politike e vendeve të zhvilluara demokratike. Politikanët tanë duhet ta kuptojnë një herë e përgjithmonë se në shoqëritë demokratike, në shoqëritë me demokraci qytetare, nuk janë ata të vetmit që vrapojnë e kthjellin, nuk janë ata të vetmit që vendosin për jetën e dikujt ose pakënaqësinë e dikujt. Për shijen e popullit të tyre çka u pëlqen e çka nuk u pëlqen. Në gjithë botën demokratike, në të gjitha shoqëritë demokratike ekziston liria e mendimit, e veprimit edhe ndryshe, e paraqitjeve edhe ndryshe, e sjelljeve edhe ndryshe e alternativave të ndryshme, nuk ka alternativë absolute as për Kosovën as për botën as për kur një vend tjetër.

Është një alternativë që e ka ofrua një grup politik, i përfaqësuar nga ajo ose kjo parti politike, por ka të drejtë edhe, ose kanë të drejtë edhe grupime të ndryshme qytetare, politike, të kenë alternativat e tyre, edhe për Kosovën, edhe për statusin e sajë, edhe për çështje ekonomike, edhe për çështje sociale, shëndetësore, arsimore, për çdo gjë dhe askush këtë të drejtë nuk mund të ua mohoj. Askush nuk mund ti përjashtoj nga kjo e drejtë qytetarët e Kosovës.

Më shqetëson shumë edhe fakti dhe roli i medias, në këtë ngjarje dhe pas këtyre ngjarjeve. Shumica e medias së shkruara dhe elektronike në Kosovë, fatkeqësisht mori anën e dhunës policore. Mori anën e politikave të dhunshme, politikave të egra, politikave paragjyquese për vetë lëvizjet dhe politikën, qëndrimet e qytetarëve të tyre. Prandaj këto media që drejtohen nga ish- nomenklatura komuniste ose bijtë e tyre, vërtet duhet të shikohen se kujt i shërbejnë dhe a u bie tamam ky kallëpi i të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejtave dhe lirive të qytetarëve politike demokratike.

Në këtë kontekst unë mendoj dhe propozoj, një ligj për lustrifikimin, ligj të cilin tash vonë e ka miratuar Polonia. Një ligj i tillë i atij është i domosdoshëm në shoqëritë post-totalitare dhe veçmas në shoqëritë që dalin nga pushtimi. Ne burra, deputet e gra, duhet ta dimë kush po na i bënë politikën në Kosovë. Kush kanë qenë këta njerëz, kush janë këta njerëz, kush është ky deputet Xhevat Bislimi që foli sot këtu në Kuvend të Kosovës?. A thua ka qenë dikund me ndonjë far skaj apo me ndonjë far mjedisi të politikave të pushtuesit? Është eliminuar nga kandidatura një ipeshkv i Polonisë, një prift i lartë i Polonisë vetëm pse ka qenë bashkëpunëtor i shërbimeve sekrete të vendit tij. Në fund të fundit, por që ishte një regjim komunist, kurse te ne, të tillë ka sa të duash në të gjitha institucionet, në media në arsim, kudo dhe a mund të ecë Kosova me këta njerëz nëpër këmbë? Absolutisht. Këtu është problemi, nuk është problemi te policia e Kosovës, as nuk ka për të ecë.

Unë mendoj që, Kosova momentalisht është në fazën e lindjes së demokracisë, sepse për derisa edhe pas 8. vitesh qytetari i Kosovës, ndalohet jo vetëm qytetari por edhe zyrtarët e Kosovës, ndalohen, kontrollohen, bastisen, nga ushtarët e KFOR-it, do të thotë që fjala është për, në Kosovë për një demokraci nëse mund ta quajë kështu ushtarake dhe shpresoj që së shpejti do të kalojmë në një demokraci qytetare, por druaj shumë që me këto politika, me këto mentalitete të vjetruara totalitariste, moniste vështirë është me kalua në demokraci qytetare. Është në dorën e të gjithë forcave demokratike që vërtet ta rishikojnë gjithë këtë politikë, gjithë këtë mentalitet dhe gjithë punën e këtyre institucioneve.

Ne shembullin më të mirë e kemi pasur edhe në Komisionin tonë. Kryetari i Komisionit të gjithë e kemi parë, se si ka dalë në media dhe çfarë qëndrimi ka mbajtur karrshi protestave paqësore në Kosovë dhe si i ka paragjykuar ato. Kush ka të drejtë të thotë se dikush paska dashur me sulmua institucionin, prandaj po e vras. Ku të çon kjo logjikë, po të ndodhte kështu në Danimarkë, ku janë shpërthyer dhjetëra barrikada do të vriteshin kush e di sa turma të njerëzve, janë djegë qindra dyqane, është sulmua policia me koktejmologov, nuk kemi parë që është plagosur dikush, përkundrazi ka pasur nga policia të plagosur.

Cili qytetar është vra në Francë, kur u dogj Franca fund e krye, dhe dikush arsyeton se qenkan hequr barrikatadat nga rruga dhe u dashtë të vriten qytetarët e Kosovës. Ku është dinjiteti i kësaj politike dhe i këtyre politikanëve që kanë marrë besimin e popullit të Kosovës, kur një polic i Rumanisë dhe një polici rumune, polake që kanë dalë nga sistemet totalitare, nga sistemet që me ndihmim ndryshe e kanë vrarë me pushkë e me plumb, vjen dhe të vret mu në mes të Prishtinës qytetarin tonë, bashkëqytetarin tonë, bashkëkombësin tonë, dhe politikanët e nderuar mos me ju thënë diçka tjetër, po ju them

„të nderuar“, u buzëqeshin, i përshëndesin, u duartrokasin këtyre vrasjeve dhe këtyre policëve e policive, në vend se të shpallen të pa dëshiruara në Kosovë.

Cili polic u përgjigj deri sot, gjema një rast, që kanë vrarë 19 protestues të vitit 2004. edhe sot ndiqen njerëzit që kanë bërë ndonjë dëm material, kurse aanjëri nuk është përgjigjur për vrasjen e njerëzve, 19 veta janë vrarë, a 20,! Cili polic ne duhet ta dimë cili polic e vrau Arbenin, cili polic e vrau qytetarin tonë? Në qoftë se kjo politikë, këto institucione presin që t'i ruajë policia rumune dhe polake, ndoshta është çështje edhe e traditës se këtë Kuvend edhe këto institucione i ka ruajtur gjithmonë policia e Serbisë. Unë vërtet kisha me thënë mjer ai deputet, mjer ai politikan, mjera ajo politikë që kërkon ta mbrojë policia rumune nga qytetari i vet, nga populli i vet. Edhe jazëk i qoftë çdo politikani që udhëhiqet në politikë me këtë logjikë. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, ka replikë zoti Naim Maloku.

DEPUTETI, NAIM MALOKU - Ju faleminderit zoti kryetar, unë desha vetëm të replikoj me zotin Xhevat Bislimi, për do shtrembërime që po i bën, ndoshta të qëllimshme këtu, por e kam thënë dhe po e them se protestat, ajo çka është e ditur, kanë eskaluar në dhunë. Pa dashje a me dashje nuk është kjo me rëndësi, por që kam thënë që është dashur të vriten njerëzit, këtë nuk e kam thënë kurrë dhe mos ma imputoni. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, më falni zoti Kumnova, urdhëroni zoti Bislimi

DEPUTETI, XHEVAT BISLIMI- Zoti Maloku, unë nuk thashë se ke proklamuar ose ke propaganduar vrasjen, por logjika me të cilën i shpjegoni ngjarjet që janë aty, jo veç jotja, nuk je i vetëm fatkeqësisht, se të ishte i vetëm kallaj ia kishim bërë edhe konkluzionet që i ke nxjerrë këtu, të Komisionit, të çojnë aty. Edhe këtu ke paragjykuar se demonstruesit paskan dashur të vandalizojnë t'i demolojnë institucionet e shenjta të Olimpikut dhe të Zeusit,

KRYETARI, KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti Maloku,

DEPUTETI, NAIM MALOKU – Nuk kam koment në këtë do të thotë kjo është një paragjykim juaji zoti deputet dhe mbani për vete atë.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Mazllum Kumnova le të përgatitet deputeti Sokol Bashota.

DEPUTETI, MAZLLUM KUMNOVA- Zoti kryetar, ministra, Unë kam pritur të kemi në dorë një raport të detajuar për 10 shkurtin sepse, u bënë mbi 40 ditë nga kjo ngjarje. Ky informacion i mangët dhe i kufizuar aq sa ka qenë kompetenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe duhet të merret në funksion te interpretimit të raportit të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Me sa e kam kuptuar me këto informacione vështirë mund të arrijmë të kemi një vlerësim objektiv, ose të krijojmë një pamje të qartë të 10 shkurtit, por më tepër e hapim problemin e krijuar, për të arritur te disa konstatime të mija.

E para, mendimi im është se nuk është vështruar drejt situata e krijuar me 10 shkurt, sidomos asaj të sigurisë nga ana e Shtabit Qendror të Policisë, nuk janë ndërmarrë masat parandaluese për zhvillimin normal të protestës, ka munguar kontakti dhe negocijimi me organizatorët e protestës „Vetëvendosje“ kjo u tregua më së miri me 3 mars kur bashkëvepruan organizatorët e protestës dhe policia që rezultoi me një protestë të qetë.

E dyta kemi hyrë në një fazë të procesit politik mjaft të ndërlikuar, e mbarsur në situata të ndryshme që kërkon një përgjegjësi më të shtuar, sidomos të UNMIK-ut dhe të mekanizmave të tij të sigurimit, por edhe kjo përgjegjësi u takon edhe institucioneve tona organizatave, joqeveritare dhe qytetarëve në përgjithësi.

E treta, para kësaj ngjarje kemi menduar se SHPK-ja ka kapacitetin në fushën e kontrollit dhe të menaxhimit të situatave të tilla, por nuk doli kështu. Atëherë, cilat investime për të cilat është folur shumë nga mekanizmat e UNMIK-ut, paskan qenë këto për SHPK-në, ose pse nuk u shfrytëzua atë ditë për t'u përballur me demonstruesit, ngjau e kundërta, ndërhyri policia ndërkombëtare dhe këtë me mjete të palejueshme, me projektila plastik të dënueshëm me konventa ndërkombëtare dhe si pasojë me dhjetëra të plagosur e të lënduar dhe dy prej tyre e humbën jetën. Çështja qëndron se duhet dhënë përgjigje, a ka qenë një mosbesim ndaj aftësive të SHPK-së, ose situata është menaxhua keq nga Shtabi Qendror i Policisë, në krye me komisarin ndërkombëtar që nuk është në varësi të Qeverisë së Kosovës dhe i përgjigjet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Duhet kërkuar adresën e urdhrat që është dhënë për të vrarë njerëz. Një e di dhe jam i sigurt se kjo adresë nuk janë institucionet tona, por ndërkombëtare. Çdo arsytim se duhet mbrojtur prona, që të vrahën qytetarët ende pa u rrezikuar prona, vetëm pse paska vlerësuar njëfarë inteligjence këtë, është absurde. Mandej ky është krim, jeta e njeriut është mbi të gjitha.

E katërta, unë mendoj se protestat dhe revoltat e qytetarëve të pakënaqur, të ngritur, rreth „Vetëvendosjes“ nuk është vetëm në kundërshtim ndaj pakos së Ahtisarit, por mllef ndaj shtyrjes së zgjidhjes përfundimtare të statusit politik të Kosovës- shtet i pavarur dhe kjo revoltë nuk është vetëm e grupeve, ose siç thuhet në komentet e policisë 2000 deri në 3000 qytetarë, por e tërë popullatës së Kosovës shumicë dhe e atyre që kanë protestuar dhe do të protestojnë në rrugë, por edhe e atyre që janë në shtëpi, në vendin e punës, në shkollë etj. Nuk është e rastësishme kërkesa e këtyre ditëve për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik nga ata që Kosovën e kanë në hartën e **kolonive të tëra**. Po ashtu për nga vështrimi politik, si institucion duhet të jemi të kujdesshëm në vlerësime, sepse disa kualifikime që janë bërë për protestat në përgjithësi dhe organizatorit në veçanti janë paushalle dhe të papjekura. Ne duhet të mësohemi me demokraci, mund të ndodhë që Albin Kurti, në mandatin tjetër të jetë edhe kryetar i Parlamentit dhe disa demonstrues deputetë dhe qeveritarë, pse jo kur shokët e Albin Kurtit janë edhe ministra sot.

Është proces demokratik në mandatin tjetër disa prej nesh mund të ndodhemi në rrugë për të protestuar edhe kjo mund të ndodhë, pse jo, edhe kjo është rrugë demokratike dhe në emër të kësaj rruge demokratike kërkoj lirin e Albin Kurtit. Prandaj ,duhet të jemi të kujdesshëm kur i klasifikojmë dhe vlerësojmë, kjo nuk do të ndodhë se edhe organizatorët e protestave dhe qytetarët të mos ndjejnë përgjegjësinë aktuale të procesit politik që po ndodhë në Kosovë dhe për Kosovën.

Në këtë kontest, mbajtja në burg e nxënësit Besnik Neziri, pse ka marrë pjesë në protesta, duket se nuk përkon as me ligje as me konventa për mbrojtjen e fëmijëve. E kemi një peticion, i ka arritur këtij Kuvendi, i nënshkruar nga mijëra nxënës të shkollave të mesme dhe nuk kemi reaguuar. Dhe mirë kanë bërë që kanë reaguuar shokët e tij. Pa dyshim ,kjo ngjarje edhe pse tragjike sollli një qeverisjen tonë aktin moral ,siç është rasti i dorëheqjes së ministrit të Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepit. Në fund është e domosdoshme që, hetimet të përfundojnë sa më parë dhe të zbardhet e vërteta për urdhrin e dhënë për të vrarë njerëz dhe të dihet adresa e saktë. Nëse nuk zbardhet atëherë këto vrasje janë me qëllime politike dhe skenarë të caktuar.

Po ashtu është vërejtur se Kosovës i mungon një infrastrukturë ligjore për të cilën folën edhe të tjerët, për raste të tilla, si e drejta për organizimin e tubimeve protestuese, Ligji për polici, Ligji për ballafaqim me trazira të mëdha, Ligji për përdorimin e armëve nga zyrtarët policorë dhe aktet e tjera nënligjore për të cilat duhet obliguar Qeverinë t'i sjellë në këtë Kuvend për miratim dhe këtë herë ngritët çështja e bartjes së përgjegjësi në institucionet tona, proces që po ecë shumë ngadalë dhe me pasoja. Ne kemi krijuar ministri e cila nuk ka kompetenca as për një raport të mirëfilltë, për ngjarje të tilla, ose për të zbardhur së paku të vërtetën me 10 shkurt 2007. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Sokol Bashota, le të përgatitet deputetja Safete Hadërgjonaj.

DEPUTETI, SOKOL BASHOTA- Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar deputetë! Isha para dilemes që të diskutoj sot në këtë Kuvend apo jo edhe atëherë kur e kam nënshkruar kërkesën për këtë rend dite, kemi qenë në dilemë se çfarë të bëjmë, për të vetmen arsye se sot, por edhe atëherë ishte shumë vonë dhe sot ky Parlament mblidhet pas një muaj e gjysmë, kur ka ndodhur ajo tragjedi. Kjo i bie sikur të flasim pas të korrurave. Prandaj, është shumë vonë dhe mendoj se këtij Kuvendi duhet t'i shërbejë ky gabim dhe të mos përsëritet më se në rastet e tilla mendoj se Kuvendi duhet të mblidhet urgjentisht.

Më herët kryetari i Komisionit për Siguri shpjegoi në rezymenë e tij se disa deputetë të Partisë Demokratike kanë lëshuar mbledhjen, më lejoni t' jua sqaroj se ne nuk e kemi lëshuar mbledhjen si deputetë, si individë, por në emër të Partisë Demokratike, me të vetmin qëllim është ky qëllim që pas 5 ditëve Komisioni për Siguri mblidhet dhe atë jo në mbledhje të jashtëzakonshme, por mblidhet në një mbledhje të radhës. Prandaj qëndrimi ynë aty na është dukur i pa koment.

Zoti ministër e tha se, dy veta humbën jetën. Zotit ministër dhe disa të tjerëve ua sqaroi se ata nuk e humbën jetën, por atyre ua murrën jetën. Dhe ngushëllimet tuaja nuk e di se sa i ngushëllojnë familjarët e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETJA, SAFETE HADËRGJONAJ - I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë! Në raport thuhet se Inspektorati Policor është angazhuar në dy rrafshë, të hetojë procedurat dhe veprimet e përgjithshme të Shërbimit Policor të Kosovës gjatë kësaj proteste dhe të mbikëqyrë inspektimet e policisë ndërkombëtare për procedurat dhe veprimet gjatë asaj dite. Mendoj se, bazuar në këtë raport në asnjërin nga këto dy rrafshë nuk është dhënë informata e duhur. Sipas këtij raporti vërejtja kryesore e policëve të SHPK-së ishte në mosveprimin, hezitimin dhe sjelljen e pavendosur në protestë, të cilën Inspektorati Policor i Kosovës e arsyeton me mungesën e përvojës.

Atëherë shtrohet pyetja: Pse policët e SHPK-së të jenë në këtë gjendje, kur janë bërë investime të mëdha për ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve për të cilat janë dhënë edhe miliona euro nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Raporti thotë se **ka** pasur konfuzion dhe mungesë të dhënies së udhëzimeve të qarta nga mbikëqyrësit e tyre. Shtrohet pyetja pse ka ndodhur kjo? Në raport thuhet se intelijenca ka theksuar se grupi „Vetëvendosje“ ka pasur për qëllim dëmtimin e pronës dhe thyerjen e barrikadës së policisë **sikur të ishte e mundur**. Synimi i policisë ka qenë parandalimi i shkatërrimit masiv të pronës qeveritare dhe lëndimit të oficerëve, të demonstruesve.

Atëherë, shtrohet pyetja: Pse intervenoi policia, meqë supozimet e inteligjencës nuk kanë ndodhur?

Të nderuar deputetë, Kodi Evropian i Etikës Policore ,që citohet edhe në këtë raport thotë: Policia mund të përdorë forcën vetëm kur është absolutisht e nevojshme dhe vetëm në atë masë që kërkohet për të arritur qëllimin e ligjshëm.

Me 10 shkurt policia ndërkombëtare e mandatar të menaxhojë me situatën në aspektin operativ dhe atë politik, ka shkelur parimin themelor të policisë që respekton demokracinë duke përdorë forcën e tepruar, e si pasojë humbën jetë njerëzish dhe u lënduan 80 protestues, pa kurrfarë arsye ngase grupi i protestuesve të datës 10 shkurt nuk ka bërë kurrfarë dëmtim të pronës as të pasurisë, nuk ka lënduar asnjë polic vendor, as ndërkombëtar. Përpos që e ka shfrytëzuar të drejtën e shprehjes së pakënaqësisë të cilën ata e kanë pasur.

Të nderuar deputetë. Një reagim i tillë të lë përshtypjen se sjellja aq e ashpër e policisë ndërkombëtare nuk ishte krejt si pasojë e protestuesve dhe protestave të cilat ata bënin, por ishte veprim i urdhëruar nga dikush për të dëmtuar dhe për të frikësuar të gjitha ata që i lejojnë vetëvetes të mendojnë apo që tentojnë të mendojnë ndryshe nga ata që janë në pushtet. Përdorimi i plumbave vdekjeprurës nga pushkët me projektile plastik, që janë të ndaluara me konventa ndërkombëtare e që sipas raportit me pushkë të tilla kanë qenë të

pajisur vetëm njësitet e Rumanisë dhe të Polonisë, nuk duket të kishte qenë i panjohur për ata që dhanë urdhër që të qëllohet mbi pjesëmarrësit e protestës së datës 10 shkurt.

Ata kanë qenë të vetëdijshëm se urdhërat e tilla kanë të bëjnë me jetën e njerëzve, andaj policia është dashur të jetë shumë më e kujdesshme dhe shumë më e përgjegjshme. Fundja, misioni i policisë ndërkombëtare i adresohet, prandaj edhe sjellja e tyre është dashur të korendojë me normat ndërkombëtare dhe me respektimin e ligjeve të cilat janë në Kosovë. Është irituese dhe tepër shqetësuese ku nga papërgjegjshmëria humbin jetë njerëzish të pafajshëm. E në anën tjetër nga institucionet e zgjedhura nga vota legjitime e qytetarëve dalin fjalë fyese për protestuesit apo ata që janë në krye nuk marrin përgjegjësinë që u takon.

Qytetarët e Kosovës janë të stërlodhur nga fjalët fyese, të bëra nga pushtuesi, por edhe nga argatët tyre shqiptarë, që nuk i kanë merituar, ata nuk i kanë merituar fjalët e tilla dhe nuk i meritojnë as sot. Deklaratat e dalura nga Kryeministria menjëherë pas demonstratës paqësore, nga qytetarët, por të përgjakshme nga veprimet e policisë, se tek e fundit policia atë punë e ka, apo deklarimi i kryetarit se nuk ndihem përgjegjës për veprimet që i bëjnë të tjerët, apo deklarimet e zyrtarëve të tjerë të lartë institucional më vonë se demonstratat qenkan dorë e zgjatur e Serbisë, nuk duanë koment, por është dëshmia më e mirë që tregon se sa të brishta janë institucionet tona dhe sa të papërgjegjshëm janë udhëheqësit institucionalë.

Koalicioni qeverisës duhet të jetë i vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë marrë nga vota e qytetarëve. Ata kanë përgjegjësinë për shqetësimin e qytetarëve për statusin e Kosovës, për gjendjen e vështirë ekonomike, për varfërinë, për numrin në rritje të të papunëve, të rinjve të papunë, për plaçkitjen legale dhe ilegale që po i bëhet pasurisë së Kosovës, për abuzimin e mjeteve të buxhetit, për korrupsionin, për personalizimin e institucionit që rezulton me dobësimin e institucioneve. Për mua është shqetësuese se edhe përkundër disa dorëheqjeve nuk është adresuar përgjegjësia ndaj atyre që kanë përdorur plumbat, që shkaktuan vdekjen e dy të rinjve dhe lënduan dhjetëra të tjerë. Për mua është shqetësuese burgosja e dhjetëra të tjerëve nën paragjykimin se çfarë do të kishte mundur të ndodhte nëse policia nuk do të ndërhynte me atë forcë aq brutale.

Apeloj që në vend se të bëhet dosje politike për qytetarët e pafajshëm, të orientohen me tërë forcën profesionale e të zbulohen vrasjet kriminale në Kosovë, të zbardhet rasti i dhunës së tepruar në demonstratën e 10 shkurtit dhe të mos na përsëritet ajo thënia e vjetër e cila është bërë traditë në Kosovë: Hetimet vazhdojnë! Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

DEPUTETI, FETAH BERISHA – I nderuari zoti kryetar, i nderuari zoti ministër, të nderuar kolegë deputetë!

Ministria e Punëve të Brendshme ka paraqitur informatën për ngjarjet e 10 shkurtit 2007. Kësaj i është bashkangjitur edhe informata e SHPK-së dhe përmbledhja e raportit të

Inspektoriati Policor të Kosovës, për këto ngjarje të cilën tani e kemi para vetes. Rrjedhja e protestës së 10 shkurtit është përmbledhur në dhjetë faqe të këtij materiali- informatës. Këtu është thënë se ngjarjet e 10 shkurtit e kanë rënduar gjendjen e sigurisë edhe ashtu të brishtë në Kosovë.

Pastaj është thënë se në informatë me bindje, është bindje e të gjithëve se veprimet e pamatura destabilizojnë gjendjen e sigurisë në Kosovë. Ngjarjet dhe veprimet më shumë janë përshkruar se sa janë analizuar. Në informatë thuhet se me rastin e publikimit të pakos nga presidenti Ahtisari, kanë pasur edhe indikacione institucionet tona për trazira nga grupet e vogla të veçanta, të pakënaqura dhe për këtë është bërë planifikimi i bashkëpunimit të policisë së UNMIK-ut, SHPK-së, dhe KFOR-it.

Të gjithë pajtohen tani se SHPK-ja ka mungesë pajisjesh, gjë që duhet rritur buxheti për SHPK-në, duhet trajnuar vazhdimisht SHPK-në dhe se ka mungesë ligjore për përdorimin e forcës vetëm atëherë në momentet tejet e nevojshme. Edhe lëndimet e lehta, të rënda, edhe dy vrasje që kanë ndodhur janë të dhembshme për Kosovën. Ky Kuvend ka aprovuar në parim Projektligjin për grevat, por jo edhe Ligjin për tubimin.

Aty thuhet qartë se kush ka të drejtë të protestojë qetë e pa dhunë dhe të shprehë mendimet e veta lirshëm për problemet që mendojnë dhe nuk dënohet, po asnjëherë nga mendja nuk duhet hequr as fjalën tolerancë, as marrëveshje, as paqe, por jo dhunë gjithnjë. Afërsisht një shekull shqiptarët e Kosovës kanë bërë tubime protestuese ,demonstrata, greva urie dhe edhe tetë kat nën dhe i kujtojmë grevat e Trepçës edhe në burgje kanë bërë greva, por vuanin dënimet edhe para OKB-së, edhe në metropolet më të mëdha të SHBA-ve, edhe në Australinë e largët.

Kërkesat ishin atëherë reale, ata vazhdimisht kërkonin liri, demokraci dhe pavarësi. Të gjitha këto brenda Kosovës u shuan me dhunë, me burgje, me vrasje, me ekzil të dhunshëm politik. Përafërsisht 100 vjet kemi kërkuar të jemi të lirë, të krijojmë e të hyjmë në institucione. Institucionet ishin të okupatorit, ne ishim jashtë tyre, tani jemi në institucione, tani veprojmë institucionalisht dhe institucionet le të frymojnë lirshëm dhe le të sundojnë mbi to ligji dhe parimet demokratike në shtetin e Kosovës. Për herë të parë në historinë tonë, u vendos protektorati i Kosovës, pasi u dëbua regjimi okupues shekullor i Serbisë mbi Kosovën. Në Kosovë u bënë zgjedhjet e lira lokale e nacionale dy herë, të sponzoruara dhe të udhëhequra nga ndërkombëtarët.

Kosova për herë të parë në historinë e vetë bëri vetë me ndihmën e ndërkombëtarëve institucionet e veta demokratike. Tani ka president, ka Qeveri, Parlament, ministri, shqiptarët nga rruga hynë në institucionet e veta. Shqiptarët e Kosovës për herë të parë në historinë e vetë, me ekspertë të arsimuar, me përfaqësuesit e institucioneve të veta, me përfaqësuesit e Kosovës, me Grupin Negociator ata tani janë ulur në sofrën ndërkombëtare për herë të parë në histori ballë për ballë me ish -okupatorin e Kosovës.

Të nderuar deputetë, nuk duhet të kihen ,po ashtu ,iluzione e të krahasohen protestat sot me demonstratat e 68-tës, 81-shit, 89-tës, 90-tës, 97-tës, etj. me këto u nisën proceset drejtë lirisë së Kosovës. Ato u organizuan dhe i treguan okupatorit serb se duhet

shporrur nga trojet tona. Ato atëherë u organizuan nga rinia studentore e mrekullueshme e kohës në Kosovë, për të arritur deri në ditët e sotme. Atëherë çdo gjë ishte e huaj, ishte okupuese për ne, prandaj kishte kuptim edhe gjuajtja me gurë, edhe përlëshja, kishin kuptim edhe burgjet politike, sepse e kishim përkrahjen e tërë popullatës sonë.

E sot është ndryshe, çdo gjë është jona, nuk është e okupatorit. Edhe presidenca edhe Qeveria edhe Parlamenti edhe ministria, edhe policia, edhe ushtria edhe pronat janë tonat, në to punojnë djemtë, vëllezërit tonë. Në to punojnë bijtë e bijat tona më të mirat, pra sot nuk duhet të ketë të burgosur politikë. Koha e tyre tani ka shkuar, nuk duhet të ketë as ekzil të dhunshëm politik, ashtu si nuk duhet të dhunohet as prona jonë, ashtu si nuk duhet të përdoret dhuna, sepse ka rrugë të tjera sot. Kosova sot është në rrugë të mbarë, rruga që e bënë Kosova, Kosovën e bënë shtet të pavarur.

Gjithashtu, sot duhet vlerësuar mirë e mirë, se i dëmtojmë proceset e pavarësisë së Kosovës me veprime të tilla. Ma thotë mendja se Kosova ka nevojë më shumë se kurrë për qetësi, askush nuk duhet të ketë tagër e mbi tagër për Kosovën, Kosova është dhembja dhe dashuria e të gjithëve. Ajo është dhembja dhe dashuria jonë. Prandaj, të gjithë e çdo gjë për pavarësinë e Kosovës, për shtetin ligjor e demokratik të Kosovës. Të kemi kujdes se Kosova po kalon nëpër proceset tejet historike. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, le të përgatitet deputetja Selvije Halimi.

DEPUTETI, BERAT LUZHA – Të nderuar kolegë deputetë, as Ministria, as Inspektorati i Policisë dhe as Komisioni Parlamentar nuk kanë sjellë një raport të vërtetë për ngjarjet e 10 shkurtit. Në vend të një raporti kanë sjellë një informatë shumë të ngjashme njëra me tjetrën, të shkurtër në të cilën ka përshkrim të ngjarjes dhe jo konkludime, jo në bazë të hetimeve. Sigurisht deputetëve u intereson rezultati i hetimeve deri ku kanë arritur ato, përndryshe përshkrim të ngjarjeve nuk na duhen për shkak se ato i kemi parë dhe i kemi lexuar në gazeta dhe në televizion.

Në këto ngjarje secili ka parë dhe ka dëgjuar për dhunën, dhunë skajshmërisht e tepruar që ka rezultuar edhe me vrasje, me plagosje, me lëndime, me gaz të tepruar. Dhuna dhe vrasjet janë bërë mbi njerëzit duarthatë, të cilët protestonin për shkak se ishin të shqetësuar për fatin e Kosovës. Dhunë të tepruar ndaj demonstruesve ka pasur edhe herëve të tjera, nuk është hera e parë. Tash na duhet një përgjigje nga organet kompetente. Kush i vrau demonstruesit, kush qëlloi me plumba të kamuflua?. Në fakt ata ishin plumba të vërtetë. Por të mbështjellë me një cipë të gomës, kur protesta ishte veç në shpërndarje e sipër. Kush i vrau personat që nuk ishin fare në protestë?

Në faqen shtatë të raportit të Inspektoratit Policor shkruan, mes tjerash, sipas njoftimeve nga mediat, njëri nga personat e vdekur, në fakt i vrarë nuk kishte qenë përkrahës i „Vetëvendosjes“ dhe kishte qëndruar pranë turmës në rrugën “Nëna Terezë”, vetëm nga kureshtja, do të thotë ai nuk ka qenë fare demonstrues dhe është vra. Kjo tregon se si ka vepruar policia dhe se çfarë raporti na ka sjellë Inspektorati që është mbështetur në

media dhe askund tjetër, kurse mediat të gjithë i kemi parë dhe aty hapur dhe shumë saktë dihen se si janë vrarë njerëzit.

Tash bëhet pyetja ku janë prokurorët ndërkombëtarë që kur duhet të veprojnë bëhen si struci, e fusin kokon në zallë?. Pse ende nuk janë identifikuar vrasësit, kur ata shihen qartë duke vrarë njerëz të pafajshëm dhe duarthatë. Pse hesht prokuroria ndaj Stefan Kurtisit, urdhërdhënësit për vrasje kur këta prokurorë janë shumë të zellshëm për akuzimin e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare, Madje edhe kur nuk kanë fakte relevante, siç ndodhi sot në Gjykatën Supreme ku po gjykohet një grup i Kaçanikut, pjesëmarrës të luftës.

Është turp për shoqërinë kosovare të na vriten njerëzit vetëm pse ata duan liri për vendin e vet dhe për bindje politike. Është turp, gjithashtu, që sot për motive politike të dergjen djemtë e Kosovës. Koha për vrasje dhe për burgosje të veprimtarëve politikë do të duhej të ishte kohë e kaluar, vrasjet dhe burgosjet nuk i zgjidhin problemet, përkundrazi ka mundësi t'i acarojnë edhe më tepër. I apeloj Qeverisë, të angazhohet për lirimin e menjëhershëm të të gjithë të burgosurve dhe atyre t'u paguhet dëmshpërblimi për kohën e kaluar në burg. Këtu përfshihet sidomos aktivisti Albin Kurti. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi, le të përgatitet deputeti Hajredin Hyseni.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI - Ju faleminderit z. Kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Fjalimet tona sot për ngjarjen e 10 shkurtit, 40 ditë pasi që ka ndodhur kjo ngjarje, janë pothuajse të papranueshme për qytetarët e Kosovës dhe të dhimbshme për familjet të cilët i humbën anëtarët e tyre të familjes dhe të dhimbshme për ato familje që dikur nga personat e tjerë i humbën anëtarët e familjet, të dhimbshme për ato familje të cilat kanë të burgosur politikë në Kosovë.

Si rezultoi që të vijë të formohet një grup që të paraqesë kërkesa politike në Kosovë pas çlirimit të Kosovës nga okupatorët. Pse u dasht të formohet ky grup? Përgjegjësia është në institucionet e Kosovës. Nëse ne si institucione vazhdojmë të jemi të papërgjegjshëm dhe gjithherë duke iu referuar interesave të qytetarëve, e duke u thirrë në transparencë, por pa i zbatuar ato, sepse hiq më larg se sot, ne diçka tjetër deklaruam për publikun e diçka tjetër vepruam me votime të fshehta. Kjo është edhe një prej shembujve se çfarë jemi ne në institucione. Nëse një grup politik organizohet dhe mendon më ndryshe se ne të cilët jemi në Kuvendin e Kosovës, se ata të cilët janë në krye të Qeverisë, atëherë çka u dashka t'u bëjmë atyre.

Të nderuar deputetë,

Ashtu si edhe unë që kam marrë një raport informatash këtu e keni marrë edhe ju. Nuk dua të lidhem shumë me raportin apo informatën nga Ministria e Punëve të Brendshme për shkak të kompetencave të ngushtuara. Mirëpo, një herë e kam bërë këtu një pyetje për një ministër tjetër, por kur gjithherë na hasë sharra në gozhdë themi s'ka kompetenca, atëherë pse pranojmë të jemi ose ta formojmë atë ministri. Nëse dikush tjetër vepron ndryshe ose nuk na informon neve, pse të jemi me një resor të caktuar apo

ta formojmë një resor të caktuar. Nuk jemi aq të padijshëm ose aq të papërgjegjshëm që së paku t'i kemi informatat apo të na kufizojë, nuk jemi aq të padijshëm e të papërgjegjshëm që gjithherë të jemi të kufizuar në qasje në informata.

Raporti përshkruan një kronologji të protestave nga 28 nëntori i vitit 2006 deri më 10 shkurt 2007 për të vazhduar pastaj më 3 mars 2007 dhe nuk i lë anash as protestat e organizuara para 28 nëntorit 2006. Unë kisha me pyetur pse në këtë kronologji nuk është përshkruar një gatishmëri e palëve, e përfaqësuesve të protestuesve dhe e organeve të rendit, një gatishmëri e qëllimit të mirë që të takohen dhe të bashkëbisedojnë dhe të merren vesh se si protestat të kalojnë ashtu siç ndodhi për 3 mars. Ajo gatishmëri ka qenë publike dhe ajo gatishmëri, kjo tendencë për këto takime apo ka qenë edhe publikisht e dhënë nga njerëzit të cilët janë dëshmitarë të ngjarjeve. Pse kjo nuk u përshkrua, pse personat të cilët janë përgjegjës vetëm pas protestës së 3 marsit ditën të dalin dhe të falënderohen për protestën e qetë, protestën demokratike, kurse pati prej tyre, që për ngjarjet e 10 shkurtit asnjëherë nuk i pa kush as në rrugë e as në media.

Unë mendoj se Kuvendi nuk duhet të merret me raporte apo me informata të cunguara dhe politike. Në raport nuk shihet si u lënduar njerëzit, me çfarë mjete u lënduan njerëzit, ku u qëlluan njerëzit që u lënduan dhe u trajtuan në spital dhe ata të cilët vdiqën? Pse kjo informatë kaq e cungueme? Çka po fshihet pas saj, edhe policia ndërkombëtare që është këtu? Unë nuk e besoj se nuk i din rregullat se si duhet të sillen në raste kur kemi protestues dhe në raste kur mund të eskalojë situata. Mirëpo, këtu në këtë raport thuhet: “bazuar në ngjarjet e kaluara dhe vlerësimin e se është duke u rritur dhuna nuk po e lexoj rresht për rresht thotë: është përpiluar një plan më i fortë operativ për të ofruar siguri maksimale në lëvizjen e lirë” e si rezultojë ajo lëvizja e lirë, rezultojë me vrasje dhe me burgosje këtë e quajmë lëvizje të lirë – këtë e quajmë plan operativ të fortë, unë mendoj se jo.

Në raport përmendet se kanë reaguar qytetarët në media, sepse institucionet nuk u mbrojtën nga organet e rendit, por u lejua që të thyhen dhe të njollosen me ngjyrë të kuqe dhe kjo paska qenë arsyeja më pas që policia të ketë një sjellje shumë brutale. Institucionet publike, institucionet e një vendi, prona publike, normal që është pronë publike. Institucionet janë të qytetarëve dhe duhet të mbrohen, mirëpo ky Kuvend nuk është asgjë më tepër se sa disa mure betoni, për 6 muaj ditë ngritët një objekt i tillë nëse ka qenë në pyetje lëndimi. Mirëpo, si duket, dikujt po i qeshet, mirëpo si do t'i kthejmë jetët e njerëzve, madje edhe të qytetarëve të pafajshëm që nuk paskan qenë fare protestues?.

Unë mendoj se institucionet e vendit, nëse vërtet e shohin që institucioni është i shenjët të mos e shohin që e shenjët është ndërtesa gjë e vdekur një ndërtesë, por e shenjët është përgjegjësia e të gjithë njerëzve që janë në ato institucione në raport me qytetarët. Askush në Kosovë nuk ka nevojë që ne të vajtojmë që ne të vajtojmë pas ngjarjeve që ndodhin, por çka kemi bërë në parandalim asgjë.

Shkëputja e institucioneve nga qytetarët do të rezultojë me protesta edhe në të ardhmen , por ndoshta jo të kësaj natyre, atëherë po dashka me i vra ata, nëse ne nuk dalim para qytetarëve dhe u shpjegojmë qartë se çka ka ndodhur, atëherë ne nuk jemi të aftë. Ku është Qeveria? Pse nuk del ajo para qytetarëve kur ata paraqesin kërkesa direkte? Ka marrë mandatin e Qeverisë të dalë para qytetarëve dhe t'u tregojë e sqaroj çka është kah ndodhë. Normalisht se kur nuk i gjen njerëzit që janë në institucionet e gjënë një objekt, kjo është krejt normale, mirëpo nuk është normale me dalë e me vra njerëz. Papërgjegjësia jonë si Kuvend për të qenë vetëm vëzhgues të ngjarjeve dhe pas një muaj, dy muaj të diskutojmë për ngjarjet që ndodhin, papërgjegjësia e Qeverisë, ngulfatja e tri pushteteve që folëm ma herët, janë të ndamë – nuk janë të ndamë, janë të ngulfatur nga politika. Kjo duhet të ndërpritet , sepse përndryshe nuk po na vyen shteti hiq, nuk po na vlejkan institucionet hiq, të ju tregojmë qytetarëve që nuk jemi të aftë për asgjë edhe mirë boll. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni me kartelën e Bajrush Xhemajlit. Përgatitet deputeti Hydajet Hyseni

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar. z. Ministër, të nderuar deputetë.

Ndërtimi i institucioneve demokratike dhe profesionalizimi i tyre është një sfidë e vazhdueshme e shteteve demokratike që synim kanë mirëqenien e qytetarëve, zhvillimin e vendit dhe realizimin e synimeve të qytetarëve të atij vendi.

Kosova vështuar përmes ngjarjeve të 10 shkurtit, mund të themi se ka mbetur mbrapa sidomos në profesionalizimin e institucioneve dhe kjo për shkakun se në Kosovë nuk kanë ekzistuar kritere profesionale dhe metodat demokratike të punësimit në institucionet dhe mekanizmat, por çelës i punësimit ka qenë çelësi partiak – familjar, gjë që ka krijuar mosfunksionalizmin normal të këtyre institucioneve, andaj edhe raporti për të cilën ne po bisedojmë sot ka qenë dashur që pikë fillimin e hulumtimit të ketë në këtë drejtim se sa janë profesionale institucionet dhe mekanizmat tjerë që veprojnë në Kosovë për të vepruar konform rrethanave të krijuara siç ishte 10 shkurt.

Të nderuar deputetë,

U tha edhe më parë nga kolegu se vitin e kaluar besoj se çdokush nga ne ka imazhin e një rebelimi dhe të një protestimi të dhunshëm në Francë, tani së voni ne kemi parë një gjë të tillë edhe në Danimarkë ku për një shtëpi të kulturës hidheshin gurë, kalleshin automjetet e policisë nga studentët. Na ka ra të shohim edhe protestat e fundit në Greqi, ku njerëz të maskuar hidheshin plagë dhe gurë mbi policinë, dhe më thoni se sa njerëz kanë vdekur në këto protesta – asnjë. Janë plagosur disa nga hedhja e tymit, por të vdekur jo, sepse në këto vende ekziston profesionalizmi i institucioneve, sepse në këto vende politikëbërja ka strategji dhe qëllim i tyre është ruajtja dhe funksionimi i shtetit, ruajtja e qytetarit.

Sot në këtë informacion do të duhej që të na jepet përgjigje se a kishte forca të mjaftueshme për ta përballuar turmën e protestuesve pa përdorur as tymin as ujën më 10

shkurt, apo pyetja tjetër: Pse fillimisht, në qoftë se ka qenë e detyrueshme nuk u përdorën uji apo gazi lotsjellës, por plumba që shkaktuan vdekjen e protestuesve, sepse kjo ishte, mund të deklarohet një parapërgatitje. Dhe pyetja fundamentale për mua është: se mos vallë ishte krijuar një ambient politik i tillë ku nga paaftësia dhe joprofesionalizmi i institucioneve që kishin treguar në protestat paraprake dhe tani donin të hakmerreshin, duke dashur t'u japin një leksion se nuk guxojnë t'i ngjyjnë ndërtesat me ngjyrë, një leksion që rezultojë me humbje të jetave, plagosje, për çka në rend të parë institucionet janë të thirrura ta ruajnë jetën e qytetarëve dhe t'i mbrojnë ato.

Të nderuar deputetë,

Ngjarjet e 10 shkurtit na mësojnë se si nuk duhet të sillen policia në një shtet demokratik. Ato na mësojnë se edhe protestuesit që duan t'i shfaqin mendime të tjera duhet t'i respektojnë institucionet dhe normat demokratike për të mos u bërë edhe vetë pjesë e tragjedisë, sepse duhet të jenë koshientë për mekanizmat joprofesional që veprojnë sot Kosovë. Të nderuar deputetë, informacioni që kemi sot është një informacion sipërfaqësor, i cili nuk thellon në shkaqet e 10 shkurtit që quan në vdekjen e qytetarëve, por më shumë merret me një përshkrim sipërfaqësor, sa për të na sjell një informacion, për të kryer një obligim e jo një informatë që do të shpjegonte ngjarjet, që Parlamenti të mund kishte pasur një pasqyrë reale dhe të shihte se cilat janë mundësitë e institucioneve që t'i përmirësojnë gabimet e bëra. Mendoj se ministri dhe Ministria nuk ka pasur nevojë të na thotë se njëri nga të vrarit ishte apo nuk ishte anëtar i vetëvendosjes, por të na shpjegojë ai pse u vra ai te hotel "Iliria", kjo do të duhej të ishte shpjegim i tyre dhe qëllimi i informatës së prurë këtu, dhe në fund respektimi i mendimit të tjetrit, respektimi i mendimit të kundërt është kulturë politike, institucionet duhet të mësojnë këtë, se pak këtë demokraci dhe zhvillim në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni –Kaloshi, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – I nderuari z. kryetar, zonja, zotërinj deputetë më lejoni që kësaj radhe ta përshëndes posaçërisht ish-ministrin e Brendshëm që nuk po e shoh këtu, paska dalë dhe ta përshëndes për aktin e tij, sikur të mos ishin edhe ndonjë deklaratë pak e nxituar përpara, mendoj se do të ishte edhe më dinjitoz. Na duhen edhe akte dinjitoze.

Unë dua ta përshëndes edhe këtë... Urdhëroni do të dëshiroja më vonë ta vazhdojmë, e përshëndes edhe frymën e këtij debati që është në funksion të qetësisë dhe normalizimit të gjendjes. Mendoj që na duhet një qasje e tillë, prandaj edhe unë nuk do të lëshohem në analizimin, vlerësimin e informatës së dhënë nga Ministria, është ashtu siç e kemi Ministrinë e brishtë, e hallakat me ambiguitete, kontradiksione po kështu jemi. Megjithatë, mendoj se një çështje del qartë. Policia dhe jo vetëm policia fatkeqësisht ka dështuar në këtë sprovë. Mendoj, ne duhet ta theksojmë këtë vetëm që të nxjerrim mësim për të ardhmen. Do të mund të diskutohej a është kjo çështje vetëm çështje sigurie sa ne të flasim tash vetëm për një informatë të Ministrisë së Brendshme dhe të kufizohemi vetëm në këtë segment? I mungon qasjes sonë, debatit tonë përqendrimi në shkaqet që prodhojnë fenomene të tilla.

Gjithmonë kur nuk jem përqendruar në shkaqet, por kemi luftuar pasojat pastaj janë shumëfishuar pasojat. Unë këtu pastaj këtë funksion e mbështes natyrisht edhe ritheksoj nevojën që të shikojmë timonin e të mos lejojmë vetëkënaqësi si institucione, sa jemi si institucione në nivelin e përgjegjësisë historike që kemi dhe mbi këtë bazë sa është besueshmëria jonë, nëse ne bëjmë, i bindim qytetarët tanë të gjithë edhe ata që janë të pakënaqur me të drejtë edhe që ata që mund të jenë pakënaqur pa të drejtë. Pra, t'i bindim se këtu është vendi ku duhet të bëhen politikat, se ky është institucion i yni, se policia është jona, se gjyqësia është jona, se edhe prania ndërkombëtare është partner i yni, atëherë gjithçka do të ishte ndryshe. A e kemi arritur këtë, është për ta diskutuar, por unë nuk dua të marrë kohë shumë.

Mua ajo që më ka bërë përshtypje ose, nëse më lejoni vetëm sa për ta ilustruar atë që thashë më parë. Sot ne biseduam për diçka tjetër për tenderët edhe i harruam qytetarët. Ju e dini çfarë është gjendja e qytetarëve tanë, shikoni fëmijët e Kosovës vuajnë për sendet elementare: bukë, libra shpesh nuk kanë dhe nëse ne luajmë siç luajtëm sot me tender e me tjerë, unë druaj që një herë do të kemi nevojë për të bërë raporte shumë më serioze për çështjet sociale, për shpërthime sociale dhe ne do të merrmi pastaj a ishte kjo më së miri apo nuk ishte më së miri etj. Policia nuk ka dështuar zonja e zotërinjë se pati panikë e nuk reagoi në mënyrën më profesionale, ka dështuar në vetë qasjen, konceptin dhe unë këtu dua ta vë theksin nëse më lejohet vetëm sa për ta tërhequr vërejtjen që të mos na lejojë të përsëriten në të ardhmen, te mendësia e vjetër e cila mua më është shfaqur më është fanitur në shumë dimensione. Për shembull, shikoni ju lutem sytë e policit që e arreston dhe i shtrëngon qëllimisht protestuesit të qetë, i kam parë diku ata sy, kujtoj policin apo policët që vrapojnë për ta zënë në periferi diku të sheshit një protestues pse ai thotë vetëvendosje, kemi parë diku në situata të tilla dikur, dikush se shkruante KR kapej, rrihej, torturohej dhe pastaj paraqitej si dëshmi lojaliteti e tjera, ose shikoni mediat tona si reagues, çfarë programe jepnin, ato informata, artikuj plotë ndjenja me patos, njëfarë servilizmi që përsëri më dukej i njohur e kemi parë diku edhe disa të politikanëve tanë të tilla ishin dhe më besoni më kanë irrituar.

Po më lejoni vetëm të përmend për mentalitetet e vjetra edhe dy ose tre shembuj: njëri nga këta të arrestuarit të cilin do të thotë e di rastin e tij mirë thirret para gjykatës dhe gjykatësja e pyet: Je Vetëvendosja, përgjigja jo, do të marrësh pjesë në protesta tjetër herë ai thotë mund të marr - 40 ditë a burg,. Dikujt që ka thënë nuk marr 15 ditë burg. Mendësia e gjykatësit që mendon se ai duhet të bëjë politikën se çka është e drejtë e çka nuk është e drejtë dhe nuk e di se e drejta për të marrë pjesë në protestë është e drejtë elementare demokratike. Nuk jemi në kohën e para 20-30 vitesh. Rasti tjetër gjatë bartjes të një të arrestuari që nuk ishte Vetëvendosja mund të ishte vendvendosja dhe nuk do të ishte gjë e keqe prej qelisë në tualet e pyet: Ke protestuar? Po. Do të protestosh?— Ndoshta, dhe e godet me kokë dhe e plandosë në tokë e le pa frymë.

Është raportuar nëpër media, nuk e pashë në raport. Përsëri është praktika që i kemi parë zonja dhe zotërinj tash ndodhin në relacione të tjera.

Megjithatë unë këto kisha dashur të mos i përmendja fare, mua më erdhi, po i përmend për të mos lejuar që të na përsëriten në të ardhmen. Më ka bërë përshtypje shumë

mesazhi i babait të dëshmorit po e them me plotë gojën të ri të Kosovës Shaban Gjelladini, babi i tij që thotë: Do të dëshiroja që djali im të jetë i fundit që pëson në këtë mënyrë.

Do të ishte mirë që edhe diskutimi ynë, ndoshta edhe raporti të përfshinte masat që janë ndërmarrë që situata të tilla të mos ndodhin, të parandalohen, dhe kur ndodhin përsëri të parandalohen. Mua më pëlqen një rekomandim në informatën që thoshte se një nga masat që duhet të ndërmerren në të ardhmen është dialogu edhe me grupet kundërshtarë. Nuk e prisja, sepse ishte politik edhe teste si të thuash na ka munguar kjo dhe na ka kushtuar dhe ne mund ta nënçmojmë po mendoj që nuk bëjë mirë. Unë do të dëshiroja që të kemi një dialog me Albin Kurtin ta zëmë. Të bëjmë debat me të dhe të polemizojë ndoshta për ndonjë aspekt, por dje ishte dita e pranverës, nesër është ditëlindja e 32 –të të cilin Albini, më lejoni njëri nga djemtë më të mirë që ka pasur ndonjëherë e që ka Kosova. Mund të ishte edhe ai ministër e të lunte me tenderët që diskutuam sot etj. ai po e kalon në qeli. Prandaj, më lejoni që në frymën e asaj që thamë të një fryme të një mirëkuptimit e tolerancës që të propozoj që ne si deputetë të këtij Kuvendit ta bëjmë një apel të përbashkët për lirimin e Albinit, nëse më lejoni do ta thoshim kështu:

- Duke shprehur shqetësimin e tyre dhe të qytetarëve të shumët të Kosovës për vazhdimin e mbajtjes në burg të drejtuesit të Lëvizjes „ Vetëvendosja,“ z. Albin Kurti, të vetëdijshëm për pasojat e padëshiruara dhe të rrezikshme aktuale perspektivën e praktikës së të burgosjeve, burgjeve dhe inkrimimeve politike, duke besuar në mungesën e arsyeve të vërteta dhe të fakteve relevante që do të justifikonin mbajtjen një burg të një veprimtari politik si Albin Kurti, të motivuar nga synimi për të përmirësuar imazhin e Kosovës demokratike në momentet që po kalon duke ruajtur, forcuar dhe avancuar frymën e lirisë e të shprehjes dhe të organizimit si dhe hapësirën për bashkëjetesës dhe bashkëveprim në tolerancë e përputhshmëri të shumësisë së programeve dhe strategjive të ndryshme politike kombëtare e demokratike, deputetët e Kuvendit të Kosovës apelojnë:

1. Të lirohet menjëherë nga burgu si i pafajshëm veprimtari Albin Kurti dhe të ndërpritet fushata e ndjekjeve dhe persekutimeve ndaj veprimtarëve dhe drejtuesve tjerë të Lëvizjes “Vetëvendosja” se edhe kjo po ndodh. Nëse eventualisht ne nuk përzihemi në punën e drejtësisë, organet e drejtësisë vlerësojnë se disponojnë fakte, arsye për fillimin e far procedure ndëshkimore kundër veprimtarëve dhe drejtuesve të Lëvizja Vetëvendosja atëherë së paku të mundësohet mbrojtja e tyre në liri në përputhje me ligjin dhe praktikën e mirënjohura ndërkombëtare. Në cilin do rast veprimtarëve dhe drejtuesve të Lëvizjes “Vetëvendosja” t’u mundësohet liria e shprehjes dhe organizimit në përputhje me ligjin dhe praktikën demokratike ndërkombëtare si dhe përfshirja e tyre adekuate në

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.
Përgatitet deputeti Gani Koci

DEPUTETI BAJRAM KOSUMI - I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë. Fillimisht po e falënderoj deputetin Emrush Xhamajli dhe deputetët e tjerë që kanë nxitë diskutimin e kësaj teme në Kuvendin e Kosovës. Unë i veçoj dy dimensione ose dy përmasa të problemit dhe temës që po e diskutojmë sot. Përmasa e parë është politike, dhe unë besoj se në esencë dhe në vija më afatgjate kjo është më esenciale. Përmasa politike ka të bëjë me menaxhimin e procesit të statusit final të Kosovës dhe kjo është më tepër se një vit qytetarët e Kosovës nuk kanë qenë të njoftuar sa duhet se çka është duke ndodhur në procesin e vendosjes për statusin final të Kosovës, jo vetëm qytetarë të Kosovës, por edhe Kuvendi i Kosovës, deputetët që është organi më i lartë ligjdhënës i vendit tonë nuk ka qenë sa duhur të njoftuar me procesin e vendosjes për statusin final të Kosovës. Dhe çka ka rezultuar kjo, kjo ka rezultuar me krijimin e dyshimeve te një numër i madh i qytetarëve të Kosovës se çka po ndodh me fatin e Kosovës dhe ky rezultat ka krijuar një pasojë, ajo pasojë është parë me n 28 nëntor të vitit të kaluar kur qytetarët e Kosovës kanë hedhur gurë ose shishe në objektet e Qeverisë të Kosovës, objekte të ndërtuar me paratë e atyre qytetarëve. Kjo është parë edhe më shumë me 10 shkurt kur për herë të parë në historinë e demonstratave në Kosovë janë ballafaquar dhunshëm mes veti dy grupe politike që të myjat grupe patriotësh. Shërbimi Policor i Kosovës që ka dalë t'i mbrojnë institucionet e Kosovës dhe policët e atij shërbimi janë patriotë, kanë dalë t'i mbrojnë institucionet e Kosovës, por në anën tjetër edhe demonstruesit qytetarë të Kosovës ose anëtarë të Lëvizjes „Vetëvendosja „janë po ashtu patriotë që kanë dalë ta shfaqin shqetësimin e tyre për statusin final të Kosovës.

Ky është dimensionin politik që po e quaj dhe këtë dimension është dashur ta parashikojmë edhe më herët, por ende nuk ka përfunduar ky proces edhe unë po e theksoj që ta parashikojmë për muajt e ardhshëm. Në Kosovë mund të priten ngjarje të tilla edhe në të ardhmen edhe pas vendimin për statusin final të Kosovës. Prandaj është në përgjegjësi në radhë të parë të Ekipit Negociator, pastaj të Qeverisë së Kosovës, të Kuvendit të Kosovës, të partive politike, që të hapin edhe më fuqimisht se deri më tash dialogun me qytetarët e Kosovës, në mënyrë që të ventillohet energjia e dyshimeve, energjia negative rreth statusit final të Kosovës.

Përmasa e dytë është ajo që po e quaj procedurale ose praktike, me 10 shkurt janë vra 2 qytetarë të Kosovës dhe Kuvendi duhet të merret me këtë çështje. Unë e përkrah fuqimisht rekomandimet edhe të Komisionit, por mendoj se duhet këtyre rekomandimeve t'u shtohen edhe disa rekomandime tjera. Nën një, do të inkurajohet Shërbimi Policor i Kosovës dhe ministri dhe Ministria e Punëve të Brendshme që t'i trajtojë Shërbimin Policor të Kosovës që të aftësohen për t'u ballafaquar me situatat të tilla edhe në të ardhmen. Ne do të jemi në të ardhmen shtet normal siç janë të gjitha shtetet dhe do të ketë protesta edhe paqësore edhe jopaqësore. Edhe në shtetet me një traditë të gjatë demokratike ka protesta jopaqësore dhe policia duhet të trajnohet. posaçërisht qysh të ballafaqohet me situata të tilla. Përmendi z. Maloku në diskutimin e tij miratimin e dy ligjeve, që po ashtu unë po e theksoj janë shumë të rëndësishme ; Ligji për tubimet politike dhe Ligji për përdorimin e forcës nga ana e policisë. Nën dy, këtyre rekomandimeve duhet t'u shtohet edhe dënimi i vrasjes së qytetarëve të Kosovës në protesta.

Nuk mjafton të thuhet se janë të papranueshme, duhet të dënohet vrasja mënyrën joligjore e këtyre dy qytetarëve të Kosovës, dhe duhet të kërkohet me një rekomandim që të përkrahet hetimi i detajizuar i të dy rasteve, mënyra se si janë vrarë që të dy qytetarët e Kosovës dhe kjo procedurë të vazhdoj në gjyq në bazë të ligjeve në fuqi në cilindo gjyq që mund të bëhet kjo. Dhe duke përfunduar këtë, duke përkrah demonstrimin e koncepteve politike të qytetarëve edhe në forma jashtë parlament, por duke kundërshtuar fuqimisht përdorimin e dhunës në rastet e tilla, por Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës janë përgjegjëses edhe për pasojat edhe për rezultatet që dalin nga proceset e tilla, dhe Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës duhet të përgatiten jo vetëm për kompetencat e një shteti, por edhe përgjegjësitë që dalin nga të qenit shtet dhe nga të qenit Qeveri i një shteti ndaj qytetarëve të vet. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gani Koci. Përgatitet deputeti Ymer Halimi

DEPUTETI GANI KOCI – Ju faleminderit z. kryesues, i nderuari ministër. meqë jeni për herë të parë dhe paraqiteni për herë të parë në Kuvend i kam nja dy vërejtje që do të dëshiroja që të m'i merreni me dashamirësi. E para, vërtet të tregoheni se jeni ministër dhe përfaqësoni një institucion edhe me tujtje. Në perëndim në disa lokale në hotele nuk lejohet bash me shkua pa kravatë. Është çështje e mirësjelljes ose sjelljes në një rreth të caktuar, sepse mund të jepni imazhin e keq para qytetarëve dhe për krejt Qeverinë këtu dhe e dyta, po ashtu dëshiroj të ma marrësh me dashamirësi edhe këtë vërejtjen e dytë, para se ta lexoni ose të lexoni raport që përgatitni për Kuvend nëse vetë nuk e përgatitni atë, sepse sigurisht se keni angazhime së paku ta lexoni dhe të dini se vërtetë se çka do të thoni në Kuvend.

Në leximin e Raportit tuaj, vërtet, sipas mendimit tim nuk dihet as ku është ve pika as ku është presja dhe besoj shumë se po ta lexonit do të bëni një korrekturë të vogël rreth kësaj, po këto ndoshta nuk janë esenciale nga ajo që duhet të them.

Edhe në fjalën tuaj, edhe në raportin që ka ardhur bashkë me informacionin e Komisionit të Kuvendit për Siguri, nuk është thënë ajo që ne e kemi pritur si deputetë. Është përshkruar ndoshta në detale lëvizja e protestuesve, veprimet e tyre të hijshme e pahijshme, me vend e pa vend, por nuk është dhënë asnjë detal i sjelljeve dhe i veprimeve të kundërligjshme të policisë qoftë të Policisë së UNMIK-ut, qoftë të Shërbimit Policor të Kosovës në këto protesta.

Keni theksuar në detale mungesën papërvojës për t'u ballafaquar me situata të tilla të policisë – Shërbimit Policor të Kosovës që pajtohem plotësisht me këtë. Keni theksuar se potencuar edhe pajisjen joadekuate dhe jo të duhur ose mospasjen e kësaj pajisje të Shërbimit Policor të Kosovës dhe këtë në përshkrime deri në detale se a është dëgjuar zëri në kufje të radio-lidhjeve, a kanë pasur maska që mund të vendosen mbi helmetet ose jo dhe nuk keni përshkruar rastin se si është vrarë një një njeri ose tjetri protestues, në cilat vende është vrarë, kush është ai që ka shtie në ta, a janë përdorë ato pajisje sipas

rregullave të përdorimit të mjeteve të tilla ndaluese për protestat, sa masa ose çfarë masa disiplinore keni marrë ndaj policëve ose atyre që i kanë thye rregullat e sjelljes në raste të tilla dhe kanë tejkeluar aturozimet, sa keni larguar nga ky Shërbim ose nga Policia e UNMIK-ut. Çfarë procedurash janë marrë, sa janë duke u hetuar në organet e gjyqësisë, dhe këto do të ishin informacione që vërtetë do të na e shtonin edhe neve si deputetë besueshmërinë dhe sinjeritetin edhe në Shërbimin Policor të Kosovës edhe në Ministrinë e Drejtësisë edhe në Shërbimin e Policisë së UNMIK-ut.

Kur e shikoj ato se çka i ka munguar kësaj policie, unë them fatmirësisht që policia nuk ka qenë e pajisur mirë, se po të ishte më mirë e pajisur, atëherë do të kishim më shumë të vrarë, do të kishim më shumë të plagosur, do të kishim ma shumë gjak dhe çështjet e tilla vërtet ne si deputet i presim. Ne si deputetë i kërkojmë, sepse sipas raportit shihet shumë se kush dhe çfarë përgjegjësie ka pasur sa i përket edhe policisë së UNMIK-ut edhe Shërbimit Policor, derisa thuhet se është udhëhequr tërë situata, tërë incidenti nga një qendër e caktuar.

Ministri ose ish ministri i kësaj ministrie e ka bërë një akt dhe një gjest vërtet që i duhet një politikan që do të duhej të ishte shembull edhe për veprimet të ministrave të tjerë, por nuk di si mund të qëndrojnë në krye edhe të Shërbimit Policor ata që në një mënyrë kanë qenë direkt përgjegjës për menaxhimin e situatave të tilla, dhe krejt në fund nuk di sa është e arsyeshme që ky Kuvend të kërkojë ose të apelojë për lirimin e Albin Kurtit. Ky Kuvend duhet të kërkojë nga Drejtësia respektimin e ligjit dhe respektimin maksimal të ligjit. Asnjë protestues e as Albin Kurti në këtë rast nuk kanë kryer veprë penale me të cilin do të duhej të dënoheshin, paraburgoseshin ose të akuzoheshin. Në rastin më të lehtë ose që mund të thuhet mund të kenë bërë një kundërvajtje dhe jo veprime penale, duhet të dënohen ata që vranë dhe jo ata që i paskan rrotulluar ose paskan larguar barrikatat nga rruga.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, pastaj deputetja Myrvete Dreshaj Baliu e ka dorëzuar me shkrim fjalën e saj , përgatitet deputetja Sala Berisha Shala

DEPUTETI YMER HALIMI - Ju faleminderit kryesues, i përshëndes të pranishmit. Me thënë të drejtën të debatosh për një ngjarje të 10 shkurtit me 22 mars kjo flet vetvetiu për nevojën e një serioziteti që duhet ta kemi për t'u përballë me realitetin politik dhe kjo kohë për mua është tepër e gjatë. Vetëm dy javë para 10 shkurtit debatuam në Kuvend për sigurinë dhe askush nuk arriti ta parashikojë 10 shkurtin aq të hidhur. Megjithatë të të gjithë shihej një shqetësim, në pasiguri për sigurinë e natyrshme, se çështja e sigurisë në përgjithësi është segmenti më i ndjeshëm ma kompleks i një kombi, prandaj kërkohej përgjegjësi individuale dhe kolektive e të gjithë në debat,. Kjo aq më parë kur dihej se në çfarë faze zhvillimi shihemi dhe në të cilat procese jemi duke ecur dhe specifikat e posaçme të them ashtu që ne i kemi. Kur jemi në përpjekje për formimin e institucioneve demokratike dhe në përpjekje për të hyrë suksesshëm në fazë përfundimtare për bërjen e shtetit dhe njohjen e tij.

Deputetë të nderuar,

Për një segment sigurie nuk është vlerë matëse vetëm të kesh mija policë e forca ushtarake. Këtë e pamë në shkurt dhe mars që i lamë dhe duhet të kërkojmë diçka tjetër. Ngjarjet e muajve të cekur treguan se shkalla e sigurisë së një vendi, më së drejti matet me shkallën e realizimit të proceseve demokratike dhe lirisë së qytetarëve në atë vend si dhe me shkallën e realizimit të proceseve demokratike në vendet që e rrethojnë. Po ashtu siguria varet nga shkalla e vetëdijes së qytetarëve për demokraci dhe vetëdijes së shtet formuese të vetë institucioneve të atij vendi, për këtë kemi dëshmi. Pamë storie demonstratash në Paris, Budapest, në Kopenhagë, Berlin, Athinë e gjetiu bile demonstrues edhe ma agresivë se sa vet në Prishtinë, por atje nuk pamë të vrarë nga policët se institucionet e tyre kishin përgjegjësi institucionale, profesionalizëm dhe kishin vlera demokratike. E natyrshme se ata e kanë bërë shtetin dhe lirinë dhe e kanë vendosur demokracinë kohë më parë, ndërsa te ne të gjitha këto janë në fazën embrionale. Bash kjo fazë embrionale na ka sjellë pasiguri dhe na jep edhe demonstrata dhe bash për këtë kohë ne duhet të jemi shumë të përgjegjshëm e të vetëdijshëm edhe si institucione po e besoj edhe si demonstrues.

Deputetë të nderuar,

Mund t'i kthehemi pak diçkaje tjetër konkrete. Në dorë e kemi informatën mbi protestat e 10 shkurtit në Prishtinë të përgatitur nga Ministria, përkatësisht Blerim Kuqi ku shkruan se planifikimi për 10 shkurtin është bërë në bashkëpunim me policinë ndërkombëtare dhe SHPK-në dhe se intelijenca ka theksuar se grupi "Ventëvendosje" ka pasur një qëllim të dëmtimit të pronës. Më pastaj vazhdon: Komanda dhe kontrolli i përgjithshëm i këtij operacioni ka qenë ne Shtabin Qendror të Policisë, së fundit del se përpjekja për dëmtimin e objekteve paskan qenë shishe ngjyre sipas informatës së inteligjencës, shtrohet pyetje: Çfarë inteligjente është kjo kur ka arritur vetëm kaq të kuptoj. Thënë të vërtetën ky planifikim me përmbajtje për mbrojtjen e pronës ishte ndër planifikimet e këqija, prandaj adresa e përgjegjësisë për këtë nga ana vendore bie në majën e piramidës së SHPK-së, dhe nga kjo papërgjegjësi do të ishte dikush kompetent që kjo përgjegjësi të ekzekutohej.

Dorëheqja e ministrit ishte një shembull tejet i mirë që dha shpresë se vërtet ne në institucione kemi njerëz mjaft të përgjegjshëm dhe dinë të veprojnë në kohën e duhur, në mënyrën e duhur, ndërsa sa i përket burgosjes së Albin Kurtit këtë mund ta themi pjesërisht, por kryesisht ka tone politike dhe më vjen keq që është në burg, do të ishte mirë të lirohej, sigurisht këtë e vendos vetë drejtësia në formën e duhur. Ju faleminderit për vëmendje.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ – I nderuari kryetar, kryeministër, ministra dhe deputetë

Nuk do të nisë fjalën time me ndonjë vlerësim të veçantë për raportin e sjellë në Kuvend, përveç konstatimit të përgjithshëm se ky raport nuk na jep informacion më shumë se sa që na e ka ofruar media e shkruar dhe elektronike. Krejt çka mund të çmohet këtu është se ky raport ka identifikuar disa elemente për të cilat edhe mund të dyshohej.

Dëshiroj që fjalën time ta përqendroj në disa rrafshe të tjera të komunikimit tonë publik dhe të ë rëndësisë që ka kjo në dritën e zhvillimit të ngjarjeve të 10 shkurtit.

Pas demonstratave të “Vetëvendosjes” kur ajo përdori shishet e mbushura me ngjyrë, që krijuan një opinion përgjithësisht refuzues ndaj saj, madje jo vetëm nga institucionet qeveritare, por edhe nga shoqëria civile. Ashtu sikur nuk ndodh përgjithësisht në botën demokratike, krijimin e këtij opinioni e ka ndihmuar edhe një pjesë e madhe e mjeteve të informimit. Unë besoj se për këtë kanë qenë të vetëdijshëm edhe drejtuesit e “Vetëvendosjes”, por këtu do duhej shtruar pyetja nëse kemi guxuar që kështu kolektivisht: institucioneve qeveritare, media dhe madje shoqëri civile të diferencohemi nga një organizatë, që misionin e saj, pavarësisht ka apo nuk ka të drejtë, e konsideron të shenjtë.

Ky qëndrim të cilin fatkeqësisht e mbajtëm të gjithë, pa një reflektim paravajtës, krijoi një atmosferë, e cila sidomos në prag të demonstratave nuk ishte vështirë të shihej, se si në vend që të shtronim takimet dialoguese ne, përforcim pozicionet tona. Në një situatë ku në njërin anë rrugët e komunikimit minohen, ndërsa në anën tjetër shtigje të reja nuk janë hapur, vrasjet edhe mund të jenë të paevitueshme. Vetëm pranimi i kësaj gjendjeje fatmirësisht, reflektoj ndryshe në protestën e 3 marsit.

Nuk dëshiroj që këtu të përgjithësoj gjërat në emër të mënjanimit të përgjegjësive individuale dhe institucionale. Identifikimi i përgjegjësit dhe institucionet që çoi në vrasjen e dy të rinjve është kusht, jo për mbylljen, por për hapjen e rrugës, që do të na vetëdijësonte të gjithëve, ata që gjendeshin drejtpërdrejtë në skenën e atyre ngjarjeve, dhe ata që i shikuan nga larg e me indiferencë.

Le të jetë ky një mësim për të gjithë ne, në marrjen e përgjegjësive individuale dhe institucionale, si dhe një përvojë për mënyrën se si duhet të sillemi në të ardhmen.

KRYESUESI, NAIM MALOKU - Fjalën e ka Sala Berisha Shala – dhe përgatitet deputeti i fundit Ymer Muhaxheri

DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA - Ju faleminderit . I nderuari z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë, z. ministër i Rendit i vetmuar nga kolegët tuaj të Qeverisë. Është vështirë të diskutosh në këtë pikë të rendit të ditës përveç tjerash edhe në kuptimin e formulimit të fjalisë si të tillë pa dalëpak jashtë formulimit, siç është shqyrtimi i Informatës për ngjarjet e 10 shkurtit 2007. Megjithatë, ndiej obligim të them disa fjalë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mos të harrojmë se si Parlament jemi institucion ligjdhënës dhe mbikëqyrës, dhe sa jemi në nivel të detyrës, përkatësisht të obligimeve tona. Jo pak herë sot u përmend mungesa e ligjeve edhe për rastin për të cilin po flasim tani.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk jam këtu të flas për konotacionet politike të ngjarjes të 10 shkurtit 2007, nuk jam këtu të flas as për t’i arsyetuar protestuesit e “Vetëvendosjes”as për të gjykuar të drejtën

de qytetarëve për të protestuar e as për dhunën e përdorur kundrejt qytetarëve duar thatë me bindje politike ndryshe. Do të bëjë përpjekje shkurt, të fokusohem në një pjesë të raportit të ofruar nga ana e Qeverisë përkatësisht Ministria e Drejtësisë. Mendoj që ky Raport është një shabllon injorus deri në qesharak. Më lejoi të citoj pjesë nga ky Raport nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, drejtuar z. Jonuz Salihaj për Komisionin për Siguri. Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me të gjithë partnerët e drejtësisë penale dhe ë përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet e aplikueshme në Kosovë, citoj: Ligjet e aplikueshme synon të rehabilitoj dhe risocializoj të burgosurit, rehabilitoj dhe risocializoj të pasocializimit, kupto dhe duke i respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh gjuhën, racën dhe religjionin, gjuhën, racën dhe religjionin – kupto, por jo edhe bindjet e tyre politike, si dhe siguron ambient të sigurt tjetër – kupto nuk janë të rrezikuar nga gazi lotsjellës.

Bazuar në këtë deklaram të misionit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është i obliguar të krijojë një ambient të sigurt dhe të rehatshëm për të gjithë, në veçanti për të burgosurit, për secilën kategori pyetja vjen. Po vazhdoj ta citoj prapë Raportin.: të gjithë kanë pasur kontakte me familjen sipas dëshirës, janë pajisur me libra nga bibliotekat e qendrave. Drejtorët e qendrave përkatëse i kanë vizituar të gjithë këta të burgosur dhe nuk kanë ndonjë shqetësim – atë shqetësim për çka kanë protestuar, d.m.th. janë krejt në rregull dhe nuk kemi nevojë të shqetësohemi për ta.

Do të dëshiroj, që këtu sot të ishte komplet Qeveria po kryesisht z. Jonuz Salihaj si ministër i Drejtësisë edhe për një arsye tjetër. Në vitet '80-ta e kam pasur profesor kimie i rreshtuar në anën e nxënësve të rebeluar. Me rastin e emërimit të tij si ministër i kësaj Qeverie i pata thënë: Si ndodhesh në Ministri të Drejtësisë e jo në të Arsimit për shembull. Ai m'u patë përgjigjur: “ Se jam njeriu më i drejtë në Kosovë”. Jam kureshtarë ta dija se a mendon prapë se është i tillë? Për mua veç sa thellohet dilema, a i mungon peshorja e drejtësisë z. Salihaj apo i mungon profesionalizmi apo të dyja së bashku. Të gjitha këto dhe skandalet e tjera e kanë një adresë në paaftësinë e Qeverisë, në sistemin e drejtësisë, sigurisë etj. por shumë e aftë me turr e vrap për të siguruar e mbushur xhepat e tyre për të përmirësuar jetën e tyre në këta minutat e fundit të qeverisjes së tyre. Me fjalë tjera, sistemi i drejtësisë, i rendit, i sigurisë nuk janë aspak në nivel pa i përmendur në këtë pikë të rendit të ditës dhe sisteme të tjera. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Deputeti Ymer Muhaxheri e ka fjalën

DEPUTETI, YMER MUHAXHERI – Kuvend i nderuar, z. kryetar. Në fjalën time të përgatitur kam pasur parasysh dhe kujdes në katër elemente. Nuk po i theksoj më gjerësisht shkaku se kam konsideratë ndaj kohës së juaj. Elementi i parë është se kur flitet mbi të drejtat dhe liritë universale të cilat janë të sanksionuara me ligjet ndërkombëtare dhe të shteteve të ndryshme, duhet pasur parasysh organizimin, tubimin, mobilizimin e këtyre se çfarë mase ato i përmbahen normave shoqërore. Përndryshe, nëse nuk e keni parasysh këtë element, atëherë kishim me ra në pozitat e anarkizmit, kishte me u sjellë njeriu si anarkist, e kishim paraqitur një shoqëri anarkike, për atë duhet me e gjetur atë masë, atë ndjenjë të maturisë për me mundur me i evituar këto

produkte apo nusprodukte të fenomeneve shoqërore të cilat i kanë përcjell lëvizjet e ndryshme, kohërat e ndryshme, vendet e ndryshme në shoqëri të ndryshme, e nëse keni kujdes, atëherë anarkizëm, anarkist është gjithë ajo sjellje, ai veprim, të menduarit e njeriut i cili nuk respekton normën shoqërore, ai është obligim imperativ i çdo qytetari. Shoqëri do të thotë ekziston një vend, rendi mbështetet në ligj, institucionet janë ato të cilat e zbatojnë ligjin, institucioni i sigurimit e ka objektivin e tyre, është pacenueshmëria e njeriut, pronës, institucioneve, e nëse ato sjellje vullnetare që nuk respektojnë as një normë e konkretisht situatën tonë, institucionet janë dalë prej një organizimi të caktushëm shoqëror nëpërmjet votës të popullit, atëherë e shohim se kur duam me e vlerësuar nuk e kemi parasysh këtë element. Elementi tretë, pozita dhe misioni i deputetit, ai si deputet merr pjesë në nxjerrjen e ligjit sipas misionit të tij e ka respektimin e ligjit, e në anën tjetër kemi mirëkuptim, rastësisht për një lëvizje si dhe i ka tejkaluar ato normat e caktuara të sjelljes dhe i ka thyer ato norma e mosmirëkuptim dhe me kërkuar që ajo sjellje të vlerësohet si normale bash në momentin më kritik të shoqërisë kosovare kur është çështja me qenë apo mos me qenë shteti i Kosovës. Elementi i katërt, i cili kishte me na ndihmuar shumë në atë vlerësim objektiv real e që kishte me i ndihmuar vlerësimin të kësaj për një zgjidhje , për një orientim të drejtë , është marrja parasysh e faktorit ndërkombëtar, është një pushtet vis-majoris që na u ka imponuar, sjelljet tona edhe të institucioneve edhe të individit janë të kushtëzuara, janë të determinuara prej pozitës dhe rolit që ka faktori ndërkombëtar. Nëse i marrim parasysh dhe kemi kujdes ,atëherë kishim me e nxjerrë një vlerësim i cili kishte me qenë më përgjegjës. Po e them këtë, ndoshta nuk është fjalë e matur por e përdorin këtë dhe kishte me qenë ndjejnë situatës. Krejt kjo është e pafalshme nëse harrohet momenti i tashëm në këtë proces të formimit të shtetit, gjegjësisht të pranimit të subjektivitetit të shoqërisë kosovare si shtet. Më falni kaq.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputetë. Për fjalë është lajmëruar tash në fund edhe një deputet Kamber Kamberi e ka fjalën.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI -Ju faleminderit z. kryesues, do të jem shumë i shkurtër, jo për pikën e rendit të ditës, por për paraqitjen „dashamirëse“ të deputetit Koci në adresë të ministrit Kuçi. Veç t’i përkujtoj deputetit Koci se veshja e njeriut është sipas dëshirës dhe se për këtë nuk ka rregulla ende në Parlamentin tonë. Pa kravatë shpeshherë mund të paraqiten edhe kryetarët e fuqive botërore ,siç ishte Klinton, Bush, Bler e tjerë. Së dyti, retorika është e dëshirueshme për secilin prej nesh, mirëpo kjo kushtëzohet nga disa faktorë. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Për replikë Gani Koci e ka fjalën.

DEPUTETI GANI KOCI Meqë nuk ishte e paraparë kjo në Kodin e Mirësjelljes dhe të sjelljes të deputetit, ishte kërkesë dashamirëse, ishte një vërejtje dashamirëse, se po të ishte e përcaktuar me kod ne nuk do të prananim që ai të fliste fare ashtu para foltores ose në sallë nuk do të kishte hyrë fare.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Kamber Kamberi e ka fjalën

DEPUTETI, KAMBER KAMBERI – Vërejtja dashamirëse mund t'i ishte bërë duke pirë kafe së bashku dhe jo në këtë mënyrë publike. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Vazhdojmë. Sabri Hamiti e ka fjalën

DEPUTETI, SABRI HAMITI – Zotëri kryesues, z. Maloku. Unë dëgjova me vëmendje, sepse është një pjesë e punës që po bëhet këtu rreth një teme të veçantë dhe mua veç më kanë penguar në këtë bisedë disa klishe- klisheja e famshme po vonohemi, po vonohemi ka filluar të më pengojë jashtëzakonisht se të gjithë ne e harxhojmë kohën si kot tue thonë po vonohemi. Kjo është bërë klishe dhe ka hyrë. Klisheja është të folur i padobishëm që bëhet lehtësisht i përdorshëm. Nuk është mirë deputetët ta bëjnë zakon ta përdorin nën një, nën dy Kuvendi nuk është vonuar, por ne kemi pasur procedura, rregullat i kemi në Kuvend të tilla që nuk ka mundësi ndryshe të bëhet. Ne nëse i ndjekim procedurat kjo mbërrin këtu ku ka mbërriri, nëse nuk i ndjekim procedurat ,atëherë bëhen mbledhjet e jashtëzakonshme nuk kërkohen ekspertiza, nuk kërkohen a rekomandime, ky është problemi.

Desha të them që nuk është vonuar kjo, por procedurat tona vijnë në këtë kohë, tutje desha të nënvizoj dy-tri probleme që këtu nuk po duhen të nënvizohen, sepse njerëzit po flasin për gjërat themelore me figura të rendit të parë e të tretë, e të pestë, përtej poetëve do të thosha unë, këtu duhet të flitet konkretisht. “Vetëvendosja” me 10 ,zotërinj ka bërë një demonstratë të artikuluar shumë qartë politikisht kundër pakos së Ahtisarit, kundër Grupit të Unitetit dhe kundër institucioneve të Kosovës. Unë nuk po i them këto, po i kanë thënë ata me parullat e veta, me fjalimet e veta, me insistimet e veta. Kjo është një.

Kjo është themelore zotërinj dhe kjo duhet të thuhet këtu, politikisht iu kanë kundërvuar pakos së Ahtisarit, iu kanë kundërvur Grupit të Unitetit me emra dhe me funksione të cilin e përbëjnë ju e dini çka ka me ju thënë kryetar i Kosovës, kryetar i Parlamentit, kryetari i Qeverisë dhe kryetarët e dy partive më relevante opozicinare dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse në bankat e këtij Kuvendi u bisedua edhe për probleme të tjera, është artikuluar një mendim shpejt e shpejtë shumë i ashpër që ju jeni fajtorë pse janë vrarë njerëzit edhe pse Albin Kurti konkretisht është në burg.

Unë mendoj që nuk është ashtu dhe analiza e ngjarjeve, analiza e politikës rreth ngjarjeve, analiza e institucioneve dhe e policisë rreth ngjarjeve është dashur ta zbardhë shumë më drejt dhe ma konkretisht këtë problem. Analizat që i kemi nuk e zbardhin dhe e lënë situatën të padefinuar. Ju thoni pse, është shumë e thjeshtë Policia e Kosovës ka dëshirë të ketë fuqi ekzekutimi – nuk e ka. Policia e Kosovës nuk komandohet nga kuadrot e Kosovës zotërinj dhe po ju them nga ajo që na pret neve konstitucionalisht dhe institucionalisht nuk do të komandohet as në të ardhmen, sepse po rezervon forca e re mbikëqyrëse në Kosovë të drejtën që të koordinojë ose të mbikëqyrë, unë do të thosha të komandojë ende në siguri dhe në drejtësi, dy fushat që lidhen kryekëput me këtë situatë të 10 shkurtit dhe me jetën tonë në të ardhmen. Prandaj nuk është mirë që thashë të bëjmë diskurse dhe të folën këtu fjalë të natyrave moralistike se nuk kemi

nevojë t'i bëjmë njëri- tjetrit se po njihemi shumë mirë, shumica që pesë vite jemi në këtë Parlament dhe i dimë fuqitë, dijet dhe qëndrimet tona dikur edhe sot.

Kjo u pa. Mua nuk më pëlqen, njerëzit me parime i dua shumë, por nuk më pëlqejnë njerëzit që deklarojnë parime dhe seleksionojnë shembuj. Për shembull, rreth atij pesëshit të famshëm të unitetit unë i pashë qysh citojnë njerëzit, thonë që nuk janë sjellë mirë dhe e citon tjetrin jo të partisë të vetë, atëherë thuani me emër filon fisheku që e ka emrin kështu, në fillim atë ditë deklaroi kështu, atëherë bëhesh i besueshëm prej parimeve kalon në një anim qesharak partiak. Ky nuk është problem që zgjidhet me anim partiak, sepse unë po ju them, me qëllim thashë çka ka lypur "Vetëvendosja" Grupi i Unitetit është përgjigjur për afërsisht njësoj me nuanca të vogla rreth "Vetëvendosjes" dhe unë po e them edhe një gjë tjetër përtej Grupit të Unitetit ose politikanëve ekstremë të naltë që i kemi na puna e mediave. Puna e mediave ka qenë shumë e strukturume ju thoni tash pse, shumë e thjeshtë është dëshmuar se je nën kontroll të partive politike dhe të funksionarëve të lartë të këtij vendi, pa të deklaruar, sepse ka qenë unison kur janë prekur interesat e të gjithëve barabarë, kanë qenë shumë të strukturume rrallë ndonjë gazetë që ka krye dhe është bërë vendvendosje ta quaj unë figurativisht, të tjerat kanë qenë pak a shumë një zë. Pra për të pasur liri duet të kesh shtet të lirë, institucione të lira e institucione të lira është edhe policia që e kryen në bazë të ligjit detyrën e vet.

Unë e dëgjova një bisedë të mirë morale të kolegut tim shumë të respektuar Bajram Kosumi, ky flet me dhimbje dhe me dashuri qysh flasim në kur ndodh tragjedia dhe e quajtur ndeshje e patriotëve. Kjo është terë interesante dhe në të njëjtën kohë është shumë paradoksale, do me thënë që të dy anët janë të mirë, janë vëllezër si thonë, por ndodhi çka ndodhi, veç problemi është tash a po duam kanun a po duam ligj, prapë këtu ne jemi diku në mes, kanunarisht vrasja falet e nuk falet, ligjërisht e vret edhe vëllain, por ki me bërë burgun se është ligj e ke vra një njeri, kanunisht mundet me u falë ajo ligjërisht nuk falet. Ne jemi në kuptimin civilizues dhe në kuptimin komunikues në një pozitë të ndërmjeme zotëri dhe kjo po artikullohet edhe sot në Kuvend. Ndodhja e dhjetëshit është një ndodhje që ka hupur jetë. Përgjegjësi për pa u gjetë, nuk është mirë t'i thuhet kërkujtë je përgjegjës as përfaqësuesit politik e as policor. Ju thoni tash këto janë më të dhimbshmet, janë të dhimbshme po unë po ju kujtoj se janë vrarë njerëzit në Kosovë në dorë të milicisë dhe në stacione të milicisë, nuk është hera e parë që ka ndodhur kjo. Po më thotë dikush, i policisë që unë po e them i policisë por është njësoj hesapi dhe kjo ka ndodhur në Pejë për shembull, fenomenet ekzistojnë.

Këto fenomene duhet të zbardhen sipas ligjit dhe unë po e përfundoj, po them që ato që i kemi na në dorë nuk mjaftojnë, po edhe këto janë përgjegjësi e institucioneve për ndodhitë, unë e di që nuk na kanë prurë kurrë policia jonë informata shteruese çfarë i kemi lypë, e ne i kemi lypë që 5 vjet me rend këto, sepse janë limitet që ata që komandojnë janë policia ndërkombëtare, nuk i lejojnë të hyjnë. Ju, e lavdëroj krejt Kuvendi sot kolegun tim të nderuar eks ministrin e brendshëm se ka dhënë dorëheqje a unë kam qenë, unë jam që kam thënë se ti nuk është dashur me dhënë dorëheqje, që po e deklaroj publikisht dhe unë nuk e lavdëroj se ka dhënë dorëheqje, pse s'e lavdëroj, sepse

nuk ka pasur faj, pse po u dashka tash me e pranua një faj që nuk e ka moralisht, nuk ka moral këtu, cili moral, kurrfarë faji nuk ka pasur Fatmir Rexhepi çka ka ndodhur atë ditë, Fatmir Rexhepin e kanë izoluar s'i ka thënë kush si je, ku je e ata që e kanë izoluar janë tue sundue ende atje. Ju falemnderit.

KRYESUESI, NAIM MALIKU – Ju falemnderit Z. Hamiti, fjalën e ka ministri Blerim Kuçi

BLERIM KUÇI, MINISTËR – Ju falemnderit z. Kryesues, të nderuar deputetë, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen në debatet rreth materialit të cilin Ministria e Punëve të Brendshme e ka ofruar, edhe posaçërisht i falënderoj deputetët të cilët na kanë ndihmuar me rekomandimet e veta. Ne këto rekomandime të cilat dolën prej këtij debati do të jemi të kujdesshëm t'i fusim në veprim. Ne, siç e patë edhe në materialet tona, kemi dhënë disa rekomandime, ashtu e kemi kërkuar që atyre rekomandimeve t'u bashkëngjiten edhe rekomandimet tuaja. Unë dhe dëshiroj t'i jap edhe disa sqarime lidhur me vëllimin e materialit që e kemi afruar po ashtu edhe me raportin e Inspektoratit të Policisë.

Ne si Ministri e Punëve të Brendshme e kemi afruar një material prej 32 faqeve ku ju keni pasur mundësi, që Raportin e Inspektoratit të Policisë prej 22 faqesh e që ju ka dërguar kryetarit të Kuvendit ta keni. Nuk e di a e keni pasur. Në qoftë nuk e keni pasur kërkoj falje, po ashtu keni pasur mundësi që atë material ta merrni përmes web-sajtit të Ministrisë të Punëve të Brendshme. Po ashtu, unë dëshiroj t'ju përkujtoj, sidomos grupi që unë mund ta quaj që përfaqëson rekomandimet e z. Baliq lidhur me raportin e Inspektoratit të Policisë.

Unë dëshiroj t'ju përkujtoj se sa i përket fushëveprimit inspektimi i Inspektoratit të Policisë nuk ka pasur për qëllim të hetojë çfarëdo ankese për sjellje të keqe ,qoftë penale apo disiplinore nga ana a e zyrtarëve të SHPK-së apo e Policisë civile të UNMIK-ut. Hetimi i këtillë është ndërmarrë nga një ekip i emëruar nga komisar i policisë së UNMIK-ut, dhe po ashtu ky raport nuk ka të bëjë me marrëveshje në mes të komisarit të policisë së UNMIK-ut dhe ministrit të Punëve të Brendshme që Inspektorati i policisë të kryejë një mbikëqyrje të pavarur mbi hetimet rreth vdekjes së personave gjatë trazirave qytetare.

Rezultatet e inspektoratit të policisë lidhur me vdekjen e dy qytetarëve dhe me hetimet të cilat janë duke e kryer tash UNMIK-u ju do ta keni në një seancë të radhës. E di se do të pyesni por kur do të jetë ajo seanca e radhës, kur do të jetë ai moment, kjo nuk varet nga ne, por varet nga komisar i policisë, ai udhëheq këtë grup me këtë task-force të hetimeve. Inspektorati i policisë e ka vetëm për detyrë t'i mbikëqyrë këto hetime. Unë kërkoj falje në qoftë se ju nuk e keni pasur këtë raport prej 22 faqesh, ku janë të përshkuara edhe shumë detale të cilat këtu e përmes kërkesave tuaja keni kërkuar që të jenë prezentë në këtë seancë të Kuvendit. Ato i keni pasur, keni pasur mundësi, keni pasur mundësi edhe përmes Web-sajtit.

Unë falënderoj posaçërisht Komisionin Parlamentar për Siguri për rekomandimet e veta. Ne po ashtu përmes Inspektoratit kemi marrë rekomandimet lidhur me menaxhimin, lidhur me mënyrën e organizimit të policisë në përgjithësi, dhe ato rekomandime po që se i mbledhim e ka një rezultatë – rezultante është se SHPK-ja nuk është e menaxhuar në nivelin e duhur tani për tani. Ministri dhe kabineti i tij ka formuar një grup që ku do të hartojë kërkesat nga inspektorati i policisë që të bëjë disa hetime lidhur me performancën e stafit udhëheqës të policisë. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Ministër. Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I nderuari kryesues, të nderuar zonja dhe zotrinjë. Nga debati doli se ka shumë nevojë që të krijohet një komision hetues parlamentar lidhur me ngjarjet e 10 shkurtit. Ka nevojë sepse edhe nga këtu doli që ka shumë çka që nuk ka funksionuar në relacionin Ministri e Punëve të Brendshme – Shërbimi Policor i Kosovës, madje këtu edhe nuk u ndriçua çfarë ka qenë ai komunikimi në mes tyre kjo një. E dyta që është shumë me rëndësi është taman në kohë formimi i këtij grupi, na ende nuk e kemi atë raportin që thotë z. Ministër, që do të vjen nga Komisariati i Policisë së UNMIK-ut dhe mbi të gjitha ne nuk kemi ende një përgjigje që e dun qytetarët e Kosovës dhe që e donë familjarët e të vrarëve në protesta dhe të plagosurëve.

Mundësia e konstatimit është e plotë, sepse nuk jetojmë në mesjetë, por jetojmë në kohën e elektronikës ku gjithçka ka qenë e regjistruar edhe nuk ka nevojë për ndonjë farë zvarritje. Mendimi që ta zvarritim hetimin në pakufi deri në përfundim të statusit është mendimi me pasojat më të mëdha që mundet me ekzistuar, sepse kjo nuk është zgjidhja, zgjidhja është tue qenë transparent, tue dalë, tue ndriçua rastin. Ata që kanë kryer vrasjet, duhet me dalë para drejtësisë, ndërsa të tjerët, do me thënë m'u ndriçua plotësisht se si ka qenë rasti, ndërkaq gjithashtu përveç krijimit të komisionit nuk është politika që, nuk është na që kemi ndërhyrë në gjykata, është gjykata që ka ndërhyrë në politikë edhe politikisht e ka arrestuar njeriun dhe po e mban në burg. Këtë nuk jemi tue e konstatuar vetëm disa këtu ose atje, këtë e ka konstatuar edhe organizata e respektuar i Amnesti Internacional edhe të gjitha organizatat e paanshme ndërkombëtare që merren me këtë punë, kjo nuk do shumë mend, do me thënë kjo është krejt.

Këtu nuk bëhet fjalë për kualifikimet se a kanë pasur protestuesit të drejtë apo jo, protestuesit kur dalin në protestë, nëse i kanë të njëjtat kërkesa që do t'i kishte Qeveria, që do t'i ishte Grupi Negociator, që do t'i kishte pushteti ajo nuk do të quhet më protestë apo demonstratë, po ajo e ka një emër tjetër, do me thënë e ka emrin dasmë ose festë që dilet me tupanë në përkrahje, ajo është krejt tjetër send, do me thënë protestat kanë të bëjnë me diçka që është e pakëndshme për ata që e mbajnë situatën në një vend të caktuar. Kështu që, ka mjaft me çka merret ky komision parlamentar e hetimor për këtë çështje dhe mendoj se do të dilte pastaj edhe me rekomandime shumë të nevojshme dhe të dobishme për punën e mëtutjeshme për mbarëvajtjen e situatës në Kosovë, për punën e SHPK-së e kështu me radhë. Pra, janë dy propozimet është ky edhe propozimi që e dha z. Hydajet Hyseni që nuk do të ishte ndërhyrje fare në gjyqësi apeli për lirimin e z.

Kurti për arsye që u thanë këtu, do me thënë këto dyja kërkoj që të qiten në votim. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU - Ftoj për prononcim shefat e grupeve parlamentare. Alush Gashi e ka fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues, na e kemi shqyrtuar me shumë vëmendje kërkesën për këtë debat. Kemi mbështetur si grup me potëni, kem marrë pjesë aktive në debat gjatë tërë ditës dhe kem mirëpritur angazhimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për përfundim të këtij procesi që të gjitha faktet lidhur me këtë ngjarje të jenë të verifikuara, të jenë publike dhe nga kjo ngjarje me elemente tragjike se kanë vdekur, janë vra tragjikisht dy qytetarë të Kosovës në një protestë e cila ka filluar si protestë paqësore dhe jem të inkurajuar me punën e Komisionit parlamentar për siguri, i cili dy –tri ditë pas asaj ngjarjeje ka filluar punën dhe ka dal me të dhëna preliminare, ndërsa sot në seancë plenare ka dalë me një raport të lakmueshëm, në raport që ne gjatë debatit provuam të gjithë së bashku që ta kompletojmë.

Ne kuptuam sot se Ministria e Punëve të Brendshme, përveç këtyre të dhënave nga inspektorati nga puna e vet e brendshme si ministri, nga komunikimi mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve jo në përgatitje të raportit i cili do të ketë aq sa unë e kuptova nga z. Ministër të dhëna nga ekspertiza furnizike dhe vendi i ngjarjes do të jetë, shpresojmë një raport i plotë. Dhe Sabriu e theksi dhe të tjerët e përdorën shumë herë elementi në kohë është herët – është vonë pa kurrfarë qëllimi që të arsyetojë kohën. Vetëm ju përkujtoj se vrasjen e dy protestuesve në ngjarjet e Parisit hetimet kanë zgjatur më tepër se një vit, tue i ditë rrethanat, tue ditë kapacitetet tona, ne duket të kemi mirëkuptim për një ekspertizë profesionale dhe shkencore.

Ndërhyrjet me vlerësime politike të çështjeve ekskluzivisht profesionale kam dro që nuk e ndihmojnë procesin. Ne si grup në ndarje të punëve të Komisionit tonë kem dërguar në Komisionin për Siguri njerëz për të cilët mendojmë që kanë ndoshta një prioritet apo një më afër një ekspertizë se sa të tjerët dhe z. kryesues kemi rezervë në themelimin të një komisioni i cili do ta ketë të njëjtin mandat si komisionin të cilin ju e udhëheqësi.

Ne nuk kemi mandat, nuk kem fuqi me i dhënë një mandat tjetër një komisioni të cilin do ta formojmë për këtë çështje, për këtë çështje sipas procedurave parlamentare ne ju. Ju e keni mbështetjen tonë, por njëkohësisht pasi që me grup kjo çështje pas debatit, ne se kemi diskutuar, ne nuk e refuzojmë por për ta pranuar kemi nevojë që të bisedojmë si grup parlamentar, nëse jo sot bisedojmë një herë tjetër dhe japim rekomandimin tonë Kryesisë së Kuvendit lidhur me këtë çështje. Nuk kemi asnjë të dhënë që grupi nuk e pranon, por kemi rezerva se a grup i formuar me të njëjtin mandat të cilin e ka Komisioni për Siguri i Kuvendit nuk do të prodhon substancë diçka tjetër. Por nëse është nevojë politike e propozuesit, ne si grup do ta diskutojmë dhe ta informojmë Kryesinë e Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës Xhevat Bislimi. Urdhëroni

DEPUTETI, XHEVAT BISLIMI - Z. kryesues .mua po më duket që debati është mbyllë, kërkesën nuk e kanë bërë shefat e grupeve për këtë debat, kërkesën e kanë bërë 25 deputetë të këtij Kuvendi dhe propozimet e Emrushit janë shumë të qarta, prandaj mbetet vetëm t'i hidhni në votim. Është shumë normale të votohet, kush do i përkrah, kush do nuk i përkrah, nuk ka nevojë më me ju kthye debatit prapë ky Kuvend . Kërkesë e grupit që ka kërkuar debatin është që të votohet – dy propozime janë, u krye muhabeti.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Të faleminderit z. deputet. Gjylnaze Sylja e ka fjalën në emër të Grupit parlamentar të AAK-së

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit Z. Kryesues. Në parim ne i mbështesim çdo veprim i cili do të zbardhte se çfarë ka ngjarë në detaje. Kolegu im nga LDK-ja veç e theksoi edhe punën e Komisionit të cilin ju e udhëheqësi, megjithatë konsideroj se ne duhet gjithashtu ta kemi një konsultë paraprake para ndonjë vendimi për hir të vetë suksesit të veprimeve çfarëdo që do të ndërmerret Kuvendi. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU - Ju faleminderit. Më lejoni që të kufizohem nga pozita e kryesuesit. Vetëm disa sqarime në lidhje me propozimin dhe sugjerimet që i dha z. Alush Gashi.

Të nderuar.Komisioni Parlamentar për Siguri është ngritur dhe është votuar nga ky Kuvend në shtator të vitit të kaluar dhe fushëveprimi i këtij Komisioni Parlamentar për Siguri nuk është Komisioni Hetimor, pra nuk kryen hetime. Komisioni Parlamentar për Siguri është ngritë si kapacitet i këtij Kuvendi për të mbikëqyrë segmentet e sigurisë në Kosovë, do të thotë mbikëqyrjen e bënë duke i thirr në dëgjim qoftë publik ose me dyer të mbyllura siç ishte rastin për ngjarjet e 10 shkurtit dhe Komisioni Parlamentar për Siguri,pastaj kërkon hetime. Ne kemi kërkuar nga Inspektorati Policor i Kosovës hetimet e metalizuara lidhur me kompetencat që i ka ai Inspektorat mbi Shërbimin Policor të Kosovës nuk ka kompetenca Inspektorati policor i Kosovës mbi Policinë e UNMIK-ut.

Ne kemi provuar të japim sqarime nga komisionari i policisë së UNMIK-ut, nuk e kemi marrë atë. Ne kemi kërkuar pra sqarime nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe raport për gjendjen e të burgosurve, i citoj disa nga ato raporte që i kanë dërguar pra nga Ministria e Drejtësisë. Mendoj se pak kemi hyrë ndoshta në kompetencat e Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, por Komisioni për Siguri ka vetëm atë segmentin e sigurisë së qytetarëve të burgosur që përkohësisht mbahen në arrest, por vetëm atë segment, pra për shkelje të tjera është Komisioni Parlamentar. Unë mendoj për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese. Pra nuk kemi të bëjmë me Komision i cili bënë hetime.

Ju e pat se Inspektorati Policor i Kosovës vetëm është i ftuar nga Komisionari i Policisë për të asistuar hetimet që i bën Prokuroria në lidhje me vrasjen e dy qytetarëve të Kosovës, dhe ajo nuk është kryer, pra për atë pjesë ne nuk kemi pasur raport këtu për vrasjet dhe plagosjet, tejkalimet kush në mënyrë individuale dhe kolektive, të cilat njësi i kanë bërë dhe kush ka komanduar përdorimin e masës të tejkaluar të dhunës ndaj protestuesve, ne atë hetim nuk e kemi, nuk e kemi atë pjesë të raportit. Nga Raporti i Inspektoratit policor të Kosovës thuhet se është ftuar inspektorati në atë hetim dhe ai hetim do të vjen dhe rezultat e atij hetimit do t'i procedohet Komisionit për Siguri në të ardhmen, pra kjo është ajo që desha ta sqaroj për Komisionin Parlamentar për Siguri. Unë ju lus që të më lejoni se si ka përfunduar edhe një Komision që e kemi ndërtuar në këtë Kuvend. Ju e dini që pas ngjarjeve të marsit 2004, në këtë Kuvend është ngritur një komision hetimor, pra nuk ka pasur qasje në hetim, në segmentet janë kompetencë e rezervuar e UNMIK-ut dhe ai Komision kur nuk ka pru raport para këtij Kuvendi.

Unë desha vetëm t'ua përkujtojë këtë dhe, më falni , por desha t'ua përkujtoj edhe kompetencat e Komisionit për Siguri që duhet t'i ketë dhe që i ka dhe që janë miratuar në këtë Kuvend. Edhe si Komision për Siguri, më lejoni të them se jemi në procesin e ngritjes së këtij Komisioni. Ende ky Kuvend nuk ka miratuar ligj për Komisioni. Ne nuk kemi pasur qasje në burgje apo në segmente tjera për shkak sa ajo duhet të rregullohet me ligj, pra edhe të drejtat e këtij komisionit në të ardhmen dhe të anëtarëve të Komisionit duhen të rregullohen me ligj në këtë Kuvend, pra Komisioni është në ndërtim e sipër, por kjo është e tëra ajo që ne kemi mundur me i ofruar këtij Kuvendi. Ju faleminderit.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se debati ka përfunduar me këtë pikë të rendit të ditës dhe e konsideroj këtë pikë të rendit të ditës të përfunduar.

Kur të vijë raporti për ngjarjet dhe për hetimet e bëra, pjesën e hetimeve të bëra në Komisionin Parlamentar rreth vrasjeve dhe plagosjeve, ne do t'ia dërgojmë Kryesisë së Kuvendit dhe ajo pastaj do të vendosë për procedim të mëtejshëm. Ju faleminderit.